

INTERVISTË ME ZENUN ÇELAJ

Prishtinë | Data: 20 shkurt, 1 dhe 7 mars, 2019

Kohëzgjatja: 323 minuta

Të pranishëm:

1. Zenun Çelaj (I intervistuari)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Po fillojmë me... nëse mundeni me e prezantu vetën edhe me na folë diçka për kujtimet e hershme të fëmijërisë. Domethanë, çkado që mbani n'mend prej fëmijërisë t'juj. Familjen, vendin ku jeni rritë...

Zenun Çelaj: Domethanë, s'do të thotë se lidhen me Prishtinën?

Aurela Kadriu: Jo, jo.

Zenun Çelaj: E po mirë.

Aurela Kadriu: Na po flasim për jetën e juaj. Mandej me ni moment të caktum nëse ajo lidhet me Prishtinën.

Zenun Çelaj: Unë jom Zenun Çelaj, vij nga një fshat i skajshëm verior në Mal të Zi, Vuthaj, luginë e Plavës e Gucisë. Ni zonë shumë historike dhe për bukuritë natyrore. E rrallë shumë, e bukur. Jo pse e kom vendlindjen, po pse osht' e tillë. Këto ma kanë thanë edhe tjetër. Vi nga një familje që ka qenë blegtorale, kanë majtë shumë dele. Kemi qenë shumë anëtarë të familjes dhe jam praktikisht i pari që jom shkollu në atë familje, që ishte mbi 60 anëtarëshe të shpërndarë knej kufinit.

Gjithnjë flas tash sikur jam në Mal të Zi dhe në Shqipëri, meqenëse fshati ashtu shtrihej, i kishte pronat. Kohën kur s'kishte kufi, pastaj ndodhën ato kufijtë e hekurt dhe me dekada nuk jemi pa as me të afërmit atje, as s'kemi ditë për jetën e tyre, as për fatin e tyre njësoj sikur edhe ata për ne. Shkollën fillore katër klasë i kom kry në vendlindje, jom praktikisht gjenerata e dytë mas Luftës të Dytë Botrore, në gjuhën shqipe në atë luginë, atë zonë. Ndërsa, tetëvjeçaren në Guci.

Aty vinin nxanës edhe nga fshatrat tjera, shqiptarët e Plavës dhe Gucisë. Kurse shkollën e mesme për mësus që quhej atëherë Shkolla Normale, e kom nisë në Pejë, asht' mbyllë në Pejë kam kalu në

Gjakovë edhe bashkë me nxënësit e tjerë të brezit. Edhe aty është mbyllë mbas ni viti dhe kam vazhdu në Prizren edhe prej Prizrenit në Prishtinë. Domethanë kom fillu në vitin 1954/55 dhe në vitin '59/'60 e kom mbaru në Prishtinë Normalen.

Ende pa diplomu, pa kry, se ashtu atëherë diplomahej shkolla e mesme, e ni konkurs të "Rilindjes", bohet fjalë pra për vitin 1960, kur "Rilindja" kishte mbushë dy vjet të saj që dilte përditë, ndërsa ishte viti, mosha e saj 16 vjet, 15 vjet. Konkurova në ni përzgjedhje të gazetës dhe u pranova gazetar, ende s'i kisha plotësu tamon 20 vjet. Dhe prej atëherë deri në mbyllje të "Rilindjes" kom punu në "Rilindje". I bjen praktikisht deri në vitin 1999 ndërsa në vitin 2000 kam qenë kryeredaktori i parë i gazetës të përditshme "Zëri", që dilte si ni vazhdim i dikur "Zëri të Rinisë", deri në vitin 2009. Ndërsa nga ai vit e deri më sot punoj, jam kryeredaktor i portalit Koha.net dhe aty vazhdoj t'jem, se di edhe sa, ndoshta derisa të rrumbullaksoj 80 vjet moshë.

Aurela Kadriu: Axha Zenun, kisha dashtë une... faleminderit shumë na ofrutë nifare skeleti të krejt jetës t'juj. Po unë kisha dashtë me ndejtë nëpër krejt qito periudha pak ma gjatë, me folë për ma shumë detaje. Po kom qef për fëmininë në Vuthaj edhe e përmendët që keni qenë familje e madhe. Qysh ka qenë jeta e ju? Qysh e mbani në mend jetën e ju në Vuthaj? Çfarë kujtime keni?

Zenun Çelaj: Tash në këtë moshë ku kom mrri unë, 80 vjeç, njeriu osht' nostalgjik (qanë). Për fëmininë, s'ka qenë e lehtë. Ishim pak shqiptarë atje, por u vendos, u rivendos kufiri në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë së atëhershme. E trajtimi nga kufitartë, por edhe nga vet popullata serbe, pjesërisht për fat të keq edhe boshnjake që ma vonë e qujtëm muslimane, nuk ka qenë aq miqësor. Kështu që, duhet të hishim edhe kujdesshëm po edhe të gatshëm për ndonjë edhe përleshje, grindje me ta siç na ka ndodhë ne.

Se ne fillum shkollën tetë vjeçare në Guci, se fshati Vuthaj është krejt shqiptarë edhe aty s'kishim këtë problemin me popullatë jo shqiptare, po me ushtartë që runin kufinin. Kurse në Guci kishte malazet edhe boshnjakë të ciltë shumë shpesh edhe na fynin në baza nacionale, po tash ndoshta edhe vet natyra e... na kishte ngritë e ndërtu ma të guximshëm se që do të duhej të ishim, dhe shpesh kishim edhe përleshje me ta. Për fat të mirë gjithmonë dilnim fitues dhe dikur gati u msun me ne, ma nuk na keqtrajtonin.

Edhe mësimin e zhvillonim kryesisht thuaje në gjuhen serbo-kroate, siç quhej atëherë, nga mësimdhënës, arsimtarë që ishin atëherë malazezo-serbo-boshnjak. Ndërsa shqiptarë kishim, vetëm një ka qenë, një Rexhep Agaj, Ahmet Rexhep Agaj, që udhëtonte me bicikletë çdo ditë nga Plava dhe vinte në Guci që t'na ligjeronte aq sa mundej. Ishte histori, ishte landa e gjuhës shqipe që ishte shumë me literaturë të kufizuar. Derisa në vitin 1952, ashtu kur erdhi emigrant një prift nga Shqipëria bashkë me motrën e tij, Prak Ndrëvashaj që quhej. Ka qenë ni intelektual i nivelit shumë të naltë që ma vonë e kom kuptu e kom ndëgju, ia kom ditë vlerat.

Ai ka qenë nxanës i shkrimtarit Ndre Mjeda, i cili shpesh herë fliste për Mjedën edhe për momente kur ka lindë ndonjë poezi prej tij. Fatkeqësisht, atëherë s'kom ditë ta çmoj këtë moment dhe s'kam ditë t'i shënoj ato detaje, por ashtu i kujtoj. Ma vonë i kom kujtu se ai në ndërkohë lëshoi Jugosllavinë, atëherë shkoi në Itali dhe pastaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atje ku ka drejtu ni kishë katolike.

Prej Vuthajve masandej kur u regjistruam ni grup nxënësish prej, prej aty, prej Plavë Gusisë në Pejë, në shkollën shqipe, duhej të udhëtonim prej atje deri në Pejë, që osht' dikund 90 kilometër. Duhej të udhëtonim në kamë nëpër... si bjeshkë, Qafa e Dilit i thonim, e pjesës tjetër Qafa e Çakorrit, që tash po trajtohet si problem kufitar në mes Kosovës... ose trajtohej si problem kufitar në mes Kosovës dhe Malit të Zi.

Dhe deri në Pejë nga 90 kilometra, grup nxënësish nëpër borë, kohë të keqe. Vinim për t'u regjistru... ose në ditët kur kishte ndonjë pushim ma të gjatë se katër-pesë ditë, ishin ato festat shtetnore në atë kohë, 29 nëntori ose 1 maji se për Vit të Ri zakonisht nuk vinim meqenëse vinte pastaj gjysëm vjetori në janar dhe nuk kishim si me thanë... s'ishte leverdia për tri ditë t'vinim edhe prapë të shkojsh atje.

Ni udhëtim shumë i gjatë, shumë i mundimshëm me rreziqe si edhe të ngriheshim siç kishte ndodhë shpesh me njerëz ma në qafat e maleve. Sepse në atë kohë edhe, çuditërisht binte edhe ma shumë borë, ishte koha shumë ma e vështirë. Poashtu në Pejë edhe s'kishte as konvikte, ishte edhe baza materiale tjetër mjaft e randë. Kështu që, ishin edhe këto vujtjet tjera nganjëherë edhe për vuajtjet ma themelore, për ushqim, por kishte edhe solidaritet.

Mund të them se profesorët shqiptar në përgjithësi kishin edhe një mirëkuptim të jashtëzakonshëm për ne edhe na përkrahnin, na stimulonin që të ishim nxanës të mirë edhe t'jepnim ma vonë kontributin si mësues atje. Po unë, ndodhi, nuk e përmbusha këtë angazhim të atyre meqenëse u mora me gazetari ku po ashtu ndoshta kom mrrë me e dhanë atë kontributin tim, qoftë në tërheqjen e njerëzve, t'rive prej vendlindjes që të shkollohen ose edhe në formë tjetër.

Mund të them se osht' një ndër fshatrat edhe në përgjithësi fshatrat shqiptare atje që kanë dhanë shumë intelektualë, të ciltë janë shqu edhe në përmasa kombëtare, flas për vllaznit Qosaj, Rexhep Qosja, Isa Qosja. Njani në fushën e filmit tjetri të letërsisë ose në shkencat tjera, mjeksi si Isuf Dedusha, Isuf Ulaj e shumë të tjerë.

Aurela Kadriu: Me sa po muj me e llogaritë në kokën teme, keni shku në shkollë fillore dikund '45-'46.

Zenun Çelaj: '46, dikund si kam as... ende s'i kisha mbush gjashtë vjet.

Aurela Kadriu: Qysh, qysh ka qenë qajo kohë?

Zenun Çelaj: Tash...

Aurela Kadriu: Meniherë mas Luftës të Dytë Botënore.

Zenun Çelaj: Meniherë ishte mas Luftës të Dytë Botënore, '45-shin u hap për herë të parë shkolla fillore shqipe. Në të vërtetë dikund edhe në vitet e '30-ta kish qenë në shkollë, ish Jugosllavia i kishte hapë gjashtë shkollë, kishte prurje edhe arsimtarë shqiptarë. Josip Relja ka punuar në atë shkollë të fshatit, por nxënësit kanë mësuar serbisht edhe thuhet se s'kanë mësuar shqip. Kështu që, kjo ishte hera e parë, pas në kohën që është qyteti i kohës së Shqipërisë. Në vitet kur ishte Shqipëria e pushtuar nga Italia, por edhe atëherë s'ka funksionuar shkolla. Kështu që, mund të flitet që i përket brezit të dytë, domethënë gjeneratës të dytë që fillonte të mësonte në gjuhën shqipe në ato territore, '46-shin. E në Gusi poashtu...

Aurela Kadriu: A e mbani në mend Luftën e Dytë Botënore?

Zenun Çelaj: Mban në mend pak, e mban në mend sa një i vogël edhe mban në mend. Mban në mend që si familje, si shpirt kemi qenë pak ma e madhe dhe shumë mysafirë shtegtar që kanë kaluar në atë relacion. Ka qenë në rrugë që e ka lidhur Kosovën me Shkodrën edhe kanë ardhur gjithmonë me fletë në shpinë tonë. Ndërsa të tjerë, mban në mend se kemi pasur në shtëpinë tonë, në një kat kanë qenë partizanët e në një kat tjetër vullnetarët që ishin kjo pjesë që mbronte territoret shqiptare. Nuk mund të thuhet se ishin fashistë ose profashistë, por ishin nacionalistë, ma vonë komunistë se atëherë s'e kom diti. Sigurisht ata pleqtë e shpirtit e kanë ditë se ata... tolerancë në mes... vullnetarët e partizanët kanë qenë të armiqësorë. Mirëpo, i kanë marrë ashtu të fshehtë. Njëni në kat, tjetri në kat tjetër. S'kanë ditë për njëni tjetrin.

Po mban në mend që kur isha te partizanët e disha atë përgjigjen "Vdekje fashizmit" {shpjegon me duar} me grusht në ball, e shkojshja ma shpesh se ata ngriheshin të gjithë në kamë e kjo m'dukëj interesante (qeshë). Këto janë ato elemente. Edhe mban në mend, ka qenë, i thojshin bija e Vokshit, ka qenë në luftëtarë nga Gjakova... këta e kom marrë vesh ma vonë po ashtu, se atëherë nuk e kom diti, po kur e kom njoftë masi jam bërë gazetar m'ka ra të njihem me ta. Osht' e familjes Asim Vokshit edhe kësaj familje luftëtare. Ajo ka qenë në grup e plagosur me uniformë. E di se nana ime kujdesej atëherë për shëndetin e saj, e vetëm... domethënë që këto janë ato që i kujtoj.

Aurela Kadriu: A keni jetë në bashkësi familjare?

Zenun Çelaj: Shumë... thashë, bashkësi shumë e gjatë meqë kishim edhe pronë. Kemi pasur shumë edhe në Plavë e Gusi në fshatrat i thonë Krusheve në katun, në tjetër Martinaj, e në Shqipëri në Valbonë. E ishim të shpërndam, po vazhdimisht në 20-25 asnjëherë nuk ka ndodhur që t'mos i ketë në një shtëpi, në një kulm.

Aurela Kadriu: Qysh ka funksionuar? Sa breza keni jetë?

Zenun Çelaj: Tash, unë mbaj në mend që kemi mrri deri në pesë breza kshtu që t'jemi në ni bashkësi familjare. Simas atyne adeteve të vjetra në familje është zgjedhë për zot shtëpie, për kryefamiljar ai që ka qenë ma i zoti, ma i meçmi, ashtu që osht' mendue, po edhe ma trimi. Natyrisht se osht' dashtë të jetë edhe guximtar. Domethanë, ai kryefamiljari, ai ka nda rolet. Osht' ditë kush është bariu, kush osht' ai që do të merret me punimin e tokës, kush do të merret me tregti, me furnizim të shtëpisë. Furnizimi zakonisht osht' bo prej Pejës, atje osht' tokë që nuk prodhon shumë pos blegtoria që mund të zhvillohej, pjesa tjetër... bukë ka mund të sigurohet për dy muj tre, pjesa tjetër të blehet në Pejë.

Aurela Kadriu: A jeni marrë me punë të fshatit?

Zenun Çelaj: E unë meqë kom qenë djali ma i vogël në familje edhe meniherë shkova në shkollë, praktikisht nuk më ka ra që të merrem me punë bujqësore. Ni verë kom rujtë qingjat, kingjat, edhe këto e mbaj në mend kështu ni prej punëve ma kryesore që kam bo atje.

Aurela Kadriu: Ajo shkolla në fshat atje katër vitet e para që i keni kry, ajo ka qenë absolutisht shqip apo?

Zenun Çelaj: Krejtësisht shqip ka qenë, po sepse edhe mësuesi ishte shqiptar edhe ishin edhe... nga fshati ynë që duket, jo duket po ashtu ka qenë, edhe në kohën e ish asaj, ish Jugosllavisë, njerëzit kanë ikë nga zullumet serbe prej aty edhe janë shkollu në Shkodër. Kanë kry ndoshta plot, jo shkollën e mesme, po edhe shkolla fillore atëherë ishte si me pasë tash fakultetin. Dhe ata ishin kthi na msonin ne se kishte shumë nxanës në atë kohë. Ishim gjenerata, domethanë e jeme kem qenë dikund 70-80-90 ndoshta. Për fat të keq... domethanë vetëm klasa e parë. Kurse sot mbas gjithë ktyne viteve në klasën e parë s'ka pasë asni nxanës.

Aurela Kadriu: Tash?

Zenun Çelaj: Po, s'ka, s'ka kush me... kanë mbetë pak banorë, janë shpërngulë kanë shku kryesisht në Amerikë ose edhe këtu në Kosovë, por atje kanë mbetë vetëm pak njerëz edhe kryesisht pleq që nuk shumohen ma.

Aurela Kadriu: Po më intereson masiqë e përmendet këtë fakt demografik, qysh ka qenë nëpër klasa? A ka pasë vajza që kanë ardhë në klasë të parë?

Zenun Çelaj: Po, atëherë meniherë mas luftës ishte edhe detyrim, ishte detyrim ligjor. Prej familjes time kemi qenë në ni klasë shkojshim nantë. Kemi qenë... edhe pse me moshë jo krejt të njejtë. Unë isha ma i vogli, ma i madhi ka qenë tri vjet ma i moçëm se unë e kanë qenë edhe tri vajza nga këta t'nantë.

Aurela Kadriu: Po në përgjithësi në shkollë domethanë...

Zenun Çelaj: Po deri katër klasë mandej tetë vjeçare nuk pat' ma. Prej fshatit tim askush, as prej fshatrave tjera. Ishte një... kanë qenë se aty ka popullatë shqiptare edhe muslimane edhe me fe, përkatësi katolike. E kanë qenë dy vajza katolike, ni Diella, ni Lena i mbaj në mend. Ato s'di çka ka ndodhë mandej, kur erdha unë në Pejë nuk e di a e kanë vazhdu shkollimin ma a jo, s'kam ide.

Aurela Kadriu: E qysh e mbani në mend... qysh ka reflektu fakti që tri vajza prej familjes t'juj kanë qenë... me siguri keni shku në shkollë bashkë?

Zenun Çelaj: Po na shkojshim bashkë. Tash duhet ta keni parasysh, te ne ka... nuk ka pasë fanatizëm asnjëherë. Është si me thanë, vend me traditë që femna ka qenë e lirë, ajo ka udhëtu vetëm, ka qenë edhe bareshë, ka qenë edhe punëtore, ka udhëtu prej Vrrit si i thojmë na fshatit në bjeshkë, vetëm nuk ka pasë kësi pengesash. E natyrisht këto normat morale, këto kanë qenë shumë të ashpra.

Ajo osht' dashtë... femna, edhe nëse ka ardhë nuse dje... se po flasim, tash i takon ndoshta edhe etnografisë a kujt me thanë. Po, po t'vije ni mysafir, kush do qoftë e thrret te dera, "O i zoti i shpisë" në qoftëse nusja nuk ka dalë, nëse ka qenë vetëm, e me i thanë, "Mirë se erdhe" e me shti njeriun mrena me i ofru ushqim e krejt, atëherë nuk do të ishte burrë ai që do ta mbante se do ta kishe koritë familjen, shpinë. Do, do ligje interesante. Tamon të mikëpritjes, si ajo që përmendet shpesh për mikëpritjen shqiptare.

Aurela Kadriu: Kjo ke veç ni degresion se...

Zenun Çelaj: Po.

Aurela Kadriu: Më interesoj qysh ka qenë qajo dinamikë. E ju, sa motra e vllazni keni pasë?

Zenun Çelaj: Unë personalisht... kemi qenë tre vllazën e dy motra. Ni vlla vdiq herët prej një sëmundje meningjtit, ma vonë e kom marrë vesh se meningjit, '51-shin, shumë herët ka vdekë. Po edhe ni motër ajo m'ka vdekë në Amerikë, ni motër e kom ende gjallë dhe ni vlla tjetër edhe ai është në Amerikë si shumë të tjerë.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë jeta në familjen e ngushtë në këtë rreth të gjanë familjar? A ka ekzistuar megjithatë qajo afërsia me ata që i ke pasë motra ose vllazni?

Zenun Çelaj: Po pa dyshim.

Aurela Kadriu: Meqenëse keni qenë ni familje e madhe, disa breza.

Zenun Çelaj: E shiko tash, po flas gjithmonë për atje zakoni si ka qenë në familje tonë. Në familjen tonë gruja ka pasë të drejtë të ketë pronë deri pesë dele edhe me leshin e atyne deleve ka veprue si ka dashtë edhe me këtë tufë, që osht' rujtë bashkë me tufën e familjes. Ka pasë të drejtë të ketë tufë pulash, me veztë e pulës të boj çfarë të dojë ajo, t'i shes t'blej çka t'don.

E poashtu ka ekzitue... tash baba im, nana ime me fmitë e tjerë poashtu ka thurë, si të them, ato copat, zhgunin, për premje rrobash, tirqi e çka po di unë. Domethanë edhe mrena asaj familje ka ekzistuar miniekonomia që i ka taku asaj ma të ngushtës. Ka qenë kjo pjesa tjetër ma e gjanë që për shembull, bylmeti e kto që janë mledh nga delet se thashë me dele kryesisht jemi marrë. Ajo osht' zanë për të gjithë të tjetër, është shërby, është zi bashkarisht për të gjithë. Ushqimi natyrisht osht' shërby simas moshës. Burrat, në të vërtetë fmitë ma s'pari, burrat, e ma s'mrami gratë, domethanë kanë hangër bashkarisht.

Aurela Kadriu: E kur zbritët në Gusi çka ke dallimi në shkollim? E përmendët edhe ma herët që ka qenë shkolla e përzine? Qysh e mbani në mend ju?

Zenun Çelaj: Tash prej fshatit tim deri në Gusi i ka dikund deri në pesë kilometra, varet se katuni është shumë i haptë. Edhe... domethanë, prej ciles pikë shkon, po katër deri në pesë kilometra. Atje kishim problem atë komunikimin fillimisht me fmitë e lagjës, kojshi, se ata flitnin boshnjakisht e na shqip. Prandaj ne ishim shumë ma afër njani tjetrit, edhe ishim shumë ma solidar me njani tjetrin edhe osht' pa rreziku nga shumica.

Po në ndërkohë fillim me mësu edhe na serbishten me mësu gjuhën e tyre edhe me komunikuar me ta edhe me u përle, me u sha si të gjithë fmitë kudo. Për tekste e këto s'mund të shkëmbejshim edhe pse ne mësonim serbisht po jo në tekstet që na i kishim po na diktonte ai mësuesi. Sigurisht kemi bënë ndonjë version ma të thjeshtë të ligjeratave. Tash s'mundem me konceptu tamon.

Aurela Kadriu: Familja a kanë vazhdu me qëndru në Vuthaj edhe kur ju keni ardhë në Pejë?

Zenun Çelaj: Po deri, deri në vitin 1970 deri atëherë. Unë erdha krijova familje, u martova shumë ma herët e mandej vëllau donte të emigroj edhe ai si shumë të tjerë në Amerikë. Kishte pesë vajza e ni djalë. Babën e kisha, ai ishte punëtor fizik. Deri atëherë punonte në Mal të Zi, derisa isha unë për shkollim mandej kur unë marova shkollimin ai mbeti ta realizoj pensionin, ni moshë për pension.

Kshtu që mas '70-tshit e arriti këtë moshë. Bashkë me babën edhe vëllaun tim që ishte me familjen e tij erdhën në Prishtinë edhe prej atëherë kanë jetu këtu. Vëllau në ndërkohë emigroi në... edhe prej këtu shkoi në Amerikë mas vitit 1990 dhe unë mbeta prap vetëm (qeshë).

Aurela Kadriu: E Peja... Shkolla Normale në Pejë, a u hap ma s'pari në Pejë në Kosovë?

Zenun Çelaj: Jo. Ka pasë në atë kohë në Prishtinë, ka pasë në Pejë edhe në Prizren. Por, për ne ishte ma së afërmi Peja. Po, se tash prej atje deri ktu duhej me tren ose autobus me udhëtu ose edhe në Prizren, kshu që na të gjithë thuaja, ni ose dy të tjerë kanë ardhë në Prishtinë edhe një në Prizren tjetër u nalëm në Pejë.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: Po, kem tu folë për Pejën, tash ni ndryshim...

Zenun Çelaj: Po, ishte krejtësisht tjetër. Tash, duken gjanat qesharake sot kur i rrëfen. Niherë kur po ktheheshim, po vishim për në Pejë me dy-tre shokë të tjerë... se n'fillim s'kem pasë as femna, ma vonë erdh një, mas dy-tri vjet, se s'kishte as në tetëvjeçaren, thashë se s'erdhën. E hypëm me ni kamion që barte lanë [drunjë] prej Rugovës... se nëpër Rugovë rruga na çon. Edhe e pash shoferi filloi të flas shqip, për ne ishte çudia ma e madhe. Paska edhe shqiptarë shofer.

Dukej si me thanë... na dukej e pabesueshme edhe ajo, si me thanë, na shtoi edhe krenarinë të përkatësisë. Ishte ky hapi i parë t'thom. Pastaj kur në Pejë fillum në shkollë e në orë të mësimit të muzikës fillum me... po dëgjonim edhe kangë shqipe që s'ishin veç me lahutë e çifteli edhe ajo ishte mrekullia tjetër. Domethanë, këto ishin ato momente që sot duken tepër qesharake po ashtu i përjetonim atëherë.

Natyrisht, ishte varfëri e përgjithshme edhe për fmitë e qytetit edhe për ne të katunit që ishim ardhë. Kshu që nuk dukej krejt e habitshme pse ne ishim me opinga që kishim ardhë. Po ndërkohë u zavëndesunë edhe opingat edhe kjo veshëmbathja prej zhgunit, le të thom, prej ktyne, produkteve që baheshin me dorë prej leshit të deleve. Fillun me i zavëndesu... jo për ni periudhë të gjatë u adaptum, u integrum. Po sigurisht ndikon edhe gjuha po edhe mentaliteti. Janë traditat të ngjajshme ose të përafërta kudo ndër ne.

Aurela Kadriu: E Peja, çfarë qyteti ish për juve?

Zenun Çelaj: E atëherë ishte shumë i madh, i ngjan, m'dukej, kisha edhe frikë ni kohë të gjatë me lëshu rrugën ku banoja, e deri në shkollë, e deri aty ku duhej me ble bukën se banonim në banesa private kështu.

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: E duhej me ble bukën... mënyra se si ushqehemi na, tash duket e çuditshme qysh kemi mbijetu. Se ka ndodhë edhe nga dy tre javë vetëm bukë me sherbet, çaj edhe krypë me hangër. Domethanë, ky ishte fillimi. Ishte tamon si nëpër filma që i kemi pa ma vonë të t'mjerëve. Me pa

ëmbëltores edhe ëmbëlsinë në vitrinë e ti s'kishe me çka me ble as me provu. Po thom, ishte çdo gja e vështirë, por në ndërkohë u kapërcy. Fillim edhe me u ofru edhe me fëmijë vendas, me kolegë, me shokë, me shoqe edhe me qenë edhe në shtëpi të tyre edhe me ndi gjithnjë ma pak mungesën e familjes. Edhe kështu, çdo ditë ndryshime.

Aurela Kadriu: Sa iu ka ra me nejt në Pejë?

Zenun Çelaj: Nji vit shkollor, nji vit shkollor. Mandej ishin ato politikat e atëhershme që nuk krijoheshin nga kuadrat shqiptarë për fat të keq. Ma vonë gjatë viteve si gazetar kam mësue se ato kanë qenë politika të regjimit për asimilim sa ma të madh të shqiptarëve që, të zhvilluara edhe prej aksioneve të tjera që janë të njoftuna. Aksioni për mbledhjen e armëve, të tepricave të pasunisë, për dëbim në Turqi me presione të llojllojshme, arrestime, vrasje, burgosje, malltretime, e tjerë, e tjerë.

T'them edhe sistemi shkollor ishte vu në këtë shërbim domethanë. Se gjithnjë është synue Peja, sidomos të jetë në duar të malazezëve, të iu dorëzohet atyne edhe ka pasë edhe banorë ma shumë malazezë thujase se serbë. Dhe duket, kanë konsideru si rrezik në shkollë për msus në gjuhën shqipe që ishim dikund katër paralele, katër klasë. Në klasën e parë aq edhe në klasën e dytë, të tretë, e derisa mrrinte në klasën e katërt... ma vonë u bo pesë-vjeçare Shkolla Normale.

Duket e kanë konsiderue si të rrezikshme edhe po e largojnë prej Peje. Mbeti vetëm gjimnazi me në klasë, dy. Kurse pesë të tjera ishin në gjuhën serbe. Kurse neve na thanë me shku dikund tjetër, në Gjakovë. Në Gjakovë u hap Shkolla Normale me klasë që u largun nga Peja. Po edhe aty, atëherë rreziku që po krijojmë kuadra nacionaliste shqiptare, se aty vetëm shqip flitej, vetëm shqip këndohej, vetëm libra shqip lexoheshin, se ambienti i tillë. Edhe thashë, ma vonë e kom pa këtë... jo, kish pasë edhe projekte të veçanta. E thanë, "Bon, ose në Prishtinë ose në Prizren". Natyrisht na shkum, se ishte Prizreni ma afër, shkum në Prizren. Nejse, une pata në situatë që u desht të largohem prej Prizrenit e erdha në Prishtinë. Kurse ajo pjesa tjetër e kreu atje.

Aurela Kadriu: Ju paskët qenë në Pejë në kohën '55, '56 të ekzistit për Turqi.

Zenun Çelaj: Po, po.

Aurela Kadriu: A e dini qysh e ka afektu kjo? A ka pasë shqiptarë në klasën e juj që kanë shku familjet e tyre?

Zenun Çelaj: Ka pasë. Edhe prej klasës sime ka pasë edhe që janë malltretue. Dajtë i kom të Rugovës edhe ata kanë qenë të përndjekun. E nji prej dajve ka qenë msus në Rugovë në atë kohë edhe unë nuk disha po në kohë erdh te banesa, aty ku banojsha... banojsha me në nxans ishte nga Rahoveci edhe njo tjetër ishte po nga Mali i Zi, nga fshati im. Edhe po m'thotë, "Prej milicisë po vi" se e kishin marrë milicia, e kishin keqtrajtu shumë.

Unë nuk disha se e kishin majtë disa javë në burg e tash e kanë lshue. Por, me kusht që ai të lajmërohet çdo ditë në milici. E tash, ky si të shkoi te pjesa e familjes tjetër në Rugovë, se janë katër-pesë orë duhet me ecë, që të paraqitet e të kthehet. “A bon me nejt?” “Po natyrisht se...” domethanë, e kom përjetue edhe këtë segment të malltretimit, keqtrajtimit të dajës, vëllaut të nënës time.

Mandej kam dëgju edhe për shumë të tjerë që kështu kanë shkue. E di se familje të tana, sidomos të qytetit të Pejës që flisnin turqisht në shpija edhe fëmitë e tyne veç kur thojshin, “Nuk osht’ ma, ka shkue për Turqi”. Ishin momente të dhimbshme, të prekshme, po ashtu ishte ajo fazë e historisë.

Aurela Kadriu: Kur shkutë në Gjakovë?

Zenun Çelaj: Në Gjakovë ishte ni atmosferë tjetër. Gjakovarët janë edhe ma të afërt me fol kështu nga del shpirti edhe na afrun, me të vërtetë, shumë ma shumë. Plus, atje funksiononte internati, ishte një objekt i kishës katolike që e lshunë për internat. Natyrisht, atëherë feja ish në luftim e sipër se socializmi ashtu e donte. Edhe ni shtëpi tjetër që ishte ni... që kishte migru, kishte ikë ai qysh në ish Jugosllavi në Shqipni, Tiranë e tash shtëpia e tij ishte e zbrastë, kish qenë e zbrastë edhe aty na vendosën ne nxanësve që erdhëm prej Pejës. Domethanë, kemi qenë në dy objekte kështu.

Kjo jeta kolektive krijon atmosferë të veçantë, osht’ shumë ma e ngrohtë, shumë ma... edhe ma formuese. Ka lloj-lloj tipash që edhe të ndihmojnë, janë të gatshëm me t’u gjindë edhe në momente të vështira, të rana. Edhe për shkëmbim të librit, të mendimit edhe gjatë debatëve, të formon vetvetiu ajo mënyrë e jetesës.

Aurela Kadriu: Çfarë kujtime kenë? Kisha pasë qef meqenëse e përmendet sa e rëndësishme është lidhja kolektive, me na tregu nëse mbani në mend ashtu tregime të caktume, kujtime të caktume.

Zenun Çelaj: Ka, kom edhe të idhta edhe të kandshme (qeshë). Ni... unë prapë vazhdojsha të isha ma i vogli se ashtu masi... po isha edhe me trup ma i vogël edhe me moshë. Gjithnjë flitet për gjeneratën që kish dalë menjëherë mas luftës. Ajo ka mbledhë fëmi që s’kanë mujtë me u shkollu përpara për shkak se edhe s’ka pasë shkolla edhe për shkak të luftës. Kështu që, kish edhe 20 vjeçar që ishin në klasë me mu gjashtë vjeçarin. Po flas për filloren.

E kjo vazhdonte, ky proporcion edhe tash në shkollën e mesme kur mrrimë. Edhe ni drejtor i internatit se ashtu i qujshim konviktet, në atë kohë ishte ni gjakovar Sylejmon Domi, ni luftëtarë atëherë natyrisht, luftëtarët i kishin pozitat. Edhe kishte ble lakna me shti turrshi për internatin (qeshë). Dy aso tinar të mëdhenj. Objekt si kasolle ka qenë të atë oborrin me avli ...

Aurela Kadriu: Si hambarë.

Zenun Çelaj: Jo, kasolle hesapi shpijat që janë në Gjakovë e Prishtinë me avlija që kanë qenë, me dyrë të mëdha. E i kishin shti laknat në ato tinar të mëdhenj. Ato kush e di sa kilogram, 500-600 a s'po di sa me thanë, sa kjo. Edhe kur shkoi drejtori shkoi edhe ai administratori, mbetëm veç na nxanësit në internat. Msym me hangër lakna edhe vjedhëm lakna, hongrëm. Kur të nesërmen erdhi ai i pa u bo nervoz. Ishte shumë i ashpër.

Edhe ai ndoshta s'ka guxu me u matë me këta të rriturit, por me mue. "Ec ti kha, shpejt!" Shkova une, "Pse ke... a ke hanger lakna?" "Po" thashë, mos me rrejt. Tha, "Shpejt me ikë. Merre valixhen e me ikë prej internatit". Ku të shkojë une i gjori. Ishte ni, ai, na e thirrshim regjisor në atë kohë, po sekretar. Gjithçka ka qenë, arkatar i internatit se s'kishte. Pos kuzhinjerëve edhe këta dy ishin, drejtori me qita. S'di a ke ni, Riza Binishi ka qenë baba i tij, ma vonë e kom ditë se u bona baxhanak mandej me me Rizan, ashtu më ndodhi.

Edhe ai, shumë i erdh keq që... une e mora valixhen e disha që e kom, osht' ni njeri që ka ni kusheri timin ilake, thashë po e lypi, shkoj te ai ni natë edhe e shoh. Dola, i thonë deri në çarshi të vogël, me valixhe. E ranë ajo e drunit, atëherë s'kish këso. Kur p'e ni këtë regjisorin si i thojshim na, "O Zenun, kthehu mbrapa" u ktheva mrena. Ai tha, "E binda disi, po të fal. Po të fal kësi heri".

E ai m'u kërcënu, tha, "Edhe niherë me bo me bo diçka, baju". Kjo ishte ajo pjesa e idhtë. Pjesa tjetër qesharake, komike që ishte, kishim ni edukator ka qenë ni, Sami Bashota, gjakovar, vendas. Ai thoshte se ka marrë pjesë si pioner në luftë, atëherë ishte në modë me thanë. Si me thanë, sikur edhe sot që thonë në luftën e UÇK-së, atëherë në luftën Nacional Çlirimtare. Në atë shtëpinë ku banojshim, se ishte internat, aty s'kishte ujë e këto ishte ni si, me thanë si hamamxhik¹. Aty kishte, kishim marrë knata, p'e din çka janë?

Aurela Kadriu: Po, po.

Zenun Çelaj: Edhe prej atyne furnizoheshim. Prej bunarit i mushim për me pi ujë. U kry, kishim orët e mësimi mas darkës duhej prej orës 7 e gjysë deri në 9 e gjysë orë mësimi. U ulshim secili me mësu. U kry ora e mësimi t'u dalë, ai edukatori u kërrus me e marrë kësi ujë me mushë, i Junikut ishte ni nxanës e me gisht kështu mrapa {tregon me duar}. I ra në prapanicë (qeshë). Ai u ngrit kështu edhe njeriun e parë... se ai që i ra ishte një i Pejës, ai eci shpejt kurse ky që nuk i kishte ra mbeti mrapa, ky i Junikut. Ky shapullë atij *bam* {onomotope} "Pis bre. Mua luftëtarit po i bjen".

Po du me thanë, e na krijoi natyrisht të qeshme. Kemi qesh mandej gjatë studimeve se u ribashkum mandej edhe në fakultet këtu në Prishtinë. Po thom, ka kësi kujtimesh. Ose, tjetrën herë m'ra... nuk më kishin mrri paret prej babës që punonte si thashë në Mal të Zi që të më shkolloj mu, punëtor fizik. Edhe ai koriri që atëherë e binte postën e paret i merrte në postë, ashtu në atë kohë. Çdo ditë e pytsa, "A erdh? A erdh?" E kisha ni shok të... dëgjom, mos p'e zgjati une se shumë...

¹ Banjo e vogël brenda dhome.

Aurela Kadriu: Jo, jo pa problem.

Zenun Çelaj: E nga Strellci i Pejës ai kishte gjendjen e mirë materiale krejt, e m'jepte pare kështu për me pagu se duhej me pagu internatin, nuk ishte pa pare. Edhe u bon dy muj, u vonun paret edhe m'thonë me dalë. Por, dul edhe ky, se edhe ky shoku kish mbetë pa pare. Kah të shkojmë? S'kishim as ku me hanger. Por, ai kishte orë, une nuk kisha as orë. Edhe shkum atëherë me ni ëmbëltore "Gexhra" s'e kom haru asniherë.

E shkum te ai. Tham, "A ban me hangër diçka?" Se ishim unshëm. Tha... se me fjetë na la po me hangër s'ka. E dukej se ishte si formë presioni. Këta shoktë... po nuk kishte bukë mjaft edhe në internat atëherë. "Qe p'e la orën peng" e la ai orën peng e hongrëm ni ditë, e dy. Mas dy ditësh ai koriri kish ardhë në internet tha, "T'kanë ardhë paret". Shkum ia pagumë atij edhe ai e kish rujtë orën, çka po di. Po du me thanë, ka kesi momentesh, ka gjithëfarshe.

Aurela Kadriu: Para se me dalë te kjo koha kur vini në Prishtinë për herë të parë, dashta me iu pytë a ekziston... se ma herët e përmendet se ju keni qenë i pari që është shkollu prej familjes...

Zenun Çelaj: Prej familjes, po.

Aurela Kadriu: A ka ardhë presioni prej jush për me vazhdu shkollimin? A ka ardhë prej babës?

Zenun Çelaj: Tash, unë... në atë kohë edhe më kanë thanë se kam qenë nxënësve ma të mirë edhe pse ma i vogli. Edhe ai, msusi, si të thashë, Ahmet Rexhepagaj, që ka qenë kusheri i këtij Jashar Rexhepagaj, ka qenë akademik para pesë-gjashtë vjetëve ka vdekë, i kësaj këngëtarës ka qenë baba, Rexhepagiq. Na e thirrshim Rexhepagaj. Atij i lakmojsha gjithmonë se si veshej, do rrobe t'mbyllta, kmishë t'bardhë, krevatë, këpucë të zeza. Thojsha, ku me pasë me u bo si ky. Kjo ishte... (qeshë) një prej inspirimeve.

Po edhe baba. E ka pasë ni medrese të ultë t'kryne edhe gjithnjë m'thoshte, "Duhet me u shkollue". I pata thanë, "Çka ki qef?" M'ka pasë thanë, "Une kom qef medresen po une e kom me borxh me të dhanë dije". Ni edukatë interesant që tash t'bon nervoz kur e ndëgjon prej njerëzve të arsimun, po mendoj prej branshës [degës] fetare që thojnë vetëm Muhamedi, vetëm xhamia, e vetëm kjo... e ai jo, thotë, "Une kom me borxh me të dhanë dije".

Edhe kjo po ashtu më stimuloi. Domethanë, kjo ka qenë motivi i parë pse erdha në shkollë. Plus edhe perspektiva aty në vend ishte me të vërtetë... kur u rrita pak ma shumë fillova të mendoj edhe këta. Unë mund aty të bëhesha vetëm bari ose bujk asgja tjetër, s'kishe ndonjë shansë tjetër. Prandaj edhe duhej të mësojsha ma shumë, që mos t'i kthehem atyne profesioneve.

Aurela Kadriu: E vëllezërit edhe motrat e tjera a janë ma t'vegjël se ju a ma të rritun?

Zenun Çelaj: Jo, t'gjithë kanë qenë ma të mëdhenj. Motra ma e madhe, ajo nuk është arsimu, ma vonë, kurse... se është e martune në Kosovë. Ka qenë e martune ma herët. Në kurset për analfabet ka mësue shkrim leximin po nuk ka arsimim. E motra e dytë, si të thashë, ka vdekë në Amerikë, ajo ka qenë me mu në ni klasë edhe ka qenë nxanëse e shkëlqyeshme po jo me vazhdu shkollën, as tetë vjeçarën ma as... po, që ka lexu ndërkohë kështu vet.

Burrin e pat'... e martun me ni emigrant prej Shqipnisë edhe, edhe ai i ngritun kështu që domethanë eci, iu hapën dritaret. E ky vëllau, ai katër klasë të krye në serbisht në atë kohën e Relës si të thashë. Po duket se ato katër klasë kanë qenë shumë të randësishme. Edhe kur ai mandej erdhi në Prishtinë, e kreu tetë vjeçarën, me kurse shkollën e naltë. Ka punu në "KosovaFilm" si distributor.

Aurela Kadriu: E tash, po du me dalë te ni fazë tjetër, hapi i parë kur ju vini në Prishtinë osht' goxha ndryshim në jetën e ju. Po më intereson kur keni ardhë?

Zenun Çelaj: Tash ikja nga Prizreni, me iu tregu motivin, është pak për axhemillëk po ashtu ndodhi. Në orë të psikologjisë, na mbante ni malazeze në atë kohë se shumë landë deri në atë kohë s'kishte kuadra shqiptare. Ni Mira Mijoviq, s'ia harroj as emrin, na shpjegonte për ndikimin e faktorit të natyrës në formimin e karaktereve, s'di a keni mësua ju psikologji a jo, po... edhe ndër tjera po merr shembull, shembullin e malazezëve.

Tha, "Për shembull ata janë amuzikal se janë t'rritun në naltësi mbi detare, bjeshkë, fryn stuhi shumë, nuk kanë ndjenjën e zhvillune të toneve për shkak se ato humben nga era, stuhitë. Domethanë, u hupë ajo ndjenjë". Edhe unë, se punë axhamie, serbisht po i them "*I gluplji su*" [Dhe janë më budallenj] prej vendit, se serbisht msojshim, "Edhe ma budallë, ma të marr janë, ma trashaman" përkthimi.

Ajo edhe ka qenë ni shumë si shtrigë kështu, tha, asgja, as me bërtitë as hiç kështu, tha, "Dil përjashta". Dola unë përjashta, prej nxanësit të shkëlqyeshëm të gjitha landtë që i mësonim serbisht dysha, se dysi ka qenë jo notë kaluese. E ashtu marova gjysëm vjetorin me nja pesë gjashtë dysha që s'ishin kalues. Hajt thashë mas gjysëm vjetorit ndoshta ndërron puna, kur filloi i njejt avaz. Edhe une s'disha, këtu në Prishtinë e kisha veç Rexhep Qosjen edhe Hasan Mekulin që ishin prej anës sime edhe letër se atëherë s'kishte telefon mundësi.

I shkruaj letër, "Jom në këtë situatë, o' ka me përsërit landën o'... a thu mund të vi në Prishtinë?". Edhe kishin bisedu, më pranun ktu në Prishtinë edhe vazhdova. Po në Prishtinë une kom qenë edhe kur kom ardhë me u regjistru për herën e parë në shkollë të mesme prej atjehit i bjen '55-shin, '56. Erdha po, taman dojsha të regjistrohem... e ni që ishte këtu nxënës, ni, Hasan Xhekaj ka qenë hendbollist numër një në Kosovë.

Më tha, “Në mujsh nalu në Pejë se e ke ma afër. Këtu larg s’ke... me mbetë krejt s’ki kujt me iu drejtu”, a din, se nuk e kishim kërkond të afërt, atje megjithatë lëviznin njerëzit. Kshtu që u nala në Pejë, u ktheva në Pejë, u regjistrova. Domethanë, hera e parë ishte kjo e mandej erdha kur ika prej Prizrenit këtu.

Aurela Kadriu: Me çka erdhët herën e parë?

Zenun Çelaj: Herën e parë me tren prej Pejës se atëherë autobusët kanë qenë tepër të rrallë edhe e vetmja mundësi ka qenë me ra nga, nëpër Istog ka Gjyrovci e me ardhë në Mitrovicë rrotull andej ose me shku nëpër Gjakovë, Prizren e me u kthye në Prishtinë që ishte shumë ma larg. Kështu që... e treni ishte rruga ma e shkurta. E natyrisht prej Prizrenit me autobus kom ardhë këtu, po.

Aurela Kadriu: E stacionin e trenit a e mbani në mend këtu në Prishtinë qysh ka qenë?

Zenun Çelaj: Po, kështu si është tash natyrisht ma i pa pastërt se e kom pa ni ditë, kom shku bashkë me... ta shikoj, ishte kështu i pastërt, i rregullum. E atëherë ka qenë shumë i pa pastërt, ato dyshemetë të lyne me t’zift, sigurisht që t’mos mbesin, që t’jetë nifar’ izolimi nga balta njerz të që kanë qarkullue. Domethanë, ky që është tash. Se ai është i ndërtun, m’doket atëherë kur është ndërtu 19... kushedi, m’u ka ngatërru si datë kur ka ndodhë.

Aurela Kadriu: Qysh e mbani në mend Prishtinën qat’ herën e parë kur keni ardhë edhe mandej, nëse muni me m’kallxu herën e dytë kur keni ardhë a ka pasë ndryshim?

Zenun Çelaj: Po, kishte ndryshim. Ndërsa herën e parë kur kom ardhë kjo ndërtesa tash ku është Kuvendi i Kosovës ka qenë vetëm ni krah i ndërtun, kurse ma poshtë ku osht’, mendoj, kjo përmendorja e Vllaznim Bashkimit, si është qujtë tash Trekanëshi, po edhe ajo pjesa poshtë ka qenë ni qendër zejtare tregtare me thanë, e mbulune krejt. Me zanatli, me do shitore. E mbaj në mend si nëpër mjegull se si ka qenë e mbulune, m’dukej e çuditshme po shumë ka qenë me pluhën, shumë ka qenë e papastërt.

E di se në të dy antë kishte shumë kësi dyqanesh zanatlish, kësi kovaç, teneçegji, argjentar e ishte goxha e madhe. Mund t’ketë pasë... tash sa man në mend ni 15 vjeçar edhe që është për herë të parë në ni qytet. Kështu, mund t’kenë qenë 20-30 ndoshta dyqane aso kandesh.

Aurela Kadriu: Kur po thuni prej përmendorës a po thuni prej përmendorës e knej apo...

Zenun Çelaj: Jo, ajo hinte prej përmendorës, jo kah është komuna po në këtë pjesën ku është tash ka qenë kjo, osht’, cila është tash, ajo për tatime, jo për tatime për...

Aurela Kadriu: “Gërmia” ku ka qenë?

Zenun Çelaj: Jo, “Gërmia”, jo “Gërmia” ishte OSBE-ja, s’di kush ka qenë aty ni ndërtesë e bukur që është përballë ndërtesës së kuvendit knej {tregon me duar}.

Pjesa e Tretë

Aurela Kadriu: A ka qenë qiky që i thojnë tash pazari i mlum?

Zenun Çelaj: Tash, ku... jo atje jo, ajo është larg shumë. Kjo vjen krejt knej te Kuvendi i Kosovës. E din ku ka qenë posta e vjetër?

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: Që është bombardu e nuk është ma? Eh, domethanë në atë drejtim vinte, e aty te posta e vjetër si e kemi qujtë që është bombardue, aty fillonte mandej ni, që në atë kohë ka qenë korzo, aty nuk hynin veturat. Kanë qenë restaurante, disa restaurante, librari edhe në anë të majtë ka qenë stomatologu, ka qenë ni, e qujshim kopshti veror. Këto edhe ma vonë kanë qenë, shumë vonë kanë qenë këto që po iu thom une tash, që po i përmendi.

Aurela Kadriu: Çka ka qenë ky kopshti veror?

Zenun Çelaj: Si restaurant, po ka qenë ni me kopsht. Ka pasë restaurantin, verës sidomos, jo sidomos po verës kryesisht funksiononte, kishte edhe këngëtarë, këngëtare në të vërtetë, vishin prej Serbie se na s’kemi pasë atëherë, shqiptarët nuk knonin nëpër restaurante (qeshë).

Aurela Kadriu: Kur erdhët për me shku në shkollë, mandej ku keni banu qat’ vit?

Zenun Çelaj: E atëherë kom fillu, ma s’pari ka qenë ni han². E dini rruga “Bajram Kelmendi” ku është?

Aurela Kadriu: Po, po.

Zenun Çelaj: E m’doket aty në atë udhëkryqin...

Aurela Kadriu: Ku është xhamia aty?

² Ndërtesë pranë udhës ose në qytete që shërbente si bujtinë për udhëtarët e që kishte edhe vend për kafshët e tyre.

Zenun Çelaj: Jo, ma naltë, shumë ma naltë, ma naltë, shumë afër shpisë ku e ka Bajram Kelmendi në qoftëse e din. Ajo rruga që e ndërprejnë këtë rrugë që në atë kohë kalonte Vellusha, gjithnjë nëpër këtë pjesë. Tash ajo rrugë e lidhë parkun e del kha te shkolla, te ish “Rilindja”, te Muzeu knej...

Aurela Kadriu: Te “Sami Frashëri”?

Zenun Çelaj: Po edhe te “Sami Frashëri” po edhe kjo shkolla fillore përpara që osht’...

Aurela Kadriu: “Elena Gjika”?

Zenun Çelaj: “Elena Gjika”. Domethanë në atë udhëkryq ku ndahet kjo në kand ku shkon përpjetë në të djathtë ka qenë ni han. Aty kom flejt disa vjet vetëm në drrasa se derisa gjeta mundësi me u vendos dikund. Ishte lirë prandaj edhe...

Aurela Kadriu: Qysh e ka pasë emrin?

Zenun Çelaj: {Rrudhë krahët} s’e di, veç ne han i kemi thanë, nuk e di (qeshë). Tash është ndërtu, s’di çka ka aty, osht’ ndërtesë e re në atë kand aty. E mandej kom gjetë njo me të Shkollës Normale, dy, dikund kanë qenë të Milloshevi knej që iu kom harru edhe emrat. Fatkeqësisht janë shumë vjet (qeshë). A din ku është kisha serbe? Ku ka qenë naltë që shkohet për Gërmi?

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: Që është ni pompë e benzinës, aty te kjo kuarti kinez që i thojshim, ni furrë që është aty në kand, përmi kuartin kinez...

Aurela Kadriu: Po, po, po.

Zenun Çelaj: E tash, mas saj osht’ ni ndërtesë, vazhdon të jetë. Aty ka qenë ni dritare ma e madhe e i zoti i shpisë, ni prishtinali, nuk na lente me hi, as ata as mua, me hi nëpër derë se kishte familje po duhej me hi nëpër dritare aty me flejt (qeshë). Aty ishte e shtrume me kashtë e mbulune me ni plaf edhe kashta, edhe jastëktë ishin qasi me kashtë edhe qaty flinim. Dilnim mandej nëpër dritare, i ofrojshim dritaret qashtu. Ndërkohë më pranun në internat, mas, jo shumë gjatë, mas nja ni muji e diçka. U pranova në internat në saje të Hasan Mekulit. Ai ishte profesor në normale dhe autoriteti i tij ndikoi.

Aurela Kadriu: Çfarë lagje ka qenë qajo ku ju po flisni përballë kuatrit kinez?

Zenun Çelaj: Qe tash, kur shkon përpjetë, mas kuatrit kinez rruga kthen te shtëpia e pleqve djathas, e tash p’e din aty ku kthen djathtas, përballë është ajo, qikjo që të thashë furra, se di si e ka emrin, “Saranda” m’doket...

Aurela Kadriu: “Saranda”.

Zenun Çelaj: S’e di si quhet. E mas kësaj furre aty ka qenë kjo shtëpia, kjo ndërtesë. Edhe tash osht’. E vjetër osht’.

Aurela Kadriu: Po qysh ka qenë atëherë po thom se qato janë disa prej ndërtimeve të para në qytet.

Zenun Çelaj: Eh, shiko, se tash kjo, ky blloku i parë iu kanë thanë ktyne ndërtesave që janë, osht’ edhe ni çerdhe aty te kuatri kinez në të djathtë. Gjithnjë flas sikur po shkojmë përpjetë. Ka qenë blloku i parë... aty ishin më intelektualë, ka pasë mjaft serbë në atë kohë se ata i kanë marrë banesat në Prishtinë, të ndërtume prej shtetit. E lagjes nuk e di si i kanë thanë. Në të majtë kanë banu serbët, se e di, ma vonë si gazetar kom banu aty. Tash është, “Meridian”, a s’e di si quhet aty ni objekt me xham, i mbulum osht’. Edhe ai stacioni i autobusit ku pritet. Ajo rrugë ka qenë e ngushtë, gjithnjë deri në Gërmi naltë. Deri te Normalja ka qenë e shtrume me kalldrëm, gurë kështu edhe e ngushtë. Aty nuk do të mund të ndroheshin dy automjete se s’ka pasë hapësirë deri te Normalja.

Aurela Kadriu: A ka ekzistuar jeta... po mendoj, ju si të ardhun prej vendeve tjera, a keni dalë në çarshi?

Zenun Çelaj: E atëherë në internat, na kem pa... ka qenë si regjim ushtarak. Aty nuk t’lejohej me dalë kur don ti n’qytet. Ke pasë mundësi me listë me dalë niherë në javë. Niherë në javë, po. Lejonte niherë në javë. Të dielën, se të shtunën ishte ditë mësimi. Po mundej në mramje me lanë, eventualisht naj grup me shku me pa naj film të rrallë, me lista sajoheshin ose... e kështu në qytet me dalë t’jepte leje, pesë-gjashtë vetë, shtatë-tetë vetë me dalë në orë të caktume. Ma së largu deri në 10:00 mund të lejohej ma vonë s’kishe të drejtë.

Aurela Kadriu: A keni shku me pa filma?

Zenun Çelaj: Po, kom shku edhe në atë kohë... unë në Prizren për herë të parë kom mathë këpucë (qeshë). E këpucë që... shokëve iu kom tregu e tash qeshin edhe bojnë mahi në këtë hesap. Kur dola me ble këpucë... se mora për herë të parë bursë, kisha marrë shumë pare se që m’duheshin për me pagu internatin në Prizren.

Dola në pazar, po shiteshin këso gjana, gjana të vjetra e i pash ni palë këpucë që m’u duken ma të rujtuna, ma të mira. E ai plaku që m’i shiste betohej se vetëm ni plak i ka mathë, kërkush tjetër. Për me tregu që janë të rujtuna, t’forta. E tash, kur erdha në Prishtinë, por jo atë vit, po në vit tjetër, për herë të parë atëherë shku me ble të gatshme, ishin shumë të shtrenjta...

Aurela Kadriu: Të reja.

Zenun Çelaj: Të reja po se po, po në dyqan me i ble ishin shumë ma të shtrenjta se me i porosit me i ba të reja me këta saraçët, mjeshtrit privat. Ka qenë ni, Gojani, që e kanë vra me 12 qershor, e kanë vra serbët në shtëpi t'vet. Mas restaurant “Rugovës” e ka shpinë aty, është ajo shtëpia “Pjata” s’e di a p’e dini, ni restaurant, e pronari i asaj shtëpie. Ai kishte atë dyqanin e vet, Saraçit, e kom porositë. Ishin në modë këpucë shpic, e une kamën e gjanë si të arushës, si të majmunit.

I matha, menja jeme, me shitë mend. Prej Normales deri ktu në kam, kur hym në kinema ishim me shokë e shoqe, kush ishim, i hoqa se m’shtrengoishin për vdekje. E kino “Rinia” i bjen qitu përballë, s’osht’ larg. I hoqa, po tash kur erdh koha me i mathë s’mujsha me i mathë. Edhe dimën ishte dikund, mund të ishte ose fundi i janarit ose shkurtit. Domethanë, me çorapë, dathë nëpër akull prej këtu deri në Normale (qeshë).

Aurela Kadriu: Çfarë filmi e kqyrshi a të kujtohet?

Zenun Çelaj: Jo, e kom harru. Me kauboj, këto i kqyrshim ma së shumti në atë kohë. S’e mbaj në mend cili osht’. Po kujtova që po më thu si film, se kur iu tregojsha fëmive t’mi kto ngjarje, dojsa me iu tregu që të mësojnë se jeta nuk është e lehtë. E ata aty, “Babë, film po na kallxon a?” (qeshë)

Aurela Kadriu: Shumë tregim interesant. Kisha pasë qef me fol për ambientin mrena në shkollë. Tash, ju Normalen e pasni përjetu në krejt format e saj...

Zenun Çelaj: Po, apsolutisht qashtu osht’.

Aurela Kadriu: E tash qysh ke në Prishtinë, Normalja?

Zenun Çelaj: Objekti i Normales, nuk e di a din ai, fillimisht ‘47-shin ‘48-shin dikund është ndërtue, sa kom dëgjue, edhe kom lexue. Për me bo ni qendër ku do t’i stërvisnin diverzantët që do t’i çonin në Shqipni, UDB-ja jugosllave në atë kohë. Po mandej, në ndërkohë, ka ndryshu politika nuk kishte nevojë ma as për diverzantë as për me dërgu atje fëmiun edhe çka do t’bajmë, p’e bajmë shkollë, Shkollë Normale.

Kështu që, ni pjesë e objektit, është objekti i madh qikjo që osht’ tash nuk ka shtojcë hiç, pos që është rregullu kjo pjesa ku është AUK-u. Ajo ka qenë pjesë, internat, kjo pjesë tjetra ka qenë shkolla, klastë. Edhe mrapa kjo që është në mes të tyne ka qenë menza e shkollës ku ushqeheshim, mrapa janë, s’e di a i ke pa, janë nja dy objekte t’vogla, ma të vogla aty rrinin edukatorët e internatit si zyre edhe drejtori i internatit.

E tash knena në internat ku ishim të vendosun na si nxanës, ato dhomat kanë qenë të mëdha. Tash nuk di s'kam hy masiqë u ba fakultet amerikan. Po atëherë, për shembull, në ni dhomë kem qenë edhe 30 vetë. Kreveta të telit të ushtrisë edhe nga dy kat ndodhte me qenë. Ato banjot kanë pasë ato çeshmet e veta për me pastru ftyrën e kështu. Kurse në bodrum krejt kanë qenë këta dushat ku laheshim na në mënyrë të organizume. Nxanësit e vitit... ma vonë kjo u ba, se në fillim laheshim në qit hamamin qitash që s'vyn, se kanë nisë me rikonstrukt u e s'po rikonstruktohet.

Aurela Kadriu: Po a?

Zenun Çelaj: Po. Prej atje vishim rresht, ka 20-30 vetë laheshim, të pshtjellun, dimër e verë deri në Normale (qeshë).

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë hamami? Se tepër interesant po më vjen. Kurrë s'e kom... hala s'e kom taku dikond që u la në hamam.

Zenun Çelaj: Po. Ishte... ka qenë ni pjesë si rrethore kështu, uji vinte prej ktyne çepave naltë. Ni pjesë ka qenë për femra, ni pjesë për mashkuj. Ai ta lshonte ujin, ti s'e kishe kontrollin me lshu ujin. Po ai bërtitke prej atje ku e kish atë kazanin, "Po e lshoj ujin tash, keni kujdes se niherë vjen ftohtë". Edhe qishtu (qeshë). E mandej i adaptun se ishte përnime problem me... se na shumë ishim, 400-500 vetë e tash duhej ka 20-30 vetë, s'kishte mundësi ma shumë në hamam me u la. Atëherë i adaptun në bodrum atje, na i banën si dusha kështu.

Aurela Kadriu: Uau, shumë interesant. E klasa qysh ka qenë?

Zenun Çelaj: Klasët, kemi qenë shumica mashkuj. Në brezin tim kemi qenë pesë klasë, domethanë kur kom mrri une këtu në klasën e tretë Normale. Po kom ardhë dikun, thash kah marsi i '57-tshit. Kanë qenë njo gjashtë-shtatë vajza. Tash s'mund t'i numëroj po dikund rreth 35-36 vetë në ni klasë. Kanë pasë klasë që nuk kanë pasë hiç femna, asni. Po klasa ime që kom qenë, pesta një si i thojshim, ose e treta një, e katërta një, edhe e katërta dy, kem pasë ma shumë. Po ndoshta gjashtë-shtatë vajza tjera s'ka pasë.

Aurela Kadriu: A mendojshit ju sa keni qenë në Normale me vazhdu gazetari, a ndodhi spontanisht?

Zenun Çelaj: Jo, as andërr nuk kam pasë pa t'bahem gazetar. Krejt... andrra jeme ka qenë të bahem mësues edhe kur erdh, e mbaj në mend edhe kush ka ardhë, Musa Murtezai ka qenë ni zavendës kryeredaktor i "Rilindjes" në atë kohë. Ma vonë ka qenë kryeredaktor i televizionit të parë shqip kur u themelu. E ma vonë, shëf i kabinetit të Fadil Hoxhës në Beograd.

Kishte ardhë në Normale, jo veç në Normale, por në të gjitha shkollat e mesme në Kosovë, ka bisedu me profesorët e gjuhës shqipe. Ata me tregu që ka ndonjë talent, ka dëshmu me hartime, kaq. Edhe mu ndër tjerë më kishin propozu ai profesori jem, ka qenë ni Demush Shala...

Aurela Kadriu: Veç po të ndërprej pak, ju filloni me punu në “Rilindje” para se me fillu me studiu gazetarinë?

Zenun Çelaj: Unë gazetarinë s’e kom studiu asniherë, unë kom studiu albanologji.

Aurela Kadriu: Aha, atë ditë që ma përmendët që keni studiu qata...

Zenun Çelaj: Po, po, para studimeve. Ende pa e kry Normalen kanë qenë edhe ni muj e diçka që duhej me hi në ato provimet, se kanë qenë disa provime të maturës që i qujshin në atë kohë. Tash më duket nuk ka aso provimesh...

Aurela Kadriu: Ka, ka.

Zenun Çelaj: Ka a? Eh e di se kjo është konë hjekë nihere. Dy a?

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: Jo, atëherë i kem pasë gjashtë a shtatë provime. Me shkrim, me gojë të gjitha para komisionit që nuk ish i shkollës. Duhej të vinte prej, atëherë s’ka pasë ministri, po i thojshin Sekretariati i Arsimit. Edhe, domethanë kishte ardhë e na thirrën ne. Ende ishin përgaditjet për provim të maturës, na thirrën në kurs. Atëherë kurs i qujshim këto trajnimet e famshme tash. Në “Rilindjen” që është, përballë muzeut, rruga i ndan, tash, mandej ka qenë gjykatë, tash është Ministria e Diasporës, në anën e djathtë...

Aurela Kadriu: Në të ‘60-shin a?

Zenun Çelaj: ‘60-shin. Aty mbajtëm atë kursin edhe masi u kry kursi na thanën, “Ju lajmërojmë kush është pranë, kush nuk është pranë”. Kishim provime me gojë e me shkrim mas atyne ligjeratave. Kur më erdh letra në Shkollë Normale, “Duhet me lutje të kërkosh që je pranë, por duhet lutje të shkrujsh”. Unë nuk mendojsha se jam për gazetar, se tepër shumë e idealizojsha profesionin.

Me Nehat Islamin, se di a p’e njeh? Ai ishte gjimnazist, po ai si gjimnazist edhe pse ma i ri se unë, [ishte] marrë me shkrime në shkollë fillore e mandej edhe në gjimnaz. E kishin rekrutu me i përgatit faqet e fëmijëve në “Rilindje”, qita të përditshmen. Kështu që ai aty ish ba si i shtëpisë edhe pse fëmijë edhe ai. Edhe thotë, “A din se je pranë?” Thashë, “Po veç s’du me shkru lutjen”. Thotë “Qysh jo more?” “S’du se s’jom për atë punë”.

Ai e kish bo lutjen në emën temin. Kështu që, unë as lutje s'kom shkru vet për me u bo gazetar. Edhe më erdh thirrja, "Je i pranum me u paraqit". Edhe u ndryshova une, pranova. Por, po të thom kom detyrim se atëherë në ndërkohë mora bursë për me shku... në atë kohë kush merrte bursë në sekretariat, ministri te quj e arsimit, se nuk është qytë kështu. Ajo të sistemon, të çonte ku don vet në punë, jo ku ke qef ti.

Edhe mu më kishin caktu në Brodosan te Dragashi atje me u bo mësus që e kryjsha shkollën. Asllan Fazlija, i ndjerë tash, ni burrë i jashtëzakonshëm, ai kryeredaktor i "Rilindjes". Edhe më thërret, "Çuni", çuni e kishin zakon, "çka ke obligime?" Thom, "Qishtu une duhet me shku m'ka ardhë thirrja". Se më erdh thirrja me shku në shërbim. Tha, "Ti mos u paraqit, une e kryj këtë punë". Edhe çka ka bo ai nuk e di, s'kom marrë ma thirrje.

Aurela Kadriu: Ju a kishit qef ma shumë me shku për mësus?

Zenun Çelaj: Tash mbeta. E kisha idealin mësus, po fillova me mendu për gazetari. Tash, natyrisht ma tërheqëse, në qytet, rroga ishte katër fish ma e madhe se e mësusit. Unë si gazetar fillestar e kom pasë rrogën katër fish ma të madhe se profesori që më kish propozue me ardhë gazetar. Kur më pyeti, ai Demush Shala, tha, "Zenun, sa e ke rrogën?" E unë e disha sa e ka ai. Thashë, "Valla po më vjen marre me të kallxu". "Pse?" "S'du me të tregu". Po i tregoj, ai u mahnitë. Ndërkohë, erdh edhe ai me punu aty (qeshë).

Aurela Kadriu: E qysh, si çka ia nisët? Si gazetar meniherë apo?

Zenun Çelaj: Si gazetar. Ka pasë "Rilindja" atë sistemin e punës t'vet të rekrutimit të gazetarëve. Ka qenë institucion. Flas kështu jo vetëm pse kom punu gjithë ato vjet aty, por me të vërtetë e tillë ka qenë "Rilindja". Ma së pari të çojshin në pazar me i kqyrë... ishte lajmi, raporti, sa janë çmimet sot në tregun e Prishtinës? Qepa kaq, patatet kaq, qe qikaq. Mandej për fatkeqësitë. Këtu ndodhi kjo fatkeqësi, këtu ndodhi kjo, këtu ndodhi kjo, këtu ndodhi kjo. Mandej me i përcjellë gjyqet, në gjykim. Ishin raporte të thjeshta. Atëherë nuk iu është leju gazetarëve, as gazetës me bo komente, as gjykime të veta, por veç pasqyrim. Po duket se u tregova shumë shpejt i suksesshëm se punojsha shumë me kompenzu atë që unë nuk kisha mendu ndonjëherë për gazetari. Ngjarjet e përditshme i përcillja veç ndonjë që mu m'ka interesu e jo çdo gja tjetër.

E në gazetari është nifarë rregulli thotë, "Gazetari duhet të dijë gjithçka nga pak". E mandej dikush e ka pasë plotësu, "Gazetari është një i padijshëm universal". Domethanë, din gjithçka ka pak e asgja tamon (qeshë). Po.

Aurela Kadriu: E qysh kanë qenë qito vizitat e para në terren? Se ju hala keni qenë i ri në Prishtinë e iu ka ra me vizitu pazarin...

Zenun Çelaj: Unë s’e di sa të hyjnë në punë këto, por po i rrëfej kështu si për vetë vetën. Për dy vjet në atë kohë, gazetarit nuk i lejohej me dalë shumë as në terren, vetun sidomos jo se jo, fillestarit, e as me u nënshkrue bile me emër e mbiemër të plotë. Duhej vetëm emrin, eventualisht mbiemrin nëse është një temë që e ke shkru pak ma mirë e ma me peshë. Kurse në faqe të parë të gazetës, faqet e para, aty duhej me i bo katër-pesë vjet gazetar për me fillu me u afirmu që të lejohej. Kështu ka qenë. E në ato fillime, fillimisht shkonim me ndonjë gazetar ma me përvojë që t’sheh se si po punon ai edhe paralelisht me të, eventualisht të gjejsh ndonjë temë tjetër.

Aurela Kadriu: Po vazhdojmë qatë që keni dalë me gazetarë me ma shumë përvojë.

Zenun Çelaj: Po. Ka qenë ni Mustafë Rushiti, tash ai ka shku në Amerikë, ni... ai përcillte në atë kohë Kuvendin e Kosovës, këto organizatat si i qujshim na politiko-shoqërore. Domethanë, Lidhjen e Komunistëve, Lidhjen Socialiste. Këta zakonisht me përcjellë këta i caktojshin gazetarët ma me përvojë, ma të formum. E shpesh më ka ra me dalë me ta. Ni ditë, verë ishte, ndoshta ‘63-shi edhe hyjmë në kuvend, njerëzit kanë shku në pushim, e ky shumë dreq ka qenë, ky Mustafa. Edhe pse një, si i kemi qujtë atëherë shumë i visë, po shumë dreq ka qenë nga shpirti.

Aurela Kadriu: E çka i bjen shumë i visë m’fal?

Zenun Çelaj: I visë së partisë. E ka respektu linjën partiake shumë (qeshë). Edhe hyjmë nga ni zyre në zyrën tjetër, ai dinte kush ku ka qenë, i çilte zyret me gjetë ndonjë material dikund për me pasë çka me shkru se s’kish. Kanë qenë institucionet shumë të mbylluna, nuk të jepshin informacion, nuk mujshin, s’të jepshin materiale. Edhe... mirëpo unë nuk gjeta kurgjo, u ktheva në zyre. Redaktori, “A ke diçka me shkru?” “S’kom,” thashë, “po shkoj në bazen”. Ka qenë bazeni tu shku kah Llukari. Medresen e din ku është ajo, atje dikund përpjetë ka qenë thuja fundi i katunit, tash ka hy në mes ai vend ku ka qenë bazeni. I vetmi bazen në qytet ka qenë.

Edhe rrisha unë, shkova me u la shkurt e shqip, me u rrezitë. Aty ishte edhe ni, ka qenë Abdyl Bunjaku, ni gazetarë atëherë “Zani i Rinisë”, i vetmi që ishte me rrogë në “Zanin e Rinisë” po shumë ka qenë komik edhe bonte edhe karikatura për “Rilindjen”, Anza quhej rubrika. Edhe po m’thotë, “He Zenun, çka ke ardhë?” “Pse Esat, çka u ba?” Unë tash me hajgare, thashë, “Kom ardhë me kqyrë mos po mytet dikush me shkru naj lajm, se s’kom gjetë temë”.

Të dillën dilke ajo faqja në “Rilindje”, ai e ka vizatue bazentin, mu... mu, nejse karikaturë po. “He, Zenun çka ke ardhë?” “Kom ardhë me kqyrë mos po mytet dikush që t’boj ni lajm për gazetën”. (Qeshë)

Aurela Kadriu: A e keni këtë karikaturë, a jo?

Zenun Çelaj: Nuk e kom rujtë. Atëherë, po thom, s'kom ditë me rujtë as s'jom kujdesë po është ajo, do të gjindej, osht' në gazetë dikund hala.

Aurela Kadriu: Në '61-ten a?

Zenun Çelaj: '63-shin mund të jetë edhe '62-shi nuk është çudi. Po, domethanë, janë këto vitet e fillimit.

Aurela Kadriu: Mandej a u profilizut ju si gazetar në ndonjë sektor të caktum? A qysh shkojke?

Zenun Çelaj: Po, kjo shkon, të thashë, ai sistemi që ka qenë ma përpara. Mandej më caktun me i përcjellë organizatat politiko-shoqërore në nivel të komunës. Edhe prapë kom përshtypjen se u tregova i suksesshëm, se njëmend punova shumë se nuk ia kisha besën vetit meqenëse s'e kisha mendu ma herët. Edhe mandej më caktun në ngjarje ma të mëdha. Më kujtohet niherë, ni prej atyne ngjarjeve që e kom pasë ma që e kujtojsh për ni kohë. Fadil Hoxha shkante për... kam harru cila, 9 korriku m'duket ka qenë që merrej si ditë e kryengritjes së Kosovës. Kosovës nuk ia patën lanë naj ditë se Serbia e ka pasë 7 korrik, Mali i Zi 13 korrik... i kom harru tjerat tash. Shyqyr që i erdh koha mos me pasë nevojë me i mbajt në mend.

Edhe m'thonë me shku me përcjellë Fadil Hoxhën në Carralevë, se në Carralevë ka krisë thojshin pushka e parë, Fadil Hoxha i ka dalë përpara ni patrolle italiane, i ka vra ata dhe ka qenë përmendorja. Edhe shkova unë, m'thanë edhe me fotografu. Kom pasë ni fotoaparatur shumë ma herët po shumë të thjeshtë, kurse redaksia ma dha një i thojshin fleksaret. Ka qenë si kuti kështu {tregon me duar}, aty duhej me kqyrë naltë m'u pasqyrue për me u përqendru objekti që don me fotografu. Ni fotografi që është përsëritë me vite të tana e Fadil Hoxhës t'u fol para tubimit të njerëzve edhe përmendorës. Po du me thanë, atë raport, ka qenë raporti kryesor me të cilin unë mandej thojsha, krenohesha, se edhe aty u hap rruga, u hap perspektiva ma e mirë.

Aurela Kadriu: E qysh... ma vonë kisha dashtë me na bo nifarë portreti të bartjeve të zyrave të "Rilindjes" në qytet.

Zenun Çelaj: Para se me ardhë në "Rilindje", para se me fillu punën...

Aurela Kadriu: Para se me ardhë te Pallati i Shtypit.

Zenun Çelaj: Po, jo këtu ku të thashë, këtu ku të thashë ka qenë...

Aurela Kadriu: Para se me ardhë në "Rilindje".

Zenun Çelaj: Po. Ajo ka shëtitë, redaksia e “Rilindjes”, kur ka ardhë prej Prizrenit, se në Prizren ka fillu ma së pari, ‘45-shin, osht’ bartë në Prishtinë. Institucionet e krahinës e bashkë me të e kanë pru edhe “Rilindjen” edhe Radion e Prishtinës, në atë kohë. “Rilindja” fillimisht ishte vendosë... si ma kanë përshkru edhe si shkruhet në historinë e saj, tash është parking përballë kuvendit, në atë anën anej kah muzeu. Osht’ bo si parking i madh, janë rrënu aty shpijat, ti nuk i mban në... a i mban në mend këto që kanë qenë, këto dyqanet, ndërtesat, këto afër rrugës që tash është bo dy katëshe?

Aurela Kadriu: Po, ato anej po, qaty janë edhe sot.

Zenun Çelaj: Jo, ato janë thellë shumë po këto kanë qenë afër krejt. Kanë qenë objekte, fatkeqësisht janë rrënu se atëherë kanë pasë ni arkitekturë, tipike të kasabave [qytezave] të kohës së turkut, se na ato ma të vjetra s’i kemi kërkund. Ka qenë e vendosun aty, mandej ka kalu në këtë rrugën si të thashë që ka qenë korzo që e qujshim na, që të çonte diku te ajo posta e vjetër, e ky kopshi veror aty ka qenë. E ndërkohë, se tu u rritë nuk ka mjaftu nga dy tri zyre kështu e kanë qit në atë ndërtesë, ajo ish burg ka qenë dikur. Burg edhe gjatë kohës së Shqipnisë t’madhe si quhej, e aty u adaptun ato zyre. Ka qenë ni ndërtesë e vjetër, ajo për fat të mirë nuk ka ndryshu. Fasadën e ka ndryshu, është ma bukur kështu e kanë ly, po jo edhe arkitekturën nuk ka ndryshu. Mrena e kanë ndryshue...

Aurela Kadriu: A osht, m’fal që po iu ndërprej, a osht’ qajo ndërtesa me xhama shumë?

Zenun Çelaj: Jo, s’ka xhama ajo hiç. Osht’ veç me dritare, kështu do dritare si...

Aurela Kadriu: Harkore?

Zenun Çelaj: Muzeun po e din knej që osht’...

Aurela Kadriu: Po, p’e di saktësisht ku po thuni po janë disa ndërtesa rend. Po më intereson, është njo aty me dritare të mdhaja.

Zenun Çelaj: Në fillim, ma e ultë. Po ajo vonë është ba, nuk i përket periudhës së hershme, osht’ pak para se me u shpërngul na prej “Rilindjes” me kalu në Pallat të Shtypit, aty ka qenë, rrotacion i thojshin asaj maqine ku nxirrej gazeta... kurse ajo është ma anej, osht’ me ni arkitekturë t’vjetër edhe do të ishte mrekullia me pas pasë forcë dikush mos me leju ndërtime tjera ku osht’ kjo, ky parkingu, po me bo farë parku, lulishte e m’u dukë objekti mrapa. Osht’ Enti i Statistikës, s’di çka osht’ aty.

Aurela Kadriu: Po, Enti i Statistikës është afër muzeut shumë, vetëm rruga i ndan.

Zenun Çelaj: Po, qikjo, vetëm rruga i ndan.

Aurela Kadriu: Kjo po m’duket diçka, nejse si agjension për mbrojtjen e trashëgimisë a diçka qashtu...

Zenun Çelaj: Ktu ku e kom pa shkrun Ministria e Diasporës, s’kom hy ma... ka qenë Gjykatë Komunale, ni kohë Gjykata për Kundërvajtje kanë qenë aty.

Aurela Kadriu: Po, po. E mandej kur ju fillutë me punu, a e mbani në mend a jeni bartë ma?

Zenun Çelaj: Jo, prej aty s’kemi lëvizë mandej, derisa kemi kalu në Pallatin e Shtypit.

Aurela Kadriu: A e mbani në mend? Se ju teksa keni qenë brenda në “Rilindje” me siguri është diskutu që po ndërtohet pallati?

Zenun Çelaj: Po, e dijsim na. Tash, ka edhe ni histori pallati. U nisë në disa vende, iu ka vu gurëthemeli e veç iu ka vu gurëthemeli e nuk është realizu. Ni prej tyne ka qenë... qitu osht’ kjo si quhet kjo? Ka qenë Klubi i Boksit, ky tuneli që osht’ mrapa saj i ka pasë kjo Flora Brovina do zyre ku...

Aurela Kadriu: Po, kjo shoqata “Nëna Terezë” që ka qenë, aty i thojnë Tophane lagjes.

Zenun Çelaj: Jo, Tophanja është ma thellë, kjo është ma naltë. S’di a po të kujtohet biblioteka që ka qenë, biblioteka “Hivzi Sylejmani” ma knej...

Aurela Kadriu: Ma afër rrugës

Zenun Çelaj: Jo hyn, ni oborr ka qenë ni objekt osht’ i vjetër edhe aty. Unë ka kohë s’kam qenë me të thanë të drejtën, qysh para lufte s’kam hy aty ma. E aty osht’ vu ma së pari gurëthemeli për “Rilindjen”. Fadil Hoxha e ka vu, po nuk osht’ ndërtue. Mandej e kanë vu ni gurëthemel dikun knej mas stadionit, jo po knej ma te lulishtja dikun qaty, prapë nuk osht’ ndërtue. Mandej kanë vu gurë themel ku osht’ tash “Grandi”, edhe gjithnji Fadil Hoxha.

Tash, ka ni histori interesante për këtë rast. Imer Shkreli, ni gazetar i “Rilindjes” ka qenë shkruante edhe humoreska edhe ai e bën njeriu me gurë në krah, humoreskën, edhe i përshkrun krejt këto, por pa e permend emrin e Fadil Hoxhës. Edhe ai bohet problem politik e përjashtun prej partie se ai u tallë me ta (qeshë). E tash, domethanë mas gjithë kësaj erdhi Ismail Bajra në krye të “Rilindjes”, ka vdekë edhe ai, edhe ai i hyni me shumë seriozitet po u ba projekti. U sigurunë edhe investimet edhe filloi objekti i Pallatit të Shtypit, ndoshta ‘70-tshi, ‘71-shi dikund. Ekziston kjo e dhanë, po tash s’po e kujtoj. Për katër-pesë vjet osht’ krye.

Shtypshkronja kaloi atje ma herët se kjo Pallati i Shtypit filloi ndërtimin ma vonë edhe pat’ probleme me ujëra nëntokësore, mandej rregullimi, interieri e këto. Kishte dilema, a me i nda... s’di a ke qenë në atë objekt ndonjëherë?

Aurela Kadriu: Po, po, kam qenë.

Zenun Çelaj: Nuk ka pasë askund pos ku janë liftat, se pjesa tjetër ka qenë krejt e hapun. Kështu që, e kemi ditë domethanë se po ndërtohet edhe ku do të jemi. Natyrisht i gëzoheshim asaj të gjithë se ishin kushtet prej ni dhome shumë të errët, ish burgut, që i kishte ato dhoma me të vërtetë edhe të vogla edhe të errëta. Tash kalojshim në ni objekt shumë modern, shumë të ndritshëm. Ka pasë atë *air conditioner* e vet mrena nuk kishe nevojë as me lëshu për ajrosje as kurgjo, të gjitha shkojshin me ato tubat nëpër, të shpërndam nëpër objekt.

Aurela Kadriu: Mandej bartja në objekt, a është ai momenti... a ka qenë edhe ma përpara sektorët e ndam? Demek gazetarët për kulturë...

Zenun Çelaj: Po, po, po. Vet organizimi i brendshëm... edhe tash ekzistojnë këto ndamje, janë gati ni ndamje klasike. Tash, pak ma ndryshe, po përpara ka qenë e ndame politika e brendshme, politika e jashtme, ekonomia, kultura, sporti, faqet argëtuese, faqet për fëmijë, faqet për komuna, faqja e kryeqytetit. Domethanë, këto kanë qenë të ndame si një njësi, po kështu ni ndamje ma, si me thanë, ma e trashë të quhej. Ka qenë politikë e jashtme, e brendshme, kulturë, sport.

Aurela Kadriu: A e mbani në mend ditën e inagurimit? A ka pasë ditë të inagurimit të objektit?

Zenun Çelaj: Nuk ka pasë.

Aurela Kadriu: A vetëm keni hy?

Zenun Çela: Vetëm kemi hy. Bile nuk kemi hy në objektin kullë, që e qujmë këtë pallatin, po kemi hi në këtë pjesën që osht' përballë, ku kqyrë knej ku osht' "21-shi", osht' "Zëri" tash gazeta e përditshme. Poshtë janë restaurantet, poshtë kanë qenë librari krejt ky kati përdhesë. Në katin mesëm kanë qenë zyre edhe kem pasë ambulancën e "Rilindjes" se ishte kolektiv i madh pat' mrri dy-tre mijë vetë të punësum. Ndërkohë në pallat, ose në atë, erdhën edhe redaksi të tjera, jo shqiptare domethanë, "Jedinstvo", "Tan" erdhen këto redaksitë e "Zërit", "Zani i Rinisë", nuk ka qenë deri vonë pjesë e "Rilindjes" po ka qenë shtëpi në vetvete. Me "Fjalën", me, "Gazeta e Pionerit", "Shkëndija", "Bati". Ndërkohë, ato u bonë pjesë të shtëpisë, shtëpisë "Rilindja". U qujtë ndërmarrje gazetaro-botuese, në kuadër të saj, të "Rilindjes" ishin edhe këto. Ishte edhe Rrjeti Librar, ishte shtypëshkronja e redaksia e botimit të teksteve jo shkollore...

Pjesa e Katërt

Zenun Çelaj: Ajo ka qenë shtëpi në veti. Tekstet shkollore po edhe letërsi, letërsia artistike. Edhe ajo ishte në kuadër, na e qujshim redaksia e botimeve.

Aurela Kadriu: Kisha pasë qef... a je lodhë?

Zenun Çelaj: Mund të vazhdojmë edhe pak (qeshë). Në qoftëse s'jeni lodhë ju.

Aurela Kadriu: Jo, jo. Une veç për juve e kom hallin.

Zenun Çelaj: Edhe pak po e shtyjmë. Te pakësojmë për herën tjetër (qeshë).

Aurela Kadriu: Po kom qef me folë... se para se me iu intervistë e kemi pasë shumë të randësishme... ekzistojnë disa momente të randësishme në zhvillimin e historisë... s'po di qysh me thonë, '68-ës, '74-ta, '81-shi, '99-ta, '90-ta. Edhe ju keni qenë gazetar nëpër tonë ato periudha, që osht' fascinate ma së pari që...

Zenun Çelaj: Kem mrri, thuj (qeshë).

Aurela Kadriu: Edhe unë pata qef sot me fol për '68-ën, qysh iu ka gjetë juve si gazetar edhe a keni mbulu si ngjarje? Krejt vargun e ngjarjes së '68-ës.

Zenun Çelaj: Qe para '68-shit ka ndodhë '66-shi, ni ngjarje shumë e randësishme për historinë tonë. Ndoshta ndonjë fat i yni, s'na ka mallku zoti historikisht (qeshë). Kish ndodhë duket sipas t'gjitha fakteve historike ni përplasje në kreun jugosllav, Tito me serbët kryesisht, se kroatët, sllovenët me serbët. Serbët kanë përba në atë kohë edhe ma vonë shumicën e popullsisë të Jugosllavisë edhe serbët kanë qenë ata që e kanë projektue ni Jugosllavi, niherë mbretëri e ma vonë shtet federal të asaj Jugosllavie.

Dikund mbi 60 përqind kanë qenë, si me thanë, si përkatësi në atë federatën Jugosllave. Edhe ato shërbimet e tyne në nivel të tyne kanë pasë Rankoviqin, personi i dytë i pushtetit në Jugosllavi. Njeri i dytë meniherë mas Titos në pushtet, e i pari në polici, e policia krejt puntë në dorë se shtet policor. Edhe nisin domethanë me zbërthy, me ç'mobilizue, me ia thy kamtë asaj mundësie.

Në atë kohë une kam qenë ushtar. Ngjarja ka marrë emrin "Plenumi i katërt i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë i Brionëve". Briona është në Slloveni, ku Tito ka kalu, si me thanë, edhe jetën ma të mirë, ni vend stërluksoz. Une e kom pa, ai osht' baraz me ata në përralla, në imagjinatë, s'di a sheh diçka ma bukur. Edhe aty e manë plenumin edhe e demaskojnë rastin, e detyrojnë këtë Rankoviqin me dhanë dorëheqje. E tash, ni prej motiveve me e shkarkue e me demaskue atë politikë të UDB-ës ka qenë trajtimi i shqiptarëve. Jo që s'ka ditë Tito ose të tjetër deri atëherë, por tash i ka hy në punë për me mujtë me diskreditu. Edhe, ndër të tjera përmendet qikjo mbledhja e tepricave, ti s'din ndoshta çka janë tepricat?

Aurela Kadriu: Po, po. Kom lexu.

Zenun Çelaj: Ke lexu? E pra meniherë mas luftës që i kanë shkatërru njerëzit tu i rreh edhe detyrohen në ni varfni të tmerrshme, mandej vjen aksioni për mbledhjen e armëve si aksion tjetër, mandej vjen dëbimi për Turqi, domethanë, detyrimi me u deklaruar si turq për me i përzan atje. Edhe, domethanë, argumente që ishin shumë diskredituese për ni sistem që pretendon të t’thuhet se janë të gjithë të barabartë, se të gjithë duhet të jenë të lumtur, në arsim të gjithë të barabartë, në ekonomi, në pushtet, e në të vërtetë kërkund jo. Në polici për shembull a kanë qenë dy-tre përqind shqiptarë, në milici, se ashtu i kanë thanë në shërbime të brendshme. Në kuadrin e ushtarakëve as pesë-gjashtë shqiptarë a kanë qenë oficerët e tjerë, në diplomaci një a dy, domethanë gjithkund të... se s’po më kujtohet shprehja, të pabarabartë shkurt e shqip.

Domethanë, për mua kjo është ajo ngjarja që e ndryshoi jetën edhe na fillim me folë. Unë isha ushtar, por mas ni muji u ktheva këtu. Unë, para se të shkoj ushtar kom pasë ni problem të madh me... në ‘63-shin me UDB-ën. Më kapën, kom qenë me ni Rexhep Zllatku, ka qenë ni gazetar edhe shkrimtar i Maqedonisë në “Flakën e Vllaznimit”. Ai kishte ardhë me t’thye çeka në atë kohë, se në ‘63-shin ndodhi tërmet në Shkup, e tash ata që ishin dëmtu u jepshin pare. Ndihma për me sanu gjendjen, por jo pare të gatshme po çeka. Me ata çeka me ble material ndërtimor.

E tash, shqiptarë dikush vishin ktu, natyrisht dallavere, me i thy çekat sikur kanë ble material ndërtimor në të vërtetë merrshin pare. Qëllon 27 nëntori, domethanë në prag të 28 nëntorit. Atëherë sa ishte lëshu “Bozhuri” tash hotel “Swiss Diamond”, se po flasim ngjarje mas ngjarje (qeshë). Edhe me atë u takova. Kisha krye puntë, se gjithmonë për ditën e 29 nëntorit na nxjerrshim numër solemn, “Rilindja”, për ditën e Republikës së Jugosllavisë. Ish ajo dita e AVNOJ-it³.

Kisha mledhë materialet e i krewa detyrat e këto, u takova me këtë Rexhepin edhe ni shok tjetër ka qenë i Kumanovës. “Hajde po pijmë kah njo në ‘Bozhur’”. Kah ora 11:00-12:00 erdhën, njani civil, “Dil me ne”. S’dish. “Kush je ti?” “Ec mas nesh mos të detyrohen policët me ardhë me të marrë”. Edhe u çova. Në atë kohë nuk mund të kishte banda këso ilegale si shfaqen sot.

Dal te dera, ishte ai automjeti me numër të milicisë edhe emrin, milicia më shtijnë brenda, gjithë natën më rrehen. Zi krejt e kom pasë trupin. E tash, motivi se ke festu 28 Nëntorin, Ditën e Flamurit, edhe me pranë. Unë nuk e pranojsha. Sado që mund ta kisha në shpirt, në mendje e krejt, por nuk e pranova. Në mëngjes më lshun. Edhe ndër të tjera ju jeni në “Rilindje”, ju jeni nacionalista, jeni kështu.

Të nesërmen unë shkova, ishte Mehmet Shoshi drejtor, p’i Peje një. Shkova i thashë, “Unë po e lshoj ‘Rilindjen’” i tregova krejt çka ka ndodhë. Edhe ai me ni... kuadri i partisë ishte, ka qenë sekretar në atë kohë i rrethit të Pejës që kanë qenë funksion shumë i naltë. Tha, “Nuk bon me shku ke me nejt. Por, ulu

³ Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë.

shkruje ni ankesë, çoja Komitetit edhe përshkruje krejt çka të ka ndodhë. Nuk del ndoshta kurgja prej kësaj, por le të mbetet gjurmë”. Shiko ti. Edhe unë ashtu bana.

Në ndërkohë në ‘65-shin shkova ushtar. Edhe prej ushtrisë ky... në ndërkohë ky Mehmet Shoshi bahet, siç i qujshin atëherë, Sekretar i Punëve të Brendshme në Kosovë, Ministër i Brendshëm për Kosovën. Se ra Rankoviqi, a po kupton? Tash fillun me i vendosë shqiptartë në pozita. Ky aty edhe ky, puna e parë, ni prej shembujve e merr rastin tem edhe e dorëzon në Komitet. E marrin atë inspektorin e UDB-së e shkarkojnë prej detyrës, bahet puna jem e madhe, afirmimi jem edhe si gazetar. Hajde tash me i përcjellë ato ngjarje edhe a po don ti, une me mrri kandidat për Kryetar i Rinisë së Kosovës (qeshë), në këtë bazë. Natyrisht s’u bana unë.

E përmenda gjithë këtë se filloi afirmimi i shqiptarëve, filloi edhe... u hapën fakultetet. Ma herët ken’ hapë, qysh në ‘60-tshin. Qysh në të ‘60-tshin qenë hapë fakultetet edhe ajo filloi me ndryshu edhe atmosferën, klimën kombëtare me fol hapun këtu. Edhe në ndërkohë, si të them, u hapën sytë u pa se çfarë padrejtësish edhe çfarë duhet të kishim na. Edhe mrrin edhe studentët që kishin fillu studimet në LjUBLANË, në Zagreb, në një horizont krejt tjetër, edhe me kulturë politike tjetër, domethanë, që nuk durojshin ma edhe krejt padrejtësitë e të gjitha këto.

U organizun demonstratat e ‘68-tshit. Unë kom pasë atë fat... domethanë, i përcolla ngjarjet e debatet e diskutimet për deformimet siç i qujshim na të Rankoviqit, mbi popullatën shqiptare që kanë qenë tregime. Me i pa gazetatat e asaj periudhe të rrënoqethet trupi. Çfarë torturash, çfarë rrëfime janë, njerëzit, rrëfime? Derisa njerëzit i kanë rreh edhe pse i ka pasë me lavru arën me ni ka t’kuq, ni ka t’zi, se kjo simbolizon ngjyrat kuq e zi, të flamurit. P’e marr njo prej shembujve, sa duket banal edhe tragjik. Du të thom që u ndërgjegjësua rinia, veç kish ecë përpara.

Edhe organizohen me mbajtë demonstratë, ‘68-tshin. Në kohën kur në Jajce, që është vendi ku ka lindë Jugosllavia siç quhej federative e Titos. Erdhën burrështetas prej gjithë botës këtu, demonstrata. Rinia kërkon barazi në kuadër të Jugosllavisë. Nuk kishte atëherë kërkesë as për ndamje, as për bashkim me Shqipërinë, por për barazi. Fati im që unë kam qenë në rrjedhë komplet. Se unë qysh atëherë kur kom ardhë në Prishtinë, si të thashë ma së pari, në atë natë shoqnohem me Ismail Dumoshin. Ai ka qenë prishtinali, vendas. [Ka pasur] Ni nanë jashtëzakonisht bujare.

Edhe ne, sidomos që vishim prej Malit të Zi e kishim qerdhe, shkojshim për çfarëdo halli. Me mbetë pa banesë, me mbetë pa bukë, shkojshim aty. E domethanë, tash ma unë isha gazetar s’kisha nevojë për këso ndihmash po shkojsha për...

Aurela Kadriu: Për qejf.

Zenun Çelaj: Po, si te nana. Edhe aty tash ky grupi organizator i demonstratës. Natyrisht, najkush prej nesh s’kish havale, (qeshë) t’shprehëm. Edhe krejt planin, krejt detalet si të thush janë projektu në atë

shtëpi. Se vëllau i këtij Ismailit ishte organizatori kryesor, Osman e ka pasë emrin. Ka vdekë edhe ai, ma i ri se Ismaili. Po ishin edhe këta, Selatin Novosella, Mir Reka, kush ka qenë, Muçolli, e tjerë, plot. Domethanë, e disha kështu që unë e kom ditë se si do të jetë, ku do të tubohen. Te Fakulteti Filozofik, domethanë qatje ku ma vonë u bo biblioteka.

Kisha thirrë edhe ni mik prej Manastirit të Maqedonisë që punonte në Arkivin e Manastirit me ardhë me pa me qenë dëshmitarë i ngjarjes. Kështu që, kemi dalë e kom përcjellë prej A-së deri në Zh çka ka ndodhë. Natyrisht, ne s'na lanë as me raportu edhe jo që kam qenë aktiv, por vetëm vëzhgustë që i kom njëkë. Shkova në "Rilindje" të nesërmen thashë, "Në qoftëse duhet përshkrim të ngjarjes, une e boj" thanë, "Jo se veç çka t'na çon 'Tanjugu' kemi urdhër, asni rresht". Edhe çka të kthehet komunikatë prej Komitetit edhe SUP⁴-it, atëherë i thojshim milicisë. Kështu që, thom e kom përcjellë vazhdimisht këtë situatë.

Aurela Kadriu: Edhe nuk u bo asni raportim, absolutisht?

Zenun Çelaj: Ka pasë vetëm në fillim, ka pasë vetëm... se në Prishtinë ni grup të rish të frustrumë edhe ata siç e kish shkruar "Tanjugu", agjensi që ishte shtetnore, shkaktun ni çrregullim, po as dimensionet as sa kanë qenë e kanë qenë me mijëra në atë protestë. Ata interesant... po kjo ishte se njerëzit të mbushun mes veti. Ata kanë shku nëpër shkolla edhe kudo e kanë shpallë orën kur do të nisë protesta. Ka qenë m'duket 15 në 4:00 ose 10 në 4:00, kom harrue, po kjo ka qenë ajo parolla te veni.

Edhe në ni moment në ora 04:00 të gjitha rrugët, tash qiky bulevard si i thomë na "Nanë Tereza", atëherë ka qenë Marshall Tito, osht' mbushë me demonstrantë që vishin nga të gjitha rrugët e qytetit. Në të njejtën kohë ka pasë mandej edhe nëpër qytete tjera, në Podujevë, në Gjakovë, në Tetovë, se atëherë mendojshim ma gjonë (qeshë).

Aurela Kadriu: Po, po, nisim qaty te '68-tshi veç me na kallxu pak për vazhdimësi...

Zenun Çelaj: Po.

Aurela Kadriu: Me na kallxu për...

Zenun Çelaj: Me u ndërlihdë, po.

Aurela Kadriu: Po, me na kallxu qysh i keni mbulu ngjarjet? Keni qenë mandej në ngjarjet e cenzurume, keni mujtë me i mbulu.

Zenun Çelaj: Po, po. A po fillojmë a?

⁴ Sekretariati i Punëve të Brendshme në kohën e Jugosllavisë.

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: Ishte ni ngjarje krejtësisht e papritur, ishte edhe e pazakonshme për kohën. '68-shi koha e socializmit e asaj diktature të egër komuniste. Edhe në Kosovë ni grup studentësh që kishin ardhë nga, kryesisht nga Universitetet e Kroacisë dhe të LjUBLANËS, e të Sllovenisë, ku kishte ni frymë që dallon pak prej ktyne pjesëve tjera të asaj Jugosllavie që ishte atëherë. Ishin pra, ma liberal, ma afër demokracisë perëndimore. I hyjnë organizimit të ni demonstratë me të cilat kërkonin, do të kërkonin barazi për shqiptarë edhe për Kosovën që t'jetë një njësi e barabartë me të tjera, me republikat e tjera.

E ne s'ishim kërkund, ishim ni autonomi krejtësisht e varun nga Serbia. E pavarësisht që ishim edhe për nga numri i popullsisë, ne shqiptarë, ma shumë se, shumëfish se malazezët, ma shumë se sllovenët, ma shumë se maqedonasit nuk i kishim ato të drejta. Unë kisha atë privilegjin që të isha si pjesë gati e një familje të Prishtinës, Ismail Dumoshi, i njoftun për përcaktimet e tij patriotike të shprehur edhe pse më pengojnë këto shprehjet e tilla.

Dhe, në shtëpinë e tij, në fakt janë ba përgatitjet për atë demonstratë të '68-shit. Kështu që, e dija se çfarë do të ndodhë, si do të, prej ku do t'fillojnë, çfarë do të jenë edhe parullat, se isha i pranishëm në bisedat e tyre. Jo si organizator e as si ndonjë ideator i asaj që do të ndodhte, por për këtë qëllim kisha njoftue një mik timin nga Manastiri i Maqedonisë, ni Teko Tajipi quhej, punonte në arkivin e qytetit. Manastiri është ni qytet shumë i rëndësishëm për historinë e kulturën tonë shqiptare, aty ka lind edhe ABC-ja që e kemi sot, shqipe.

Dhe ai erdhi me qef, sigurisht edhe na pasionet e tij si arkivist që ishte edhe historian me vokacion edhe erdhi. Unë e dija se do të ishte ashtu... ka qenë edhe parulla e 10 në 4:00 se... domethanë edhe si metaforë kanë ardhë minutat e fundit, ishte thirrja nëpër shkollë se ajo ishte popullata që, edhe studentët që përbënin turmën kryesore të protestuesit. Megjithatë, mikun... se unë banoja në lagjen Ulpiana afër spitalit, kurse këta do të niseshin prej oborrit të Fakultetit Filozofik, Filologjik që i thojshim edhe atëherë dhe do të derdheshin drejt qendrës së qytetit.

Atëherë, kjo bulevardi "Nanë Tereza" tash, atëherë quhej Rruga "Marshalli Tito". Siç quheshin të gjitha rrugët kryesore të qyteteve të Jugosllavisë me emrin e tij. Dhe protesta do të ndodhte para teatrit, tash Kombëtar, atëherë quhej Teatri Popullor i Kosovës. Dhe natyrisht se duhej të lëvizte, të vinte me kërkesa para Komitetit Krahinor, tash Ministria e Kulturës. Ishte domethanëse edhe kjo për shkak se Komiteti e Partia atëherë ishin, thuja, pushteti. Asgjë s'bahej pa miratimin, pa besimin e Komitetit.

Dhe nisëm, por u pa se po vonohem. E takum ni shok që punonte në Institutin Albanologjik në atë kohë, Rustem Berisha, edhe ai me veturën e tij në atë kohë, kanë qenë këto fiqat veturat e vogla prodhim i "Fiatit". E nalëm edhe i tregum çka o puna. Ai u kthye menjëherë, po kur mrrijmë deri te, tash ku osht' Radio Prishtina, atëherë Radio Kosova, tash në të vërtetë Radio Prishtina, po mandej ishte rritë turma edhe s'mund t'lëviznim.

Ai u kthy, ne u inkuadrum, u përfshimë në valën e, si të them, në lumin e njerëzve që marshonin drejt qendrës. Ishte, si të them, ajo derdhja e popullatës nga të gjitha drejtimet, na të gjitha rrugët, thuja, si është ajo shprehja, çonin në qendrën e qytetit. Se edhe nëpër shkolla kështu ka qenë, si me thanë, thirrja e ktyne kasnecëve, lajmëtarëve, thirrja për protestë vetëm hapej dera e klasëve edhe u thuhej, “10 në 4:00...” dihej se do të ishin në 04:00 se ajo ishte ideja që në ora 04:00 njerëzit të jenë në këtë bulevard, rrugë “Marshalli Tito”.

Dhe ashtu ndodhi, u mbush rruga. Policia ose milicia si atëherë e qujshim, edhe ajo u ndodh e befasime. Çuditërisht nuk kishte rrjedhë lajmi edhe pse aq haptas, aq thuajse publikisht ishte ba thirrja për demonstratën, nuk kishte mrrri që të mobilizojë policinë për ta pengu, se sigurisht do ta pengojshin. Ka qenë data 28 nëntor, domethanë në prag të 29 nëntorit, ni festë që atëherë festohej shumë në Jugosllavi si festë kryesore, ishte dita e themelimit të Federatës Jugosllave Socialiste, që kishte ndodhë në Jajce, në Bosnje. Atje ishte edhe Tito, kishin ardhë edhe miq të Jugosllavisë në atë kohë nga të gjitha anët e botës dhe atje po festohej, kur këtu shpërtheu ni demonstratë që ishte ni thirrje që atëherë llogaritej e trajtohej si armiqësore, si demonstratë për shkatërrimin e Jugosllavisë, për cënimin e integritetit territorial.

Dhe, organizatorët ishin të përgaditun, e di po thom meqë isha në... kisha ndëgju jo pjesë e organizimit. Ishin përgaditur për sakrificat. Mirëpo, Tito ka qenë një njeri shumë pragmatik, shumë i mençëm dhe kur kishte mrrri lajmi atje, që ma vonë e kuptum se çka ka ndodhë edhe u deklarum për andej, nuk osht’ gja serioze, ni grup t’rijsh me t’drejtë shqiptarë të Kosovës kanë ba ni protestë, kanë ba disa kërkesa të arsyeshme dhe se pushteti do t’i trajtojë ata në ndërkohë. Kështu që, kaloi pa u dokë, jo me shumë pasoja.

Në të vërtetë arrestun, i kapën organizatorët dhe ata dënuan me, jo me ato dënime drakonike që dënoheshin shqiptarët me ato gjana për këso rastesh, por u dënuan me pesë, e gjashtë, e tri, e katër vjet. E kom harru numrin e saktë por ishte një numër i tyre. Por, është interesant në ndërkohë në të vërtetë ndodhi që disa nga kërkesat e shpallura në atë protestë edhe u realizunë. Nuk u interesu ajo kryesorja që ishte për Kosovën Republikë, por u realizu që Kosova të ketë kushtetutë. Deri atëherë kishte ni statut, i cili nuk, vet edhe si emër nuk pasqyronte ni trajtim të barabartë të Kosovës e të shqiptarëve me republikat e tjera, e që tjerat ishin sllave e veç na ishim shqiptarë kryesisht.

Aurela Kadriu: Qysh ish emri deri atëherë para se me u bo...

Zenun Çelaj: Statuti i Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës. E tash u kërku kushtetuta edhe në ndërkohë u banë ndryshimet në Kushtetutën e Jugosllavisë. Quhet, është ajo faza e amandamentimit të saj në të cilat u banë ndryshime edhe Kosova me të vërtetë fitoi disa prerogativa në nivel të federatës. Tash ishte e përfaqësuese në... ishte një, dhoma në Kuvendin e Jugosllavisë, parlamentin pra të atëhershëm, ishte dhoma e republikave. E u kriju dhoma e republikave edhe krahinave quhej.

Nuk më kujtohet saktësisht numri, por m' duket, ndërsa republikat kishin nga 15 përfaqësues në atë dhomë, ajo ish dhomë që vendoste, jepte vulën vendimeve të Parlamentit Jugosllav në atë kohë. Kosova i kishte dhjetë, domethanë, dy të tretat e asaj përbamje. Mandej kishte anëtarin, përfaqësuesin e vet në kryesinë e Jugosllavisë edhe në kryesinë e partisë. Ishin dy forume shumë të randësishme të cilat diktonin praktikisht politikën në federatën e atëhershme të Jugosllavisë.

Tash Kosova s' ishte e përfaqësuar si republikat në këtë dhomë, por ndërsa ato kishin nga dy përfaqësues në kryesinë e shtetit, Kosova e kishte një. Edhe në parti e kishte anëtarin e vet dhe i vinte edhe radha që niherë të kryesoj, të jetë kryetar i Jugosllavisë. Natyrisht sa ishte Tito gjallë, ai ishte kryetar i përjetshëm edhe ashtu që shpallë kryetar i përjetshëm, por pas vdekjes t' tij qëlloi bash shqiptari t' jetë kryetar i kryesisë që rastisi të jetë Fadil Hoxha, mos gabofsha. Pastaj u krijue edhe Universiteti i Kosovës, se deri atëherë nuk kishim as universitet në Kosovë. Kishte fakultete, ishin kriju Fakulteti Filologjik, Filozofik ashtu quhej. Aty përfshinte degët që përgadisnin kuadra për arsim, domethanë profesor të shkollave të mesme. Ekzistonte fakulteti juridik dhe ekonomik. Kishte fakultet shkollë të naltë, arteve, domethanë arteve të pikturës e ndërkohë u shndërru në, ishte shkollë e naltë u shndërru në fakultet.

Dhe pas kësaj, prej ktyne u krijue universiteti, u hap fakulteti i mjekësisë, u kriju akademia e shkencave dhe e arteve, Instituti Albanologjik. Domethanë, u hapën shtigje që me të vërtetë e avanconin pozitën edhe kushtetuese edhe politike po edhe shoqërore të Kosovës me të tjerët, domethanë arriti disa efekte. Ndërkohë u hapën edhe shtigje për bashkëpunim me Shqipërinë që deri atëherë ishte në mollë e ndaluar të ndëgjoje edhe Radio Tiranën e televizionin e Shqipërisë ta shikoje. Tash veç fillun të vinin, në ndërkohë, mas në viti jo meniherë mas demonstratave, po erdhën '71-shi, '72-shi. Kurse me Kushtetutën e '74-tës praktikisht u afrim me status, me republikat e tjera.

Aurela Kadriu: Kisha dashtë, veç ni pyetje, kur u kthytë ju prej demonstratës në gazetë që dojshmit me raportu për to, çka ndodhi?

Zenun Çelaj: Po. Tash mas gjithë asaj nate që ishte shumë dramatike, megjithatë ndërhyri milicia, sollën edhe zjarrfikësa me këto shkulmet e ujit që të shpërndajnë protestën. Sepse ma nuk ishte protestë vetëm e studentëve, e rinisë, por asaj iu bashkue populli. Populli janë gjithëpopullor, janë disa ngjarje, skenat interesante. Ishte, ndoshta ka qenë e premtë unë kom haru ditën, po m' doker sikur ka qenë e premtë po edhe në qoftëse s' ka qenë e premtë, ka qenë koha kur besimtarët ishin fut nëpër xhamia të falnin ose akshamin ose kështu diçka.

E di protestuesit kanë hy nëpër xhami edhe u kanë ba thirrje atyne që po faleshin që tu bashkoheshin fëmijëve të tyre. Edhe ata kishin dalë. U mbajtën fjalime në atë para teatrit tash Kombëtar, atëherë Teatrit Popullor. Mba në mend, se aty sollën Komiteti tash u, Komiteti thashë, ishte pushteti e partia, ishte gjithçka. Kishte thirrë profesorët ma autoritativ që t' u bonte thirrje studentëve që të

shpërndaheshin sepse simbas logjikës edhe simbas analizave të tyre këto protesta mund të dëmtonin çashtjen, interesin e shqiptarëve që kish fillu megjithatë të merrte në zhvillim, të ecte përpara.

Se po ndodhte gjithçka mas ramjes së Rankoviqit, dy vjet më parë. Ndër ta ishte Mark Krasniqi, mbaj në mend, Dervish Rozhaja ishte, nuk po më kujtohen të gjithë të tjerët. Por, mbaj në mend që ndër ta, ndër tjerë që dulen të flasin doli edhe Ismail Bala, që ishte anëtar i kryesisë së Komitetit Krahinor dhe ai fliste për arritjet, për perspektivën, për ecjen përpara të shqiptarëve që kishte edhe bazë reale, se me të vërtetë mas Luftës së Dytë pozita e shqiptarëve kishte ndrrue.

Pjesa e Pestë

Zenun Çelaj: Me kohën e asaj Jugosllavisë, Mbretërisë Jugosllave. Osman Dumoshi që ishte padyshim organizatori kryesor i protestës i rrinte afër, edhe këta protestuesit nuk kishin megafon, nuk kishin mjete për të komandu, për të mbajtur fjalime me efekte. Kurse, këta të partisë, se këta kishin marrë... sigurisht, nga policia a kush s'e di. E mbaj në mend se pat' shkaktuar të qeshme, iu afrue i tha, tha, "Hajt se ti boll fole s'the kurgja, ama knej". Edhe e mori ai edhe mbajti atë fjalimin e tij të gjatë...

Aurela Kadriu: A e mbani në mend çka tha?

Zenun Çelaj: Po. Ishte kjo kërkesa se jemi të shtypun, jemi pa të drejta, jemi të shkelur. Edhe pse qito fakte që i numërova, që edhe pse jemi një popull ma shumë se maqedonë, se sllovenë, se...

Aurela Kadriu: Kroatë.

Zenun Çelaj: Jo kroatët kanë qenë populli i dytë, se boshnjakët për shembull. Ishim ma shumë në numër. Na s'i kemi të drejtat, duam universitet, duam kushtetutë, duam republikë. Na takon me të gjitha të drejtat ndërkombëtare, edhe kështu... ata i arrestun masanej, edhe Osmanin edhe këta që mbajtën fjalim. Po, i kapën sigurisht edhe këto shërbimet e tyre e të sigurimit, i kapën organizatorët e i dënuan siç thashë, po jo në mënyrë drakonike. Ashtu thashë, siç i dënojshin përpara për asgjë, 15 vjet njerëzit merrnin dënime.

Aurela Kadriu: Thatë që qito idetë për liri kanë ardhë ma së shumti prej studentëve që kanë studiu në Kroaci edhe Slloveni. Po më intereson, ju keni qenë gazetar, përjetimet e juaja personale. Në Kosovë, a ekzistonte një pranueshmëri e situatës për arsye se nuk e dijshin që ka ma mirë? E u dashtë me ardhë ata prej Kroacisë e Sllovenisë me iu kallxu që nuk o' mirë.

Zenun Çelaj: S'iu përgjigja pyetjes të parë t'juj se si raportova. Në të vërtetë kur u ktheva, mas gjithë ngjarjes, ajo zgjati deri dikund mas orës 12:00-01:00 të natës kur u shpërndan të gjithë. Shkova në redaksi, atëherë gazeta edhe shtypej me mjete të kohës. Ishte mjaft primitive në krahasim me sot,

radhitja me shkronja të plumbit, me makina të vjetra, ni maqinë që ka qenë rrotacion, prej gjermanëve që ishte marrë qysh në luftë.

Domethanë, vonohej gazeta e dilte dikund kah mesi i ditës. E shkova, thashë, “Unë, nëse duhet raport, unë e kam përcjellë”. Natyrisht nuk guxojsha me thanë që une e kam ditë se ishte, po ashtu ishte me rrezik të arrestohem. Po, thashë, “Jom gati të shkruj raportin”. E redaktori që ishte kujdestar, m’tha, “Jo, s’ka nevojë na ka thanë Komiteti do të dërgoj ni komunikatë edhe mos të marrim asnjë...” Mos t’ketë asnjë shkrim pos asaj që i dërgon vet Komiteti ose që do të përcjellin përmes agjensisë telegrafike zyrtare të asaj Jugosllavie, që edhe sot ekziston, por sot është në Serbi si agjensi e lajmeve.

Edhe ashtu ndodhi edhe lajmi ka qenë shumë i zbehtë, pa ato dimensionet që pat’, pa përmbajtjen e plotë po, “Në Prishtinë ndodhi ni protestë e organizime nga rinia. Kaloi e qetë, nuk pat’ ndonjë pasojë, nuk ka të arrestum”. Ishte, domethanë, si me thanë, me qëllime qetësuese dhe minimizuese të gjithë asaj që kishte ndodhë. Ma vonë, ditëve në vazhdim ato erdhën duke u pasqyru me dimensionin që kishte pasë ngjarja.

Tash, se, m’pyte...

Aurela Kadriu: Ta kujtoj pyetjen. Thatë, ma herët në fillim të fjalisë, thatë që disa studentë kanë ardhë prej Kroacisë edhe Sllovenisë ishin prej nismëtarëve të demonstratës së ‘68-tes. E mu më erdh meniherë ni pyetje, a ka ekzistuar nifare pajtueshmërie me qat’ gjendjen në Kosovë? Për arsye se njerëzit që kanë qenë në Kosovë s’e kanë ditë që ka ma mirë e ata është dashtë me ardhë me pru ide për liri?

Zenun Çelaj: Jo. Idetë kanë ekzistuar edhe ato janë jetu. Grupe, grupe të tana t’rinj e intelektualë ndër vite kanë vujtë me dhjeta vjet nëpër burgje, si grupe të organizime për me ndryshue situatën për me pasë ni protestë, për me kriju, si me thanë, ni mendim tjetër për shqiptarët. Por, këta natyrisht se frika kishte hy në shpirtin e njerëzve edhe nuk e kishin gjithë atë guxim. Kurse këta, thashë, që erdhën prej, që kishin studiue në Ljublanë e Zagreb sollën këtë frymën e guximit që të organizojnë protestën.

Tash, duhej përmend se ka qenë ni lëvizje studentore e rinisë në gjithë Europën. Ndërkohë kishin ndodhë protesta të studentëve edhe në Beograd edhe në Zagreb. Në Gjermani janë të njoftuna ato protestat e rinisë e të studentëve, në Francë, në Çeki, në... shumë vende të Europës. Ishin kërkesat e brezit për me ndryshue situatën. Kërkonin liri, kërkonin demokraci, frymëmarrje ma shumë, pjesëmarrje ma shumë në jetë edhe kushte ma të mira, punë, e tjera, e tjera. Po t’thom kta erdhën e patën këtë guximin që t’i hynin kësaj pune.

Aurela Kadriu: E për juve, do të thotë, përjetimi personal mrena në gazetë edhe me kolegët e juv. Qysh e përjetut ju këtë ngjarje?

Zenun Çelaj: Tash, në çdo kolektiv në atë kohë ka pasë njerëz që kanë qenë shumë, si i qujshim na atëherë, regjimli. Njerëz që kanë qenë të vijes, të pushtetit, të partisë edhe të personaliteteve që kanë udhëheq dhe gjithkund dihej se cilët janë ata. Ata mund edhe të ishin edhe bashkëpunëtor të sigurimit të shtetit në atë kohë. Dhe ne dinim me u, si me thanë, me u rujt prej tyre. Por, në “Rilindje” thuja 90 përqind të tjerëve nuk e kanë fsheh entuziazmin. Edhe jo veç në “Rilindje”, por edhe në popull, në rrugë, në arsim, në shkollë, kudo, për atë që po ndodhë.

Ishte ni shfrymje e njerzëve për herë të parë. I binte, menjëherë prej luftës, Luftës të Dytë Botërore, që të shprehin ni mënyrë ma të haptë, qoftë edhe me rrezik atë që e kanë pasë në shpirtin e tyre. Domethanë, ka ekzistuar frika nga individë të caktun që t’mos shplohesh i tëri. Por, ke pasë edhe pjesën tjetër me t’cilët ke komunikuar lirisht edhe ke shpreh ndjenjat, emocionet pa asnjë brengë.

Aurela Kadriu: E ‘74-tën? Ju ma përmendët atë ditë kur u takum që keni makinën me të cilën është shkrujtë deklarata e ‘74-tës.

Zenun Çelaj: Jo, ‘74-tës. Kjo është ma e vonshme.

Aurela Kadriu: A ma e vonshme...

Zenun Çelaj: ‘89-shi, ‘90-tshi Deklarata e Kushtetuese e Kosovës.

Aurela Kadriu: Aha, pasna keqkuptu. Flasim ma vonë për këta atëherë. Veç, po më intereson kjo vala e ndryshimeve institucionale qysh iu gjeti? Sidomos ‘74, shpallja e kushtetutës së ‘74-tës, qysh iu gjeti? Qysh e mbani në mend ju personalisht?

Zenun Çelaj: Tash, Kosova ma, tash prej asaj demonstrate, mas formimit të universitetit, shkoi për bamja edhe elita intelektuale ishte krejt tjetër. Tash kishin ardhë edhe profesorë edhe ish studentë që kishin studiue edhe në qendrat e tjera të edukimit. Gjithnjë Zagrebi e Ljubljana e kanë sjellë ni frymë ma demokratike për ne. Po, edhe në Beograd ka pasë, si me thanë, janë marrë njohuri ma të thella sesa që kanë qenë te ne.

Edhe njerëzit kishin mësue, intelektualët në këto qendra për historinë, për... hulumtue arkivat, pa, se nuk është vetëm ajo që kemi pa e mësue na në atë shkollën tonë goxha të varfun, me tekste, me kuadër. Për shembull, në shkollë të mesme msusi më ka dhanë mësim, edhe histori edhe gjuhë shqipe. Natyrisht msus që kishte kry shkollë në Shqipëri po s’kishe kuadër tjetër ma të arsimum.

E du të them, kish fillu ni frymë tjetër, me njohuri tjera dhe ma nuk ish krejt e thjeshtë të kufizojsh, të frenojsh kërkesat e brezit për afirmim, për ndryshim, për me qenë i barabartë me të tjerët e të mos jesh i përbuzur. Na deri atëherë as shqiptarë nuk na kanë qujtë serbët po shiptari, që ishte ni, ni, si të them, ni epitete...

Aurela Kadriu: Thatë që iu kanë qujtë shiptari?

Zenun Çelaj: Po, po. E ka edhe ky Esat Mekuli ni vjerrshë interesante edhe sërëbisht të botume edhe shqip.

Aurela Kadriu: Çka thotë?

Zenun Çelaj: Shiptari mos më qujë, me këtë fjalë, domethanë, me këtë atribut. Ata përfshijshin njerëz primitiv, me sharra në krah që çajnë dru nëpër rrugë të Beogradit me të tjerë që lypin, domethanë shumë përbuzës. E tash ma, nuk mujshin ma ashtu me të qujtë. Me këtë kushtetutën mandej të '74-shit ndodhën ndryshime. Ne na u leju përdorimi i flamurit kombëtar. Tash e imponun ni shenjë që do të dallonte nga flamuri që përdorej në Shqipëri, që të mos ushqente ndjenjat e bashkimit Kosovë me Shqipëri, të bënte gjoja nifare dallimi. Se na jemi shqiptarë ata janë... edhe ashtu na qujshin.

Bile, kish shkru shtypi që ishte nacionalist i Beogradit, ata i qunte, "Albanci ne shiptari". Edhe shqipen qashtu, gjuhën. Nuk donte me leju me qujtë në gjuhën e tyre si i thonë *albanci po shiptarci* për ne, e *albanci* për ata. Domethanë, kërkonin me bo dallime sikur ke këso synimesh edhe sot edhe pse ma s'jemi me ta, si me thanë, jemi dy shtete krejt tjera. Ata vazhdojnë me atë andrrën mesjetare.

Aurela Kadriu: Qysh shkrujt ju në "Rilindje"? A kish najfar'... se kur e përmendët tash dialektin, kur i lexon botimet e vjetra të "Rilindjes" gjuha është krejt tjetër.

Zenun Çelaj: Po ka qenë. Deri në '68-shin, deri në vitin 1968 ne kemi shkru edhe tekstet shkollore të gjitha kanë qenë të shkruara në dialektin gegë. Ni dialekt shumë afër këtij standardit që është sot, por jo i unifikum. E në '68-tshin para se të unifikohet drejtshkrimi i shqipes, para se të kodifikohet në hapësira shqiptare, na e kemi miratu këtu në '68-shin kurse kodifikimi ka ndodhë në '72-shin, Kongresi i Drejtshkrimit si quhet në Tiranë. Domethanë, deri atëherë kishim dy dialekte. Kjo që e përdornim na... po edhe në Shqipëri është përdorë në botime të ndryshme edhe dialekti gegë edhe dialekti, si quhet, toskë. Kështu që, mas atij kongresi u unifiku edhe u bo kjo që e kemi sot standardi i gjuhës shqipe.

Aurela Kadriu: Po a kish tendenca prej pushtetit se kur e përmendët se edhe gjuhën ata dojshin, si me thonë, me bo qat' dallimin në gjuhë. A kish tendenca hala me iu shty me shkrujtë me gegë, mos me shkru në standarde.

Zenun Çelaj: Jo. Osht' interesant se tash ka, tash ndër disa për... t'thom... ekziston mendimi se të gjithë ata funksionerë, ata politikanë që kanë jetu e vepru në kohën e socializmit kanë qenë anti-shqiptarë, kanë qenë pro-jugosllav, pro-serb. E nuk është e vërtetë. Kur dul koncepti i standardit i

gjuhës shqipe, u botue në Shqipëri '68-shin. Këtu, Sekretariati i atëhershëm për Arsim e Kulturë, ashtu quhej ministria që merrej me këtë fushë, e solli knej edhe objektivisht e organizoi mledhjen.

Këtu te na nuk u qujtë, po u qujtë konferenca e gjuhës në të cilën u mldhën krejt intelektualët shqiptarë, gjuhëtarët edhe u pajtuem se po fillojmë prej kësaj dite të përdorim standardin, ende pa fillu në Shqipëri. Pati një përpjekje që të kriminalizohej prapë, kriminalizohej si akt politik kjo konferencë. Edhe Fadil Hoxha, që ishte atëherë kryetar i kryesisë këtu. Organizatori... se Instituti Albanologjik që sa ishte themelue, ajo e organizoi këtë konferencë për me ia mbyllë gojën të tjerëve. Atëherë autoritetet politike ishin shumë të fuqishme.

E i thirri, i priti, i përgëzoi Fehmi Agani që ishte drejtor i Institutit Albanologjik, për këtë sukses, për këtë efekt të rëndësishëm për kulturën, për gjuhën, për... domethanë, edhe objektivisht ndali çdo përpjekje që të arrestohej dikush ose të merrej ndonjë masë politike ndaj tyre.

Aurela Kadriu: Në cilin vit keni hy në këtë ndërtesë ku ka qenë “Rilindja”, tash qeveria?

Zenun Çelaj: Aty kemi shku '76-shin, ashtu m' duket.

Aurela Kadriu: Çfarë momenti ke?

Zenun Çelaj: E po tash ishte, na ishim në këtë objektin e vjetër ishte, si iu thashë, në objekt që ka qenë dikur burg. Ishte kështu kujtonte sigurisht edhe kohët e errëta, se edhe ambientet, dyrtë e dritaret kanë qenë me grila, me hekura. Në oborr ka qenë në ambient që kështu zakonisht burgjet e kanë që i nxjerrin...

Aurela Kadriu: Nifarë burgu të censurës.

Zenun Çelaj: Po edhe ajo ka pasë në një mënyrë, nuk ka pasë në censurë kështu sot si paramendohet, me ardhë cenzori si ka pasë në disa vende socialiste...

Aurela Kadriu: Po qajo ka qenë e infiltrume në sistem.

Zenun Çelaj: Shiko, dihej ajo. Mbante mledhje Komiteti Krahinor, thotë, “Këto janë drejtimet me të cilat duhet të ecë shoqnia, zhvillimi ekonomik, jo bujqësia, jo arsimit, vllaznim-bashkimi”. E tash, këto ishin ato kornizat që secili e krijonte censurën në kokën e vet, se secili ruhej mos t'i ndodhë diçka. Bile dikur e patën, si me thanë, lansu ata, ma e zezë është autocenzura se censura e jashtme. Domethanë, kishim na atë autocenzurën tonë, e dinim deri ku guxojmë me shku e ku s'guxojmë. Thashë, burgu ka pasë në hark kështu {tregon me duar} që e kanë... oborr në mes ndërtesave osht' harkore. Edhe tash me pa duket ashtu e ka harkun siç janë... edhe ky burgu tash që po dojnë me e shndërru në muze që është në ndërtesën e...

Aurela Kadriu: SUP-it.

Zenun Çelaj: SUP-it, po (qeshë). Na ka mbetë, a p'e sheh, prej serbishtes. Ku janë këto policia, e ka në mes mandej një si oborr hark ku zakonisht i nxjerrin të burgosurit i qesin kah gjysë ore sa për me lëvizë me marrë ajër të pastërt, sa mos me vujtë veç mrena se degjenerohen. Aty ishte edhe shtypshkronja ishte edhe ato maqinat që kanë pasë pru disa nga Shqipëria në kohën kur ishin marrëdhانيت e mira Jugosllavi-Shqipëri, se këtu te na s'ka pasë.

Ma vonë janë modernizu natyrisht. E tash prej atyne kushteve, dhomave të vogla që kanë qenë, si thashë, me grila, ishin shumë të ngushta, të errëta. Tash, do të shkonim në një pallat, në një ndërtesë shumë moderne ku gjithë kati ishte një hapësirë, pa këto mure ndarëse, vetëm me do paravana që i thojshim, që mund të komunikoni ose kur ngriheshim në kamë e shishim një tjetër, me kësi *air conditioner* që qarkullonte nëpër të gjitha katet, verës freskët, dimrit ngrohtë.

Nëpër kate që, 17-18 kat sa është Pallati i Shtypit, me lifta, ishte krejtësisht diçka tjetër. Në shtypshkronjë sollën maquina që ishin veç tash të kompjuterizuara. Ishte krejt diçka tjetër, shumë ma moderne. Bile në një periudhë kemi qenë shumë ma modern, sepse prej asgjaje tash duhej me ndërtu diçka. Kemi pasë shtypshkronjë ma moderne sesa që e kishte edhe vet Beogradi ose Sarajeva, se u furnizuem prej sllovenëve, prej anej, atje e patëm ble.

Domethanë, fillonte një epokë krejtësisht tjetër. Nuk kishim ma nevojë që... janë histori të gjata si raportoni na gazetarët prej terrenit ku duhej me shku. Atëherë s'ka pasë faks, por duhej me dikt me telefon. Telefon, ishin telefonë statik, duhej me shku në postë. Dikur kishim edhe zyret tona, përfaqësitë si "Rilindjet" e qyteteve kryesore, e duhej prej aty me thirrë redaksinë. Në redaksi ishte punëtori që i merrte lajmet.

Por, në ato vitet e para nuk kishte njeri që dinte me, stenograf që dinte me marrë lajme se s'kish shkronja, stenografi shqip, s'kish. Duhej me shkru serbisht që i merrte sërbi, se vetëm ata dijsin, edhe mandej sërbi ia diktonte përkthyesit shqiptarë, shqiptari daktilografit shqiptar... ishte proces mos pyet, i gjatë. E tash erdhën faksat edhe ti shkrujshe tash me faks në teren, e shtin në faks edhe ajo shkante në redaksi atëherë merrej daktilografi. Atëherë, natyrisht s'ke mujtë me dërgu lajmin si tash të gjallë që e dërgon me internet, po në atë mënyrë. Domethanë, ndryshoi gjithçka, me të vërtetë ndryshoi gjithçka. Erdhën edhe kompjuterët taman kompjuterë.

Aurela Kadriu: Sa kat i ka pasë "Rilindja" në atë ndërtesë?

Zenun Çelaj: 18.

Aurela Kadriu: Po "Rilindja".

Zenun Çelaj: E “Rilindja”. Redaksia e gazetës si gazetë, se “Rilindja” ka pasë njësi të veta shumë. Përveç shtypshkronjës që është ajo pjesa mrapa, ka qenë redaksia e gazetës. Na kishim si gazetë pesë kate, mandej vinte redaksia e revistave kishte dy kate që i ka pasë, ka qenë, “Fjala”, “Shkëndija”, “Gazeta e Pionerit”, ka qenë... se ka qenë edhe “Gazeta e Pionerit” edhe “Pioneri”, “Bati”, ka qenë revista “Jeta e Re”, ato ma vonë. Ndërkohë patëm kalu kha mas ndërtesës së policisë në do baraka.

Mandej ishte redaksia e botimeve si e qujshim na që botonin beterialistikë, jo redaksia e “Enti teksteve e mjeteve shkollorë”, jo “Libri shkollor”, po ishte romane, poezi. Ajo kishte ni gjysë kati. Mandej prunë edhe “Jedinstvo”, gazetë që ishte dikur u bo edhe ajo e përditshme e sollën aty. “Tan-i” ka pasë mbetë dy herë në javë në gjuhën turke. Mandej edhe “Entin e teksteve, mjeteve shkollorë” që kishte dy kat e gjysë e mbaj në mend. Domethanë, kështu ishim të ndamë.

Aurela Kadriu: A kish shkëmbim? Se ata që iu futën krejt me ni ndërtesë a ish qëllimi me përçu mesazhin e bashkëjetesës a?

Zenun Çelaj: Po tash kishte edhe ka qenë edhe kjo ide fillimisht kur u ndërtu pallati, se ishte objekt shumë i madh për kushte të Kosovës. Ndërsa këto redaksitë “Jedinstvo” ishte vendosur një ndërtesë tash ku është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, qaty ka qenë, bash në qat’ objekt. Tani ka qenë dikund tjetër, nuk e di ku dikund në qytet, e tash ishin edhe shpenzime se shteti në atë kohë, gjithçka pagunte shteti. Për me i racionalizu edhe shpenzimet e tyne, atëherë thanë, “Le të bahet ndërtesë ku do të vendosen edhe redaksitë e tjera”, plus është edhe bashkëjetesa, ish edhe kjo. Por, jo që kemi pasë ndonjë komunikim të veçantë. Takoheshim në lift edhe byfe, por dikur secila prej ktyne redaksive bani byfe për veti në katin e vet. Por, jo edhe ndonjë grindje, ndonjë fërkim mes veti nuk kemi pasë.

Aurela Kadriu: Po kthehna edhe niherë te ‘74-shi, nëse mundeni, me siguri keni qenë në detyrë edhe atë ditë kur u shpallë deklarata e, a na tregon kujtimet e tua?

Zenun Çelaj: E tash, t’thashë që ndryshimet kushtetuese fillun qysh ‘68-tshin ma herët, domethanë mas kësaj demonstrate të studentëve. Tash ajo ishte ni proces që kish nisë edhe ma përpara, por kjo, si me thanë, e nxiti edhe e përshejtoi, ky ndryshim, se ishte... thashë, Tito ka qenë njeri i mençëm dhe ai donte të kishte ni Jugosllavi nën kontrollë po të jetë qetë, të mos ketë shumë të paknaqun. Të gjithë nën kontrollë, të gjithë nga pak të paknaqun kërkush jo taman.

Edhe fillun ato diskutimet për amandamentet kushtetuese, fillun ndryshimet edhe u amandamentu Kushtetuta e Jugosllavisë. Në bazë të asaj kushtetute atëherë ndryshun edhe, ndryshoi edhe Kushtetuta e Kosovës, domethanë statuti. Ma nuk kishte statut, por ishte Kushtetuta e Kosovës. Mori disa prorogativa t’vetat. Kishte, i ka pasë pesë dhoma Kuvendi i Kosovës. Dhoma e punës së bashkuar, si quhej ajo, domethanë ishte kolektive. Ishte dhoma e komunave, ishte dhoma shoqërore-politike,

cila ka qenë dhoma tjetër, nuk po më kujtohet (qeshë). Secila i kishte ato kompetencat e veta dhe ato ishin të rregullune me këtë kushtetutë, rregulloren.

Aurela Kadriu: Po qysh ndodhi mledhja e... qysh e mbani atë ditë në mend?

Zenun Çelaj: Kushtetuta e '74-shit jo e Jugosllavisë se ajo, si me thanë, ishte kushtetuta që i impononte mandej ndryshimet ma vonë në Kuvendin e Jugosllavisë. Mas t'gjitha ktyne përgaditjeve, amandamentimeve, si thashë, në Kosovë, jo vetëm në Kosovë po edhe republikat e krahinat tjera, Serbia u mundu me gjithë fuqinë që ta pengojë këtë ndryshim dhe të miratojnë një kushtetutë të tillë në nivel të Jugosllavisë.

Kosova mandej u shkëput, ma nuk trajtohej si kompetencë ekskluzive e Serbisë, po ishte edhe pjesë e Jugosllavisë. Domethanë, deri atëherë Kushtetuta e Jugosllavisë nuk fliste për krahinat, thonte se Kushtetuta e Republikës së Serbisë rregullon krahinat. Dy krahinat se edhe Vojvodina që vazhdon t'jetë edhe tash. E tash e rregullon, do të thotë, është pjesë e Jugosllavisë po edhe e Serbisë. Kurse ato kompetencat kryesore i kishte Jugosllavia. Por, Serbia s'kishte të drejtë asnjë vendim me marrë që ka peshë për Kosovën pa Kosovën. Kosova kishte të drejtën e vet, nuk e pranoj edhe nuk mund të pranohej ai ligj ose ai vendim...

Aurela Kadriu: Mas '74-tës?

Zenun Çelaj: Mas '74-tës, po. Domethanë, kjo ishte një ngjarje që edhe u festue në Kosovë. Natyrisht, atëherë nuk mund të festohej as me armë as me kës, por në këto qarqet që me thanë intelektuale por edhe politike por edhe ata kanë festue ndryshimin e kushtetutës, se ndryshonte edhe vet pozita e politikanëve, ishte edhe interes i personaliteteve. Kurse, kur osht' nxjerrë Kushtetuta, e di për shembull... se me Kushtetutë të Jugosllavisë u dha leja për përdorim të flamurit kombëtar.

Ne na erdh njoftimi përpara në redaksi se atëherë komunikimi me redaksitë ka qenë shumë ma i ngjeshun sesa osht' sot, interesant. Ne na erdh lajmi, thotë, "Janë marrë vesh ato komisionet", çfare kanë qenë, "që të lejohet përdorimi i flamurit kombëtar i kombësive". Domethanë, jo vetëm shqiptarëve u lejohej edhe hungarezëve e çka po di unë, ka pasë edhe sllovak në Kroaci. Gjerman ka pasë, ma vonë s'mbeti gja prej tyne.

Edhe ne në "Rilindje" ka qenë në gazetar i Deçanit, Isuf Rizi, ai improvizoi sikur ka në dasëm edhe e gjetëm në flamur shqiptar. U bomë kolonë na. Në atë kohë veç kishin fillu vetura private t'ketë ma shumë, murrem edhe të redaksisë. I kemi hy nga Prishtina, Ferizaj, Shtime, Suharekë, Prizren, Rahovec, Gjakovë, Pejë, Istog, Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë me flamur. Skenat... (qanë) keq që s'kemi pasë kamera atëherë me i xhiru.

Qe kështu, domethanë flamuri edhe e drejta të flasësh shqip deri edhe në Parlamentin e Jugosllavisë të Serbisë u kriju kjo e drejtë, domethanë u vunë pozita të barabarta edhe kjo ishte. Po thom, në këtë mënyrë u festu. Mandej ti s'ke pasë dasëm tjetër që osht' mbajtë pa flamurin shqiptarë. Ni kohë bile fillun me dalë vetëm me flamur shqiptarë, mandej u problematizua çashtja u urdhnu që të përdoren dy flamuj. Edhe flamuri kombëtar edhe flamuri shtetnor ose i Serbisë, për që të qetësoheshin serbët.

Fillun mandej kta serbët të mos nireshin, të mos nireshin dominant në Kosovë. Fillun të nihen pak në pozita ma inferiore, fillun të shpërngulën e pastaj fillun këto fazat kur serbët, nacionalistët sërbe fillun të organizohen, të protestojnë, të shpifin, të trillojnë se shqiptarët po ua djegin shtëpijat, po i rrehin, po i malltretojnë që të ndryshonin situatën. Po deri në vitin 1980 nuk mund, se Tito kishte autoritetin edhe ai veç thonte, "Po. Jo", të tjerët heshtnin. Edhe nën këtë ombrellë, si me thanë, këta nuk ngritën ashtu kokë.

Me vdekjen e Titos këta fillunë pastaj të ngrisin kokë edhe të bojnë përpjekje me kthi situatën kur Serbia e kishte gjithë kontrollin e mbikqyrjen mbi krahinën. Atëherë ndodhën edhe demonstratat e '81-shit kontra ktyne tendencave edhe historia mori, si me thanë, ni rrjedhë krejtësisht tjetër.

Pjesa e Gjashtë

Zenun Çelaj: E po të thom, në këtë katunin para hyrjes në Suharekë mandej morën vesh familje që kishte vujtë shumë vite nëpër burgje për çashtje kombëtare... se ne shkonim me veturë edhe tu i ra burive si në dasma, sot ose edhe në atë kohë. E kur dulën njerëzit me familje, me, një prej atyne pleqve u shtri para veturës, tjetri i hypte veturës përpara e puthte flamurin (qan). Ne të gjithë qanim, qanim. Këto skena u përsëritën thuaj kudo.

U ndalëm edhe në Suharekë në qytet mrena. Suhareka osht' edhe e njoftun për këso grupesh që kanë vujtë për çashtje kombëtare. Osht' një prej komunave ku ka pasë gjithmonë, interesant, shumë kësi të arrestum në kohën e socializmit të thom ose edhe të Jugosllavisë të përparshme. Në Prizren, Gjakovë ma kanë qenë ato s'na lshojshin, me hangër flamurin, në Deçan e njehta gja. Derisa kemi mrrë në Prishtinë, po thom, këto skena të tilla kudo janë përsëritë.

Ne na shkoi gjithë dita, atëherë edhe rrugtë kanë qenë ma t'kqija, ma të ngadalshme. Po dikund ka qenë para se të legalizohej zyrtarisht. Po tash ne e dishim se kjo u leju edhe ma nuk mund të kriminalizohej si akt. Dikund ka qenë ose shtatori ose tetori. Se dikund në nëntor u, ose dhjetor, tash e kom harrue kur u miratu tamon data e kushtetutës '74-shi.

Na i primë gjithë kësaj, njerëzit tash ishin edhe të habitun se nuk ishte publiku lajmi me thanë osht' vendos lejimi, kështu që ne dulëm të partë. Po thom, ka qenë ni, të ishte xhiru film po thom, do të ishte diçka që sigurisht kish me prekë zemrat e secilit sot.

Aurela Kadriu: A ishte ditë pune?

Zenun Çelaj: Jo, ashtu edhe ne e zgjodhëm ditën se na ishim në punë të gjithë edhe në atë kohë edhe ishte diciplina e punës. Ka qenë shumë e domosdoshme të kontrollohet. Po e zgjodhëm ditë jo pune. Mos gabofsha e diel ka qenë, se edhe të dielave mbaheshin dasmat kështu që ishte kështu... po s'patëm asnjë problem, as s'na doli milici as kërkush përpara, por na pengon për shkak se duket se kish mrri edhe në qarqet tjera kjo, njoftimi se po legalizohet përdorimi i flamurit.

Aurela Kadriu: Kur hapet shkëmbimi me Shqipërinë edhe qysh ndikon kjo mandej në punën e "Rilindjes" se edhe botimet shkëmbehen.

Zenun Çelaj: Tash, hapja me Shqipërinë ka ndodhë meniherë mas ramjes së Rankoviqit. Mas atij plenumit të dhunshëm të Brioneve '66, atëherë fillojnë këto proceset. Kurse '68-shin, '69, '70 veç fillunë shkëmbimet e para edhe të grupeve kulturo-artistike, lejohen vizitat turistike, vijnë prej anej, ma pak natyrisht prej Shqipërisë e ma shumë prej nesh. Na ishim edhe ma të etshëm e ma të përmallshëm për Shqipërinë. Kurse mas të '70-shit, '72-shit, atëherë fillunë edhe me ardhë... kur u kriju Universiteti i Kosovës, fillunë me ardhë ligjerues prej Shqipërie. Natyrisht, kishte ni kujdes nga këto organet arsimore që mos të teprohet se kishin frikë, me matuni që mos të krijohej kundër-efekti, mos të zemërohej politika, t'thom, sërbe, urdhnoi të ndalen.

Kështu që, thirrreshin ekspertë të veçantë, fushave të ndryshme, për shembull për letërsi thuajse s'thirrreshin profesorë se kjo është me përmbajtje që duhet, si me thanë, me folë ma shumë për histori, për emocione e tjerë, po për shembull, për gjuhën. Për historinë e gjuhës, për gramatikën, për këto që ishin ma shkenca. Lejunë, i thirrshin profesorët e fizikës, të automistikës, të kimisë, mandej inxhinierë të maqinerisë.

Kur u kriju Fakulteti i Mjekësisë vinin ligjerues, se ne s'kishim shumë ligjerues në Kosovë për landët e mjekësisë. Çka po di une, anatomi, se nuk i di cilat, edhe krejt janë... po e di se vinin kështu grupe-grupe në mënyrë të organizume. E Kosova nënshkroi, në të vërtetë në emër të Jugosllavisë se Kosova nuk kishte subjektivitet për marrëdhanie me jashtë.

Po, nënshkruante Kosova në emër të ministrisë së sekretariatit për marrëdhanie me jashtë që ishte e Jugosllavisë. I nënshkruante këto protokolet për me... kush me ardhë me ligjeru knej. E për mos me u dukë që veç prej anej po marrim edhe prej knej caktoheshin ekupe profesorësh që ligjëronin në Universitetin e Tiranës.

Aurela Kadriu: Ju a e mbani në mend herën e parë kur jeni shku?

Zenun Çelaj: Unë kom shku shumë vonë, kom pasë disa probleme pak ma shumë politike në atë kohë. Unë kom shku në '92-shin për herë të parë, jo ma përpara në Shqipëri.

Aurela Kadriu: Çfarë probleme po thuni?

Zenun Çelaj: Po m'kanë konsideru gjithmonë nacionalist ma shumë sesa... ndoshta edhe që isha po...

Aurela Kadriu: Ndoshta që keni qenë i hapur... (qeshë).

Zenun Çelaj: Po, me të vërtetë edhe ashtu është. Kom qenë pak ma, me fol ma haptë, a din, nuk jom frenue, gjithmonë kjo një. Edhe e dyta në shkrimet e mia gjithmonë kom lypë... se shkrujsha për problemet që reflektonin, si me thanë, këto raportet me Serbinë, kjo disa herë ka qenë në rend dite me m'përzanë prej partisë, me m'dënu, me ma ndrru sektorin që ishin. Prej politike, për shembull, m'qitën ekonomi se ajo ka ma pak politikë e kish politikë ma shumë, e kështu... Se i bjen sikur po lavdohem (qeshë).

Aurela Kadriu: Jo, jo, une veç po kom qef me ditë se në këto krejt kohna që janë shumë larg prej kohës teme s'i mbaj në mend, s'muj me i mbajt në mend hiç...

Zenun Çelaj: Po, ke shumë që... jo veç ti që je shumë ma e re, por ke plot të tjerë që nuk kanë mrrri edhe kur ndonjëherë flasim kështu bisedojmë për këso tema iu duken si përralla.

Aurela Kadriu: Po, megjithatë krejt pyetjet e mia janë krejt veç prej kureshtjes jo me përfaqësu ndonjë pozitë.

Zenun Çelaj: Po, po.

Aurela Kadriu: '81-ten prapë keni qenë gazetar edhe po më intereson shumë përvojat e juaja personale në të gjitha këto ngjarje që po iu pys. Qysh i mbani ju në mend? Çka ndodhi?

Zenun Çelaj: Tash, 1980-shi Tito ishte smutë... se gjithë e lidhi me Titon ose kultin e personalitetit, po thom, edhe sot njerëzit s'e kuptojnë tamon mirë, kjo osht' si me thanë studime, studime. Ai ishte i smutë pritej çdo ditë vdekja e tij edhe pritej si me thanë mas vdekejs së Titos shpërthejnë problemet, të gjitha që kishin... ashtu edhe ndodhi. Ne, si me thanë, na kishin shtrëngu pak ma shumë, se na shqiptarët ishim të vetmit popull ose rajon që nuk ishim sllavë, të tjerët të gjithë sllavë. Ata kishin pasë shtetin e tyre edhe në kohën e mbretërisë, Kroaci, Slloveni, Serbi. Kurse ne, na shihshin si rrezik ma shumë kështu që ishim të monitorun prej shërbimeve, prej politikës, t'thom, shërbimeve policore e tjerë. Sigurisht edhe prej shërbimeve të jashtme.

Edhe, secilin që kishte ndonjë predispozitë t'jetë ai, e rrehshin kokës. Kështu që, edhe mua më ka ndodhë personalisht t'më thonë, "Boll ke përcjellë organizatat politike, sistemin, tash merru me ekonominë". Edhe kom shkru për ekonominë disa vjet në atë kohë. Kështu, domethanë fillunë në kuadër të ktyne frenimeve, masave mos me leju ndonjë shpërthim pakënaqësie, fillunë të arrestojnë njerëz që kishin hipoteka të maparshme, Adem Demaçi, e të tjerë, për të satën herë ata, e njerëzit që e kanë rrethue atë.

Këta që kanë qenë të '68-shit të grupeve të tjera të njoftuna të proceseve të Prizrenit. Me dhjeta grupe kanë ndodhë, gjithmonë prej Luftës së Dytë Botërore ka pasë... edhe numri ma i madh thuja i burgosunve edhe i të dënuarve politikë ka qenë kah rrathtë e shqiptartë në ato burgje të Jugosllavisë të Titos. Kështu që, thom, këto masat shtrënguese prodhun edhe kundërefektin. Prandaj, edhe ndodhë, me ni xixë e vogël që ndodhi në menzën e studentëve të Universitetit të Prishtinës, edhe tash është kjo menza te semaforat, si quhet... ni përplasje aty rreth rendit kush me marrë ushqimin e derdhet përneherë shpërthen edhe dalin në rrugë fillojnë protesta, fillojnë demonstrata.

Unë qëllova te Nehat Islami. Nehati është kolegë, osht' ma i ri se unë pak, por gazetar i vjetër sa unë. Ai ma ka shkru edhe lutjen për me u bo gazetar. Ai në atë kohë ka qenë sekretar për informim, osht' si me qenë sot minister i informimit. Tash s'ka këso ministri për informim po atëherë kishte. Edhe te ai po pinim çaj, diku mund të jetë kah mesditja, dreka. Kur po thrasin, shpejtë, shpërtheu, demonstratë studentët. Aty prej, ku e ka shpinë te shkolla "Hasan Prishtina" s'di a p'e din ku osht?

Aurela Kadriu: Po, po.

Zenun Çelaj: Banesën. E te menza e studentëve, konviktet ishin ma aty kah soliterat shumë afër. E shkum vrap. Na kemi mrrri në valën e parë që ishin dalë në rrugë. Çfarë fati! Ni fat interesant. Edhe ishin turma, shkonin drejt semaforit poshtë, shkonte deri poshtë edhe kthehej, bërtitshin, "Kosova Republikë". Ni prej atyne që ishte ma zhurmaxhiu, s'e harroj se edhe është orator i mirë, është Ali Lajçi, osht' tash deputet a? Po. E ai thriste sa mundej brohoriste parolla, "Kosova Republikë, duam liri, duam drejtësi, poshtë klikat". Çka po di unë, edhe këso. U bo tollovi, erdhën këta të Komitetit të Partisë me kqyrë me qetësue, i thirrën profesorët edhe prapë me ardhë me marrë pjesë.

Mbaj në mend, prapë, Femi Aganin, e Gazmend Zajmin, Suria Popovci, se u futa në turmë me ata. Unë sillesha si gazetar, zemra më bahej mal, mos me rrejt. Dikur erdhën edhe milicia, ata i mrrin me i shti mrena me bindje, "Hajde të flasim mrena t'i shqyrtojmë cilat janë problemet, cilat janë kërkesat e juja". Ndërkohë, ata fillun edhe me arrestu, mandej filloi çdo ditë, fillunë këto protestat, fillunë ndjekjet, u trimnun këta policia serbe kujtun se i erdhi dita e tyre. Kam pa skena të randa, masandej se ato ma s'u ndërprejnë deri në, praktikisht, derisa u çlirimë. Edhe mas çlirimit Vetëvendosja! s'i nalë (qeshë).

Aurela Kadriu: A raportut?

Zenun Çelaj: E tash, prapë ndodhi e njejta gja si '68-shin. Prapë shkova në redaksi thashë, "I kom pa, i kom përcjellë, jom gati të bëjë përshkrimin". Prapë e njejta si, "Çka t'na çon Komiteti, çka të na dërgon 'Tanjugu'". Edhe me pa atë ditë kur ka ndodhë demonstrata, lajmi që ka ndodhë të nesërmen në gazetë janë pesë-gjashtë rreshta, s'ka tjetër. "Ndodhën çrregullime, disa grupe të studentëve me kushte në menzë të studentëve, protestuen". Edhe kështu.

Aurela Kadriu: A u përfshinë mandej edhe profesorët në protestë apo mbetë ajo vetëm e izolime?

Zenun Çelaj: Profesorët janë ruajtë gjithnjë. Di raste për shembull që i kanë inkurajë studentë që t'mos nalen. Natyrisht edhe këshillue që t'jenë të kujdesshëm se erdhën mandej forca prej Serbisë. Ndërkohë, patën pru edhe prej gjithë Jugosllavisë forca, njësi, milici, se milici atëherë i thojshin që të mbikqyrin, që të kontrollojnë situatën. Se fillunë masandej, nuk u ndalën erdhën. Mas '81-shit vazhdunë në mënyrë përmamente çdo vit, çdo përvjetor të asaj '81-shit. Se në mars, 11 mars, ka qenë mos gabofsha. E ato mandej i kishin jo vetëm me 11 mars, por vinte edhe me 2 prill e çka po di une, kështu, e gjithmonë dilshin grupe që e shënonin përvjetorin e najnjanës prej ktyne. Edhe ato vazhdunë. Mandej, filloi edhe greva e minatorëve, erdhën deri në periudhën kur ma filloi edhe lufta.

Aurela Kadriu: A t'ja u boj ni çaj para se me vazhdu?

Zenun Çelaj: Jo, jo.

Aurela Kadriu: Nuk po pritoj, sinqerisht.

Zenun Çelaj: Jo, jo me ujë ma mirë qishtu.

Aurela Kadriu: Okej. Po kom qef me iu pytë, se herën e kalune ma kini përmend "Bozhurin" edhe pa dalë te të '90-at po kom qef me fol pak edhe për Prishtinën si qytet. Mandej, ndërtohet edhe "Grandi", fillutë me festu vitin e ri brenda...

Zenun Çelaj: "Grandi" është ma i vonshëm. "Bozhuri" ka qenë hoteli i parë, si të thom, modern në Prishtinë. Tash i kanë hjekë më duket, nuk i shoh. Ka qenë në ballinë të saj kanë qenë luftëtarë të Kosovës të Millosh Obiliqit, e çka po di unë si i kanë qujtë këta trimat e luftës së Kosovës. Kanë qenë si n'formë të mozaikut... unë s'e kom kqyrë qe sa kohë po m'dukjet janë hjekë krejt ato ma vonë.

Aurela Kadriu: Une s'pe di as që i kom pa najhere.

Zenun Çelaj: Kanë qenë, mund të gjinen ndoshta edhe në fotografi. Tash ishte hotel, për kohën mjaft modern, shumë i frekuentumë, shkonim ne gazetartë. Ka qenë edhe në modë përpara që gazetartë t'jenë ma shumë nëpër kafe, t'pijnë kah pak. Unë kom pi pak po kom qenë gjithmonë i dobët s'ma ka

duru shumë, kështu që nuk thom që kom pi raki ose birra po naj gotë sa për kështu me iu bo shoqni tjerëve. Priteshin vitet e reja, organizoheshin manifestime. Ka pasë sallë poshtë, ka qenë kjo salla ku... tash moti s'kom hi me të thonë të drejtën n'to, ka qenë një ma naltë me terasë e gjanë po e ka ndryshue mjaft ky pronari i ri, Pacolli. Kurse "Grandi", ai osht' bo shumë ma vonë. Ai ishte shumë ma ekskluziv. Aty shkonim po ishte ma shumë për t'hujë. Filloi dikur për njerëz që vinin kështu elitarë.

Aurela Kadriu: E në "Bozhur" a keni përjetime personale qysh më kallxojsh për konvikt? Qashtu diçka.

Zenun Çelaj: E për "Bozhur" e kom ni përjetim kur m'kanë marrë me 27 nëntor...

Aurela Kadriu: A po.

Zenun Çelaj: Po. Me 27 nëntor ishte ni ditë para 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, e kjo i bjen '63-shin, 1963. E dy shokë më kishin ardhë prej "Flakës të Vllaznimit", ka qenë... qe tash, qysh ia harrova emrin atij. Po, ishte kryeredaktor i "Flakës së Vllaznimit", ai edhe ni kolegë i tij i Kumanovës. '63-shin ka ndodhë edhe tërmeti në Shkup po në shkurt ai ka qenë dikun. Edhe në atë kohë në vend se me iu dhonë pare atyne që kishin pësue iu jepshin çeka me vlerë.

Ata duheshin me ble material ndërtimor për me rindërtu shpinë. Po ata kishin ardhë me i thy pare në Kosovë, shkojshin në këto ndërmarrjet e kështu që ndodhi të takohem me të edhe po pishim qaty. Ni person që unë se njofta, m'duket iu tregova herën e kalune? Erdhi, m'tha, "Dil mas nesh". Kur dola tha, "Hy në automjetin e milicisë" edhe m'qunë në milici. Në ndërkohë i kishin marrë edhe këta dy po unë nuk e disha.

"Çka ke festu?", "Kurgjo, shoktë kanë ardhë jemi taku". Tash, e vërteta është se na e përgëzojshim njoni tjetrin e kështu për flamurin. Se '63-shin atëherë ishte tepër e ndalune kjo. Edhe nuk pranojshim, nuk pranova kurgja edhe ata s'kishin tregu. Atëherë m'hynë dajak më rrehen, m'kanë pasë ba krejt zi. Krejt trupin zi e kom pasë. Domethanë, kjo është ai kujtimi i asaj kohe prej "Bozhurit".

Mandej, po thom, kom shkue natyrisht se ajo kishte ndodhë edhe mandej ndryshunë edhe rrethanat si thashë. Mas '68-shit ishte ni klimë tjetër ma nuk guxonte me ardhë me... guxonte edhe atëherë po jo ashtu fushatë me t'kqyrë a je shqiptarë edhe menihere hajde.

Aurela Kadriu: A keni pa... se po iu pysë ma shumë për këtë trekandësh për arsye se ju prej "Rilindjes", aty te burgu mandej barteni te "Rilindja" e madhe. E po iu pysë për këtë trekandësh se ju e keni përjetu bash në qat' kohë qytetin e vjetër, transformimin. Në të njëjtën kohë bashkë me transformimin e qytetit transferoheni edhe ju në këtë pallatin e ri. E qysh ka qenë qyteti i vjetër? Qysh ju e mbani në mend në atë kohën e juj?

Zenun Çelaj: Tash Bulevardi me, “Nanë Tereza” që është... ka qenë ni rrugë, fillimit ka qenë me kalldrëm, kur kom ardhë ma së pari në Prishtinë. Kanë qenë këto ndërtesat ku është “Koha Ditore”, “Rings”, janë edhe disa restorante tjera, “Bozhuri” nejtse ma anej. Ka qenë ndërtesa ku osht’ tash Ministria e Kulturës edhe këto ndërtesat përballë që osht’ Oda Ekonomike, PDK-ja, janë edhe disa banesa private. Këto kanë qenë të ndërtume në atë kohë kur kom ardhë une në Prishtinë.

Por, rruga ka qenë ma e ngushtë edhe nëpër to natyrisht kalonte, kishte rrugë, kalonin autobusat edhe vetura që kishin. Kjo ndërtesa e lartë e Kuvendit të Kosovës. Ajo, me të thonë të drejtën, në atë kohë ka qenë ndërtue, ni pjesë jo e gjitha. Kjo pjesa aneks është shtue ma vonë që është me xhama me, janë do që shihen edhe shkalltë prej jashtë.

Por, ka qenë kjo pjesa tjetër si, gati si ni kooperativë bujqësore dukej. Ka qenë ni ndërtim mjaft i pa shije, taman tipik i sistemit socialist kështu, rus. Tipit rus. Ndërkohë, ma vonë iu kanë shtue anekse, pjesë. Qikjo me dritare, me xhama, me, në anën tjetër. Edhe përmes kësaj edhe ndërtesës ku osht’, i thojshim sigurimi social, tash...

Aurela Kadriu: Ministria e Punës ka qenë ma vonë aty.

Zenun Çelaj: Nuk e di çka është tash aty...

Aurela Kadriu: Tash s’e di.

Zenun Çelaj: Ndërkohë u ba kjo “Bankosi”, është njo krejt me xhama e naltë. Përmes asaj e kësaj ka qenë rruga, në mes kuvendit e kësaj ndërtese. Ma vonë është mbyllë ajo... prej te “ProCrediti” deri te komuna, deri knej. Kurse knej, prej atyne deri te përmendorja e Skënderbeut te këto kanë qenë, ka qenë ni rrugë. Në dy antë ka pasë edhe restorante edhe librari. Kanë qenë dy-tri libraria aty, restorante edhe shkonte njeri deri te posta e vjetër që është bombardue. Ajo ma nuk ekziston. Kështu dukej ajo. Shumë ma herët, kjo ka qenë mbas kuvendit, domethanë prej sheshit tash, si p’e qujmë? “Adem Jashari”...

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: Ajo pjesë ka qenë dikur e mbulume, ka qenë ni *Kapali* [turqisht - e mbuluar] Çarshi. Që e mrrri m’duket janë do mure kah ka pasë edhe ndonjë kala, une nuk e kam të qartë. Hala janë gjurmte e mureve që dalin deri në rrugë knej prej Kuvendit të Kosovës. Ndonjëherë kur shkoni mund t’i shihni ato mure po unë s’di, s’u marrë ma kërkush me atë. Domethanë, kjo pjesë ka qenë ajo modernja, s’ka pasë thuja ndërtesa tjera t’nalta, edhe kjo ku është sot policia, ajo ana anej. Këto janë ndërtue ma vonë, këto anash, këto rruga kah Kino “Vllaznimi” te poshtë. Kurse kto pjestë e tjera prej “Rilindjes” anej kanë qenë ndërtesa të vjetra. Shkonte deri te shkolla e muzikës edhe vazhdonte anej. Kjo tjetra osht’ rujtë relativisht, kjo mbas muzeut, mes Shkollës “Elena Gjika” që del te xhamia, te hamami atje.

Kjo rruga mandej prej te “Elena Gjika” që shkon andej, del deri te Taukbahçja, ka qenë rrugë e ngushtë me kalldrëm, dy antë ndërtesa të vjetra. Kurse ajo rruga tjetër që osht’ paralele “Bajram Kelmendi” andej ka kalu lumi, ka qenë Prishtevka dilte deri atje naltë.

Aurela Kadriu: Edhe ni pyetje para se me dalë te të ’90-at se mandej ajo osht’ krejt periudhë tjetër e s’po du me iu shkakto probleme në mendime. Po kom qef pak me folë për familjen. Qysh jeni njoftë me bashkëshorten?

Zenun Çelaj: A po ia nisim a? E po unë kom qenë nxanës në Gjakovë, iu kom tregu herën e kalume që i kom ndrru shkollat, klasën e dytë Normale aty isha. Tash ishim pak ma në sy bishim na nxënësit që erdhëm prej Gjakovës edhe që ishim të vendosun edhe në konvikte. Kurse bashkëshortja ishte nxanëse e tetë vjeçares, klastë e fundit të tetë vjeçarës, knonte.

Ka qenë pjesë e Shoqërisë “Hajdar Dushi”. Edhe pse tetë-vjeçare ma e rritun dukej. Edhe kështu jemi njoftë, aq sa... ajo nxanëse, kangëtare, une nxanës i Normales edhe qikaq, asgja ma shumë. Po mas disa viteve kalum, ajo e krym maturën, gjimnazin në Gjakovë erdh në Prishtinë, unë erdha poashtu kisha me ardhë prej Prizrenit e Normalen me kry këtu, m’u ba gazetar. Edhe përneherë u ballafaqum ftyra të njofshme. “A je ti?” “Jom une”. Edhe kështu, si me thanë, i rivendosëm raportet edhe në ndëkohë u martum.

Aurela Kadriu: Ku u takutë? Ku u ballafaqutë?

Zenun Çelaj: Ata... ka qenë konvikti i studentëve, i thojnë shtëpia e pylltarëve, te shtëpia e Fadil Hoxhës ma poshtë në anën e djathtë... tash unë nuk di çka ka aty, osht’ dikund ni agjensi diçka. Ka qenë shtëpi e pylltarëve e në atë kohë ke shndërru në konvikt të studentëve. Ajo sa kishte ardhë edhe aty në fillim të rrugës aty u pamë edhe (qeshë) historia, si me thanë, vazhdon. Po, ka qenë ni martesë pak problematike. Në kohën kur u ritakuam ajo ishte feju me një, dikund tjetër, se s’ishim pa natyrisht as s’e kemi pasë ndonjë raport. Po një fejesë e kundërvullnetshme prej saj edhe pse familje intelektuale po ashtu. Ndodhi, po thom, i rivendosëm kontaktet. Ajo u shkëputë prej atij të fejumit që ishte një student në Zagreb. Sigurisht e ka ba të vetën edhe distanca, ku e di unë. Edhe ‘63-shin, në ato vite dramatike u martova (qeshë). Une 23 vjeç ajo 20 vjeç.

Aurela Kadriu: A m’tregoni pak për fëmijtë?

Zenun Çelaj: E tash, ajo, kur u martum pat’ probleme me shtatzani, me mbajtje të fëmijëve. I ndodhi dy-tre fëmijë i dështoi. Edhe mas mjekimeve, mas kujdesit mjekësor ‘68-tshin më lindi djali i parë. Osht’ tash inxhinier, jeton në Londër. Punon në profesionin e vet, Arianiti. Kurse ky tjetri lindi ma vonë, ‘73-shin. Ndërkohë, ajo u smu edhe vdiq në ‘95-shin nga kanceri.

Aurela Kadriu: Ku e keni pasë shtëpinë e parë? Përpos ktyne bartjeve.

Zenun Çelaj: Unë kom shetitë mjaft, deri në, mjaft, prej '63-shit deri në '68-shin kur kom marrë banesë, se atëherë shteti i ndante, ndërmarrja domethanë banesë shtetnore. Kom banu me qira jo shumë larg prej ktuhit. Osh! në mes komunës edhe ish "ProCredit" ni rrugë te poshtë aty në fund. Aty nja dy vjet me qira kom banu e mandej përtej hekurudhës rruga që çonte në varreza, ato banesat e reja te ni goran, ni burrë shumë i mirë që, si me thanë, i kom borxh gjithë jetën. Se me të vërtetë, si me thanë, ka qenë shumë njerëzor me mu. Aty edhe tri vjet tjera e mandej kom marrë këtë apartamentin në Ulpianë te Shkolla "Hasan Prishtina" deri '83-shin. Deri '83-shin fillova ndërtimin edhe atëherë kom hy, jom në Velani.

Aurela Kadriu: Çka ndodhi në të '90-at në "Rilindje"?

Zenun Çelaj: Ishte dramatike. Ne në "Rilindje" na konsiderojshin... na konsiderojshin edhe ishim, si me thanë, ni punkt i organizuem mirë që bënim rezistencë ndaj tendencave serbe që të kthejë atë situatën para Plenumit të Katërt të Brioneve, që, domethanë, të marrë krejt kontrollin edhe të na kufizonte të gjitha të drejtat. E shkruanim, me të vërtetë me guxim në atë kohë. Kishte... s'ishim vetëm ne. Ishte edhe televizioni në atë kohë, Radio Prishtina edhe Radio Televizioni i Prishtinës, si quhej, jo i Kosovës.

Atëherë ndodhën edhe këto protestat masive që quheshin në atë kohë. Ka pasë marshe, punëtorët në mbrojtje të asaj autonomie që ne e konsideronim edhe ishte afër republikës edhe pse s'ishim republikë. Ishin këto marshet e punëtorëve të qytetarëve nga gjithë Kosova. Ne i përcillnim edhe raportnim me të vërtetë me guxim.

Ndodhi pastaj edhe greva e minatorëve... tash osht' si të thom, përvjetori, sot me Ibrahim Osmanin, osht' ni gazetar i "Kohës", atëherë ka qenë, punonte në Komitet Krahinor, por ni djalë shumë i rreshtum e i mbarë. E sot ai shkonte për Selanik edhe m'shkroi, tha, "30 vjet..." thotë, "m'kanë arrestue". E ata e murrën si sot mu mas, me 4 mars. Ato me 1 mars, mu me 4 mars, si organizator të grevës së minatorëve.

Aurela Kadriu: E pse si organizatorë?

Zenun Çelaj: Po, raportojsha prej atjehit...

Aurela Kadriu: A shkutë?

Zenun Çelaj: Po, po. Si na mrrijti lajmi prej gazetarit, korrespondentit në Mitrovicë, se minatorët janë mbyllë në mbrojtje të Kushtetutës të Autonomisë të Kosovës. Unë mandej shkova t'i bashkohem të raportoj atje edhe hyna mrena. Mandej, gjithë kohën kom raportu prej andej e mandej më arrestuen. Kur mrrinë me i nxjerrë minatorët prej grevës... se ishte ni grevë e urisë që ngriti në kambë thuja gjithë

opinionin botëror. Ishte, thuja hera e dytë në botë që ndodhte minatorët të mbyllen, të gatshëm të vdesin në horizontet nëntokësore 800 deri në 1200-300 metra në thellësi...

Aurela Kadriu: Edhe ju shkutë?

Zenun Çelaj: Edhe unë isha me ta. Po, jo unë s'e qujsha vetën si protestues, por si raportues. Rrisha me ta merrsha deklaratat e tyre, si me thanë, e përshkrujsha situatën, gjendjen. Ishte gjendje e mjerë, në të vërtetë shumë e randë. Kishte raste njerëzit... disa kokëfortë s'dojshin as me pi ujë, po përnime të vdesin. E kjo, si me thanë, u trajtu si nxitje, si inspirim që njerëzit të protestojnë dhe të detyrohen të vetëshkatërrohen. Ishte ni akuzë shumë e randë që shkonte deri 15 vjet burg. Se pushkatim [si denim] e patën pasë hjekë prej Jugosllavisë atëherë edhe këtë vdekjen, këtë burgun e përjetshëm. Domethanë, me këtë akuzë më morën edhe pse grevën e trajtun si ni organizim... se ashtu fillunë, mandej fillunë përnime shkatërrimi.

Pjesa e Shtatë

Aurela Kadriu: Nuk e paskam ditë që keni qenë brenda...

Zenun Çelaj: Po, kom qenë.

Aurela Kadriu: Qysh ish situata brenda? Çka shishit?

Zenun Çelaj: Shiko, tash këto grupet e minatorëve që ishin mbyllë mrena, ata s'dojshin me dalë. Kërkojshin dorëheqjen e Ali Shukriut, ni eksponenti me të vërtetë... sërbeve, të politikës sërbe. Ka qenë Husamedin Azemi edhe kërkonin Rrahman Morinën. Se këta kishin ardhë në pushtet, i kish pru në të vërtetë Beogradi. Regjimi serb me ato masat që ndërmorri në Kosovë.

Ata kërkonin kthimin e autonomisë, asaj autonomie, asaj kushtetute edhe shkarkim dorëheqjen e gjithë ktyne. E këta natyrisht s'donin ose rezistonin deri ni ditë mas tetë ditësh m'duket. Kom harru tash, tetë-nanë. Sollën letër të rrejtshme se ata kanë dhanë dorëheqje, dilni edhe i mashtrun xehtartë. Tash unë isha poshtë edhe kur fillunë dalja e tyre, une dola me i raportu gazetës. T'i tregoj se këta... unë gjithnji t'u kujtue se përnime dhanë dorëheqje.

"Dhanë dorëheqje, minatorët po dalin..." tamon po e ndërprejë raportimin thotë, "Veton Surroi po të thirrë". E marr Vetonin, "Tregoj se po rrejnë, nuk kanë dhanë dorëheqje". U ktheva unë, po vet ata dilshin. Ata e kishin gjendjen shumë të randë që s'kishin dalë gjithë ato ditë, atje terr është poshtë. S'keni qenë poshtë?

Aurela Kadriu: Jo, jo.

Zenun Çelaj: Atje është, dritat aty shkojnë sa mos me humbë si me pasë gati orientim, frymë ka, promajë shumë të madhe, se këto galeritë komunikojnë njana me tjetrën. Ato që i kanë nxjerrë xehet tash kryqëzohen bohet si labirinth, ato tash, ato rrymat përshkojnë njana tjetrën, shumë të rrezikshme. Kështu që, këta xehtartë gjithmonë nxjerrshin... ka aso kande që mbajnë qëllimisht ku mund të rrinë gjatë kohës sa shpërthejnë, se ato xehet nxirren edhe me shpërthim, me dinamit e shpërthime të ndryshme.

Qaty mbylleshin ata, si me thanë, rrishin grumbull me nxe edhe njani-tjetrin edhe me pengu që mos t'u bijë era pijshin ujë, se uji është në këso rastesh të grevës së urisë është shpëtimtarë. Domethanë, mos me vdekë njerëzit. E tash flitej sikur po hyn përmes portave, përmes vrimave, portave të ndryshme edhe ndonjë sasi ushqimi po me të vërtetë këta kanë ba grevë urie, të gjithë.

Kish, po thom, që u binte të fiktë e atëherë kishte shërbime kujdestare që i merrte ambulanta. Ka qenë naltë, se aty hin me lift duhet me u ngjitë naltë. Mandej prej liftit del si me thanë, me binarë si të hekurudhës, por janë binarë të ngushtë. Janë ato vagonat e ngushtë, të vogjël, e i qet deri te porta. Ashtu i merrshin i çojshin në ambulantë. Ka pasë... unë nuk e mbaj në mend numrin e ktyne që është dashtë të kërkojnë ndihmë, por ka qenë i madh.

Në këtë, në ndërkohë kanë ardhë edhe emisarë partiak e edhe politikanë edhe të nivelit të Jugosllavisë. Ka qenë Stipe Shuvar, ni personalitet i njoftun edhe kryetar i Jugosllavisë, i partisë. Erdhën me i bindë këta minatorët që të dalin, por këta ishin aq këmbëngulës, aq rezistues sa ishte e kotë edhe nuk ia dolën me i bindë.

Aurela Kadriu: E ju a dilshit?

Zenun Çelaj: Unë dilsha për raportime, vetëm për këtë, raportime. Ata kanë organizue edhe interesant nuk lejshin me ardhë, milicia me ardhë me i arrestue njerëzit, këta grevistët. Për shkak të frikës se mund të zgjojnë, si me thanë, edhe ma shumë njerz të t'ju bashkohen, se ndodhi... mandej grevat e minatorëve ndodhën edhe në miniera tjera. Këtu, në Kishnicë, Hajvali, në Gjakovë ajo e kromit, në këtu, Magure është poashtu ni minierë tjetër, në këto të... njihet si sipërfaqësore të Obliqit, studentët u mbyllën në fakultet...

Aurela Kadriu: Në sallën "1 Tetori".

Zenun Çelaj: Po, në sallën "1 Tetori", fillunë shkollat... dhe ajo mori përmasa me të vërtetë të një kryengritje kështu paqësore, por viktimizuese që e çoi në kamë gjithë dynjanë.

Aurela Kadriu: Mandej, kur iu erdhën masat e dhunshme me iu përjashtu prej...

Zenun Çelaj: E tash, domethanë i paraprinë... ishte... se kësaj i prinë delegatët, qysh janë deputetët. Me 2 korrik të vitit 1990, m'thirrën me ni deklaratë kushtetuese të cilën e ka shkru Gazmend Zajmi, tash i ndjerë, atëherë ishte akademik. Une shoqnohesha me ta edhe kisha kriju ni emën si gazetar, Zenun, edhe kisha shoqni, jarani me atë, me Fehmi Aganin, me profesorë të tjerë.

Edhe derisa po shëtitnim në ato mbramje që ishin shumë të zymta, shumë të ngarkume, Gazmendi m'thotë, "Zenun ti i dike, si gazetar ti i dike, i njeh këta delegatët" deputetët pra, se ashtu quheshin, deputetët të asaj kohe. Thotë, "Osht' mirë të nxjerrin ni deklaratë kushtetuese, si organ legjitim që osht". Në atë kohë kishte ndodhë që deklaratë kushtetuese kishte nxjerrë Parlamenti i Sllovenisë që po ndahej prej Jugosllavisë. E kishin nxjerrë disa parlamente të vendeve Ballkanike që ishin në kuadër të Bashkimit Sovjetik, Lituania, Estonia. Domethanë, këtu kishte marrë ndoshta idenë Gazmendi.

Tha, "Osht' mirë edhe këta tantë te bojnë. A ke me kond me bisedu?" Kisha. E kisha baxhanakun edhe çiken e kunatës. Baxhanaku Sabri Hashani ishte delegat, kurse ajo ka qenë një Leonora Binishi prej Gjakove, e tash është mjeke në Zvicër, edhe atëherë ka qenë mjeke. Thashë, "Po, kom" tha, "Mirë, nesër po shihemi!" U pamë me to. Erdhi te unë me veturë në shtëpinë në Velani, ku e kom. E kishte të shkrume me dorë atë deklaratën. Ajo përmbajtje që është publikue tash ma është e njoftun. Edhe m'diktoi me maqinë e shtypa. E detyrova se ai s'donte, po ndoshta me pasë ditë me rujtë, po atëherë shikojshim me rujtë njani-tjetrin.

Unë pritsha se do t'më arrestojnë e mos t'ma gjejnë si thonë *corpus delicti* e shkeva ata, atë dorëshkrimin e tij. E gjeta këta, këtë djaln, këtë baxhanakun. Atëherë veç i kishin largue prej kuvendit, delegatët, këta deputet shqiptarë. Kish marrë kontrollin Beogradi, Sërbia. Ia dhashë atij tekstin por këta delegatët u organizun edhe ata mbajshin mbledhje. Edhe atëherë ka pasë komisione sikur edhe tash komisioni parlamentar. Nëpër ndërtesa kështu edhe dikund te Kurrizi atje në ni shtëpi t'ni delegati nga Prizreni. N'banesë të atij ishin mbledhë e m'thirrën.

"Jemi tu e shqyrtu këtë deklaratën kushtetuese, a po vjen? Kemi vetëm një kërkesë". Ata kërkun me heq ni pikë të... ishte me gjashtë pika, mos harrofsha. Ajo pika e gjashtë me të vërtetë dukej e tepërt, s'kishte nevojë se thotë, masi të ndodhë kjo, kjo, me informu këta, këta. Kjo s'kishte nevojë. E m'thojnë, "A po fol me Gazmendin?" Se iu tregova kush e ka shkru, "që, a pajtohet ai ta heq". Edhe e takova Gazmendin, e hoqëm atë pikë. Domethanë... kurse me 2 korrik ajo... këta u mbledhën s'e lanë me hi brenda, u mbledhën para parlamentit, hyrjes edhe aty e lexunë tekstin e deklaratës. Votuen me gishta, populli ishte, në të gjitha anët po i vështronte çka po ndodhë. Në anën knej kah komuna kishin pru tenka ushtria, milicë në të gjitha antë, po këta e deklarunë ata edhe duartrokitën.

Patën pru edhe ni grup... se e dijshim kur do të bohet shpallja. Prej Zvicre ni shok edhe i jemi punonte në Kombe të Bashkume, i Zhegrës, Gilanit, ni mysafir e thirrëm i tregumë. Ai kishte paret e veta kishte financu ni grup, Komiteti për të Drejtat e Njeriut të Francës, federatë jo komitet, Federata për të Drejtat e Njeriut e i dërgoj këtu. Thirrëm ni prej Amerikës, ka qenë ni qorrë e verbër kështu që punonte prej,

punonte, ishte president, hala është gjallë po shumë e smutë në Amerikë, Eva Brendli ajo quhej. Ajo me qen, bile ka pasë ardhë edhe ajo. Se disa ditë përpara e dijsim dojsim me krijue, domethanë, legjitimitet ndërkombëtar. Se jo veç delegatë po edhe vëzhgues të jashtëm e kanë pa, e kanë miratu deklaratën kushtetuese.

E mas gjithë kësaj atëherë Beogradi u zemëru shumë e kish marrë, tash edhe kontrollin të milicisë, të punëve të brendshme, të kuvendit, institucioneve. Edhe erdhën, murr vendim ndër tjera, “Suprimohet...” me 5 korrik ndodh kjo. “Suprimohet Kuvendi i Kosovës me të gjitha prerogativat i merr Serbia e ndalohet dalja e ‘Rilindjes’ ndërprehet transmetimi me RTP”. Janë ato skenat kur kanë hy me zor edhe kështu na ndalunë. Une në atë kohë vazhdojsa të isha gazetar gjithnji edhe isha edhe në Këshillin për të Drejtat e Njeriut, sekretar. Edhe kisha nxanë në Amerikë shefin nip i jemi, Elez Biberaj.

E njoftova shpejt e shpejt e tash ai tha, “Prit me m’thirrë” se kushtonte shumë shtrenjtë atëherë telefoni në pallat. Po taman sa fillum, se në kat të tretë i kishim na zyret, redaksia e brendshme, në katin e tretë... e u organizum na me roje që në qoftëse vjen milicia a dikush me na lajmëru mos t’na nxen kështu. Edhe tamon thirra ata, ai m’thirri mue fillova me raportu për “Zërin e Amerikës”, po vjen policia veç sa s’kanë zbritë këtu. Unë prej aty, “Elez, thirrëm prapë në këtë numër” në katin tjetër, e qishte mezi e kem dhanë këtë raportin atë ditë.

Ishte ni dramë kështu interesante. Po nuk më arrestunë atë natë, nuk ndodhi. Diçka mandej mas dy ditësh kanë ardhë m’kanë arrestue. E, kështu. Ndërkohë, se tash vjen Kuvendi i Kaçanikut. Mas kësaj deklarate kushtetuese, Akademia e Shkencave dhe e Arteve, ata dulën me ni vlerësim kështu profesional. Ishte Gazmendi, Rexhep Qosaj, Idriz Ajeti e tjerë kush kanë qenë. Dulën e përkrahën deklaratën kushtetuese edhe gjithë rezistencën.

Edhe ndër të tjera ni konkluzë që u kërkohet delegatëve që ende ishin, si me thanë, kështu s’ju lejohej me shku mrena, po ekziston si informacion, që të nxjerrin tash ni kushtetutë, Kushtetutën për Kosovën. Prapë Gazmendi ma shkroi tekstin. Kishim atëherë ni organizëm Alternativa Shqiptare, ashtu quhej. Ishin në atë kuadër Këshilli i të Drejtave të Njeriut, Lidhja Demokratike që u formue, ishte Partia Fshatare, ishte forumi ose i të rinjëve kështu disi, kam harrue.

Ndërsa këtë Forumin e Alternativës e kishte rend se ashtu kishin organizu nga ni javë, a nga ni muj e merrte ni kryetar i ni subjekti. Niherë LDK, ni muj Këshilli, ni muj Partia Liberale, ni muj Partia Fshatare. E tash rendin e kish ky, Veton Surroi, kryesonte. Edhe ni mbledhje qitu në Pallatin e Rinisë i tregova se kështu edhe dola e lexova unë atë tekstin. U duartrokis edhe delegatët shkun me 5 shtator në ndërkohë derisa u hartu, se u organizu grupi i ktyne juristëve, konstitucionalistëve edhe hartun tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Aurela Kadriu: A ishit edhe ju aty?

Zenun Çelaj: Kom pasë edhe këtë nderë me qenë. Unë isha në rrjedhë natyrisht se ajo kushtetutë thuja është e shkrune në lagjen time po... në shtëpinë e ni, ka qenë biznesmen, Xhevdet Shoshi. Tash aktualisht ai është pronar i Banjes të Pejës. Ai kishte ble ni kohë prej ni serbi ni shtëpi, punonte... kur u mbyllën shkollat, universitetet në shtëpinë e tij u vendos edhe rektorati i universitetit.

Ai kishte edhe pajime në shtëpi, fotokopjues, dhoma, e kish shtëpinë ma të madhe. Edhe në shtëpinë e tij praktikisht është komponue kushtetuta. Ajo kushtetutë pra që do të shpallet në Kaçanik. Edhe në ditën kur... se ashtu kishin bisedu me këta hartuesit. M'thanë, "A kishe me ardhë ti?" Thashë, "Po, jam i nderum". Atëherë m'thanë, "Ti gjej kameramanin edhe fotoreporterin që t'kem, ta regjistrojmë si ngjarje".

Unë me ata numra që i kisha atëherë lypa këta kameramant. Asnjë. Se veç e kishin pasë mbyllë televizionin, por i lypa nëpër shtëpia, "A ka dikush kamerë?" S'doli. Fotoreporter e mora një, Bylykbashi, edhe tash është njo i gjatë...

Aurela Kadriu: Sadik a?

Zenun Çelaj: Jo, jo. Ia harrova... i lidhë floktë mrapa. Ia harrova emrin. Nejse, e ata e gjeta. Thashë, "Duhet të shihemi". Se s'guxojsha me telefon, se e dijsa se po më përgjohet telefoni. Thashë, "Qishtu, qishtu osht' shpallja e kushtetutës..." se m'lajmërun mu. M'thanë, "Me marrë njo prej delegateve..." që e kisha kojshi, "edhe fotoreporterin edhe kameramanin me ni veturë". Unë s'kisha veturë në atë kohë. Shkoi një, Vula është, avokat është tash, s'më kujtohet emri as i atij, po në lagjen time është, Avni Vula.

Ata e pata lutë a po na dërgon, i tregova se cili është qëllimi edhe ku shkojmë. Erdh pa asni hezitim. Edhe ajo delegatja që është gruaja e ni farmacisti të Preshevës, Afijete e ka emrin. I thashë se vi të marr. Ky këtë fotoreporterin, kesi kameraman nuk gjeta. E këtij Bylykbashit, jo Ilazi, por kusherini i tij është njo i gjatë, bile nanën serbe e ka (qeshë), po shumë patriot kështu.

Edhe m'kallxunë osht' ajo, e kom përshkru edhe këtë rrugëtimin se duhej me qenë atje në orën 08:00 të mramjes. Po ishin caktue, ky organizatori që m'thirri osht' ni... o tash edhe atij ia kom harru emrin. Osht' i Gostivarit ai, po ishte sekretar në kuvend. E ai m'lajmëroi, u takum. Tha, "Në ora 08:00 në Pallatin e Kulturës në Kaçanik. Po, ti..." tha, "duhet me ardhë në 07:30 qashtu, jo ma herët". Ata i kishin caktu delegatëve simbas qyteteve prej nga vijnë që t'mos vijnë përniherë, që t'mos bijnë në sy nga milicia.

Se atëherë këto targat, për shembull, Gjakova e ka pasë DJ, Peja PJ, Prizreni PZ, Mitrovica MD, Prishtina PR e çka po di unë, e kështu. Për mos me ra në sy që po vijnë në Kaçanik, veturë prej Mitrovice, "Çka po lypë?" dy-tri vetura. Po vjen prej Gjakoves... e kishin caktu me orë të ndryshme që të tubohen e mos të bijnë në sy. Edhe mu m'kishin shti si me thanë në ni radhë, domethanë në 07:30.

Parolla ishte në rrugën ku ndahej rruga e Ferizajit prej Brezovicë. “Kur kalon atë rrugë do t’jetë ni kamion, nën kamion ni njeri që sikur po rregullonte kamionin. Në qoftëse ka plaf të bardhë, nalu pyt se mund të ketë ndryshue situata”. Si n’luftë.

Aurela Kadriu: Te plafi i bardhë.

Zenun Çelaj: Po, “Do të jetë pra ni plaf i bardhë, nalu, e t’i thotë parolla a ka diçka të re. Në qoftëse thotë ai, ‘Ec, ti vazhdo. Kur të hysh në Kaçanik kanë me të nal të ri, se organizue, si me thanë me prit, e ti ju thu pa t’pytë ata asgja, ka ni syneti. E ata atëherë e dijnë se ti je i kësaj pjese. T’marrin, vjen dikush me ty e mshefin veturën edhe t’çojnë në Pallat të Kulturës”. Edhe ashtu, kur hyna në Kaçanik, s’di a ke qenë ndonjëherë?

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: Osht’ te poshtëze aty para kalasë edhe m’dulën do kështu me dorë. Thashë, “Kom ni syneti”. Hyni njani me mue, m’çunë, e kalum urën e Lepencit me shti veturën në ni oborr t’ni shtëpie. M’prinë edhe dojnë me ecë bregut të Lepencit të poshtë për te Shtëpia e Kulturës që nuk ishte nja njiqind metra nga stacioni i policisë. S’ka pasë ma shumë. Mrena hollit, koridori i Shtëpisë së Kulturës, mrena njerëzit, dritat dritareve të pallatit të fikura, vetëm në holl kishte drita që t’mos binte në sy, sigurisht. Mrena delegatët të renditun, të sistemun. Përpara, “Kuvendi i Kaçanikut 2 korrik, 1990”, ni transparent i shkruen.

Në ballë ishin Ilaz Ramajli ishte, ishte edhe atëherë, ishte kryetar. Se masi e shpërndamë parlamentin e caktun këta. Ka qenë... ne jse gjinden emrat se janë të shkrumë, s’po më kujtohen të gjithë aty. Edhe filloi mledhja, u zhvillu me një shpejtësi shumë të madhe, u lexu ajo kushtetuta, e kishin lexu ma përpara njerëzit, nënshkrimet e delegatëve, ish ba lista përpara edhe të gjithë ishin nënshkrue që t’mos humbim kohë, se ajo zgjati 20 minuta kështu jo ma shumë. Krejt procedura, u lexu rezoluta, u lexunë ato vendimet që ishin që shkojnë bashkë me rezoluten edhe u shpërndamë. Kjo ishte ajo.

Aurela Kadriu: E qysh u informu populli?

Zenun Çelaj: E tash, unë u ktheva në redaksi atë natë edhe në qytet dikun 09:30 mund të ketë qenë, se isha me këtë Avni Vulën, me këtë delegatën, me fotoreporterin. Edhe, se harrova, aty u morëm vesh që delegatët... se është thanë gjithmonë se ata kanë ikë e në të vërtetë s’kanë ikë. Ishte urdhën që, “Delegatët le të shpërndahen, le të shkojnë kush kushdo jashtë Kosovës”, se veç Jugosllavia kish nisë me u shpërba atëherë. Po, “Le të shkojnë jashtë Kosovës që t’mos kenë mundësi me nxan ndonjë që policia me detyrue me thanë se m’kanë shti me zor me nënshkrue. Po kështu, s’janë këtu edhe evitohej kjo mundësi”. Kështu që, iu tha atyne të largohen, “Mos rrini ni kohë këtu”. Edhe ashtu ndodhi. Ata atë natë janë shpërnda. Të nesërmen unë... atë natë u ktheva në Prishtinë, po tash vet delegatët kishin tregue dikujt dikujt.

E di takova babën e këtij Albin Kurtit, punonte në “Rilindje”, inxhinier ai, Zaim Kurti. E ai gjithë, axha Zenun gjithmonë m’ka thirrë edhe u kanë ma i ri se unë, Zaimi. “Axha Zenun, more niva është shpallë, delegatët e kanë shpallë kushtetutën”, “Ku bre”, tha, “në Dubrovnik”. Kush e di qysh e ka asi. Thashë, “Në Dubrovnik jo, dikund tjetër” edhe eca. Në ndërkohë e takoi një tjetër prapë, “More njeva se është shpallë Kushtetuta” thashë, “Ku?” Tha, “Në Durrës”, “Në Durrës jo, dikund tjetër”. Edhe kështu, domethanë atë natë nuk tregova ma shumë se unë isha ai që duhej ta bëja publike këta.

Të nesërmen me këtë fotoreporterin u morëm vesh. I shkrova unë tekstin e u mora vesh me redaksinë e “Zërit” ishte “Zani i Rinisë” po e patëm kthi në “Zëri” pa rini. E kem pasë hjekë shumë ma herët. Ishin Bardh Hamza, Blerim Shala ishin në krye të kësaj redaksie. Ata mezi pritshin se e dijsin se ka me ndodhë kjo. E bamë... tash se prapë po duhet me bo digresione. E “Rilindja” u ndalue, ishte ndalue prej 5 korrikut, nuk dilte ma. Kurse si “Rilindje”, domethanë, jo me emrin “Rilindje” herë dilte “Bujk” me emrin, herë “Shkëndija”, herë “Fjala”, herë “Gazeta e Pionerit”, “Bat”. Se këto s’kanë qenë të ndalume. “Rilindjen” e pat’ ndalue gjygi në Beograd edhe ti si me thanë, ishte inkriminue automatikisht.

E tash, atë ditë e kishte rendin “Zëri” me dalë si “Rilindje”. Edhe u morëm vesh që unë të shkruaj tekstin e krejt. E shkrova. Ky i kish pru fotografitë edhe, po ky i kish nënshkru komplet me emër të vet. Thashë, “More, a po don me u nënshkru ti? Ti mos u nënshkruj, unë du” tha, “Edhe unë du”. Edhe u nënshkrumë njani-tjetri me emra të plotë, doli ashtu në gazetë. Tash në vend se me i lypë rend delegatët, na morën mu e ata në burg. Patëm nejt një ni muj e kusur, një muj e gjysë në atë kohë.

Aurela Kadriu: Ku?

Zenun Çelaj: Këtu, në burg të Prishtinës u mbajshim. E mbaj në mend një, se ka qenë interesant, tash asaj s’ia di emrin e kom harru, sekretarëshë e kryeredaktorit ka qenë. Edhe kishin ardhë këta të policisë, milicisë edhe sigurimit me m’lypë mu. E kishim byfenë e gazetës edhe po vjen ajo tha, “Zenun, kanë ardhë të milicisë” tha, “Unë nuk iu tregova se je këtu. Ndaq me ikë, ik!” Edhe unë thashë, “S’du me ikë, qitu ku jom”. M’lidhën. Edhe qishtu.

Pastaj ndodhën zhvillime të mëdha siç dihen mas ‘90-shit, mas “Rilindjes”, masnej s’janë ndërpre protestat asnjëherë. E ndalun këto gazetat, mandej ne fillim e zavendësum të gjitha gazetat tjera vetëm me “Bujk”. Edhe kështu kemi dalë deri në, pak para bombardimeve.

Aurela Kadriu: Ku punojshit? Meqenëse “Rilindja” u mbyll.

Zenun Çelaj: E atëherë na përzunë prej atyhit e atëherë punojshim nëpër shpija.

Aurela Kadriu: Secili nëpër shpija t’juja.

Zenun Çelaj: Po. E redaksinë herë vendosej në ni shtëpi, herë ni shtëpi tjetër, po thashë, tash ishte kompjuterizue teknologjia. Kishte kompjuter edhe mund të bahej. Ma s’kishte nevojë për shtypshkronjë të plumbit, po...

Aurela Kadriu: E qysh bohej faqosja masnej?

Zenun Çelaj: Po, me kompjuter bohej. Edhe tash bohet ashtu, osht’ elektronike, osht’ mundësia.

Aurela Kadriu: E distribuimi?

Zenun Çelaj: Distribuimi, ende shpërndahej qashtu. Herë e nalke milicia rrugës, herë vishin njerëzit e merrshin. N’mënyrën ma... si mundeshim.

Aurela Kadriu: Çka ndodhi mandej kur e morën vesh popullata për Deklaratën e Kaçanikut?

Zenun Çelaj: Ai ishte ni gëzim, ka qenë i jashtëzakonshëm. Njerëzit e merrshin si punë të kryer punën që po bahej Kosova Republikë, por fillun mandej persekutime të egra të serbëve, fillun edhe vrasjet. Nisen ato serijat e masakrave të ndryshme. U deklarë, doli në skenë edhe UÇK-ja e organizume. Edhe pastaj në fakt nuk u ndërpre kjo situatë kështu, kjo dramë deri me 12 qershor të ‘99-tes kur hyni KFOR-i në Kosovë.

Pjesa e Tetë

Aurela Kadriu: LDK-në qatëherë para luftës edhe për Këshillin e mandej luftën edhe mas luftën. Nëse nuk na mbetë kohë vazhdojmë herën tjetër.

Zenun Çelaj: Tash, ndodhi mas këtyne protestave masive, keqtrajtimit të protestuesve, të njerëzve që i rrihnin rrugës, nëpër organizata punuese, i debun shumë nga puna prej institucioneve shtetore, shëndetësisë, arsimit, shkollat u debunë për jashtë, universiteti, të gjitha këto. Filloi, si me thanë, ni përpjekje për organizim paralel të sistemit. Edhe u organizunë për fat të mirë sistemi shëndetësor, arsimor, u vendosën shkollat nëpër shtëpia private, edhe universiteti vet, kjo shëndetësia, u aktivizua “Nënë Tereza” këtu e nëpër komuna tjera. Domethanë, filloi një jetë paralele.

Në ndërkohë u organizunë edhe partitë politike. Lidhja e Komunistëve u braktis për ni natë. Dulëm na të “Rilindjes”, kolektivi i “Rilindjes”, me ni letër arsyetim disa rreshtash që e shkroi Ramush Tahiri. Tash, p’e dini Ramushin, ky analisti që del shpesh nëpër televizion, atëherë ishte gazetar i “Rilindjes”. Edhe e shkroi tekstin se, “Në këtë situatë kur partia, Lidhja e Komunistëve osht’, i keqtrajtonin, malltreton shqiptartë, ka bo këtë t’keqe, këtë t’keqe”. Osht’ teksti, si me thanë, edhe i publikumë. E ne, gazetartë e

“Rilindjes”... Organizata e Lidhjes së Komunistëve në “Rilindje”, e braktisim kolektivisht Lidhjen e Komunistëve edhe nënshkrimet.

Lajmin e transmetojnë në atë kohë Televizioni i Prishtinës, hala që funksiononte edhe për 24 orë praktikisht Lidhja e Komunistëve u shu. Në këtë atmosferë nisën përpjekjet për krijimin e partive shqiptare politike. Kishte ni përpjekje prej Zagrebit, ni profesor është i njoftun, kroat, që donte të krijonte ai ni parti këtu në Kosovë që do të ishte alternativë e Lidhjes së Komunistëve, Lidhjes së Socialistëve, partive që kishin qenë deri atëherë në skenë. Në këtë alternativë ishin Veton Surroi me Shkelzen Maliqi e disa të tjerë.

Në këtë atmosferë pra të përpjekjes për me kriju këtë alternativë, Mehmet Kraja, Ibrahim Berisha osht’ profesor universiteti, ndërmarrin një iniciativë me formu Lidhjen Demokratike të Kosovës që do të jetë parti shqiptare. Edhe në ndërkohë i bashkohet edhe ky, shkrimtar osht’, edhe ai ka qenë gazetar në “Rilindje”, s’po më kujtohet momentalisht. Domethanë, Vetoni, Shkelzen Maliqi ishte ajo partia tjetër që donin me ngritë. Po lind ideja, Mehmet Kraja, ky Ibrahim Berisha, Isuf Buxhovi e tjerë thonë po formojnë ni parti shqiptare, që do të quhej Lidhja Demokratike. Edhe fillunë mbledhjen e nënshkrimeve, ndër të tjerë isha edhe unë, në atë grup jam me nënshkruesit e parë, të kësaj iniciative.

Kurse takimet e gjitha aktivitetet... se u mbyllen të gjitha institucionet s’kishim ku me zhvillu aktivitetet. Kishte mbetë vetëm Lidhja e Shkrimtarëve te kjo baraka afër stadionit ku kryetari i shoqatës, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, ishte Ibrahim Rugova, i zhvillum aty. Dhe natyrisht Ibrahimiu bashkue kësaj nisme. Iu bashkun edhe shumë intelektualë të tjerë, avokat, Bajram Kelmendi, e të tjerë mos t’hi të përmendi se janë, shumë janë, me dhjeta. Dhe formum Lidhjen Demokratike, e shpallëm dhe kryetar e shpallëm Ibrahim Rugovën. Ibrahimiu nuk e ka kundërshtu.

Kishte ide në atë kohë që të propozohej për kryetar ose Rexhep Qosja ose Gazmend Zajmi ose Fehmi Agani, por edhe për shkak të ambientit që ai ishte kryetar i shoqatës, e shoqatën nuk e kishin ngucë domethanë, u përqendrum në Ibrahimin edhe ai e pranoi pa problem. Edhe kështu në atë konferencën themeluese pasi e shpallëm, se po themelohet grupi nismëtar. Shkum në Medrese, jo këtu ku është Fakulteti Islamik, por Medresja në drejtim të Llukarit.

Na lejunë Medresja që aty të mbanim këtë konferencën themeluese ku u zgjodh kryetari, u zgjodhën këto strukturat udhëheqëse, dhe ajo vazhdoi dhe ekziston deri tash. Ajo luji ni rol padyshim shumë të rëndësishëm po para Lidhjes Demokratike si organizëm të parë jo qeveritar që ishte jashtë sistemit të atëhershëm u themelu Këshilli për të Drejtat dhe Lirive të Njeriut.

Këshilli nisi si, kishte nisë si iniciativë në Fakultetin e Drejtësisë. Edhe aty Gazmend Zajmi, Rexhep Qosja, Bardhyl [Çaushi], djalin e ka këtu në Vetëvendosje, kishin nisë ni iniciativë që të formojnë një këshill që do të merrej me mbrojtjen e lirisë së fjalës. Mos je lodhë ti? [i drejtohet bashkëbisedueses]

Aurela Kadriu: Jo, jo. Veç kesh tu e mendu se p'e di për kond po folni për atë Bardhylin, po s'po më kujtohet mbiemri e kesh t'u mendu bashkë me juve.

Zenun Çelaj: Jo Bardhyl Zajmi, as Bardhyl Nushi, po... nejse. Ndoshta më bjen ndërmend në ndërkohë.

Aurela Kadriu: Nejse, se as mu s'po më kujtohet.

Zenun Çelaj: Kishin nisë ni përpjekje me formue, me nxjerrë ni këshill që do të merrej me mbrojtjen e lirisë së fjalës e të shprehjes. Ndërkohë përzihet edhe Zekerija Cana edhe thotë, "Jo, po i hyjmë po formojmë Këshill për Mbrojtjen e Lirive të të Drejtave të Njeriut". Ni këshill i tillë ishte formu në Slloveni, e ni Sali Kabashi ka punu atje në një publikim në gjuhën shqipe që, në Ljublanë me ni grup aktivistësh të të drejtave të njeriut prej Francës, Federatës për të Drejtat e Njeriut.

Më kujtohet një Antonio Garapone, e mbaj në mend se me to mandej kom pasë shumë punë. Ai ishte kryetar i këtij këshilli edhe në këtë kohë vijnë në Prishtinë. Edhe vijnë, thërrasin, i thërrasin këta nismëtarët, më thërrasin edhe mue. Mue si gazetar edhe si veprimtar që isha edhe i këtyre lëvizjeve të tjera edhe vendosën me formue Këshillin e të Drejtave të Njeriut.

E formuem, lypshim kond ta bojmë kryetar. Kërkohej në atë kohë që të kemi ni kryetar i cili nuk ka ndonjë histori që mund të kriminalizohej nga regjimi serb. Edhe e gjetëm Idriz Ajetin, që vdiq tash njëqind e sa vjeç. Nji njeri me shumë autoritet, shumë i, si me thanë, domethanës për kulturën shqiptare. E pytëm, ai, "Po more, babush". Ka qenë... edhe babush e thirrshim.

E zgjodhëm atë kryetar, sekretar ke Zekerija Cana nji kohë, mandej u ndrrunë, si me thanë, rolet. Se tash ky ishte, Idrizi edhe në atë kohë ka pasë vjet. Kishte moshë, plus s'kishte lidhje me drejtësi, me këta, ai ishte i fushës së letërsisë e vet kërkoi, tha, "Osht' mirë ta bajmë ndonjë avokat kryetar". Na kishim mbledhë në këshill 20-30 vetë kemi qenë, tash s'e mbaj në mend numrin e saktë, por personalitete me të vërtetë të zgjedhuna të kulturës, të shkencës, dhe avokat më të njoftun.

Ndër ta, Bajram Kelmendi, Fazli Balën... janë shumë tash s'po më kujtohet të gjithë. Edhe u propozue të merr Bajram Kelmendi që ishte avokat me nam në gjithë Jugosllavinë e atëhershme. Ia kishin frikën gjyqëtarët kudo në hapësirën jugosllave, ka qenë me të vërtetë tepër i zoti. E bamë Bajramin kryetar e mu më zgjodhën sekretar edhe ashtu kemi vazhdu deri dikun kur doli nga burgu Adem Demaçi.

Atëherë u propozue se ai kishte legjitimitet, kishte biografinë që njihej ndërkombëtarisht. Ka qenë, si me thanë, sinonim i shtypjes shqiptareve. Amnesty International sa protesta e demonstrata, sa letra kishin shkru këto organizatat Amnesty International e tjerë në mbrojtje të Adem Demaçit edhe të kauzës së tij. Dhe vetë Bajrami tha, "Le t'bahet, ta bajmë Ademin se ka reputacion ndërkombëtar edhe na afirmon edhe problemin tonë edhe këshillin". Edhe u zgjodh Bajrami [mendon Adem Demaçi].

Aurela Kadriu: Atëherë, a po nisim me na kallxu ku keni qenë luftës?

Zenun Çelaj: Gjatë kohës së bombardimeve, se lufta ka fillu ma herët. Lufta ka fillu përpara se të fillonin bombardimet dhe bombardimet ishin rezultat i gjendjes që u kriju qysh para se të fillonte vet lufta. Në represet me dhunën që ushtronte regjimi i Millosheviqit ndaj popullsisë në Kosovë, i kemi përmend ato, dëbimin nga puna, mbylljen e institucioneve, të shkollave, të universitetit që domethanë secila prej ktyne e bëri jetën të pamundshme dhe përfundoi me luftën.

Ndërsa, ajo që bënte regjimi i Millosheviqit ishin ndjekja e njerëzve, dëbimi, domethanë ni përpjekje për të bo pastrimin etnik. Për të kriju ni situatë në të cilën simbas projekteve të tyre të Akademisë së Shkencave nuk do të ishin ma dominant struktura e popullsisë shqiptare në Kosovë, por do të ishin serbët. Edhe prandaj ata do t'mund të bënin çfarë të donin me një territor ku do të ishin shumicë.

Ndërsa, vet fillimin e bombardimeve, atë natën e fillimit të bombardimeve me 24 mars të vitit 1999 ndodhesha në banesën, në shtëpinë time në Velani dhe prej aty i vetmum, fill i vetëm për shkak se djali, Liraku, ai kishte shku në radhë të UÇK-së qysh ma herët, qysh thuja nga korrik-gusht të atij viti. Kurse grunë atëherë e ka pasë edhe fëmijtë i pat' përcjellë në Maqedoni e Strugë, prej nga ajo ishte me origjinë.

Ishte ni natë, sa e frikshme, se po fillonte ni luftë që ne s'e kishim njoftë deri atëherë. Ishin bombardimet e NATO-s në caqet serbe, strategjike siç formulue aksioni i forcave të NATO-s që vinin me aeroplan në lartësi të nalta prej bazave ku i kishin në Mesdhe. Aq ishte edhe gëzim i papërshtatshëm sepse pritej, e jo veç pritej, po ishte shenjë se po përfundonte një periudhë e tmerrshme, e randë për të gjithë shqiptarët në këtë pjesë të Ballkanit.

Dy ditë ma parë unë takova Fehmi Aganin, që ishte pjesë e delegacionit të Kosovës në bisedimet në Francë mas Rambujesë dhe ai me disa përfaqësues tjerë të delegacionit të Kosovës ishte kthye në Bruksel, në selinë e NATO-s. Kishin bisedu edhe në NATO, kishin qenë shumë të sigurtë se gjithçka do të zgjaste dy-tri ditë edhe do të përfundonte edhe kjo do të ishte, si me thanë, ai fundi i, *happy end-i* [anglisht - fundi i lumtur] i gjithë asaj tragjedie që kishim përjetu.

Me atë dëshirë, me atë mendje edhe unë i vetmum në atë shtëpi, pra kur i fikën edhe dritat e krejt dola në terasë, ballkonin e shtëpisë, është naltë edhe prej nga shihet edhe qyteti edhe aeroporti edhe Goleshi, që ishin caqet e atyne bombardimeve. Si kundër edhe ky mali naltë në krye të Gërmisë, ku ishin antenat të cilat i shfrytëzonte ushtria, armata e atëhershme jugosllave siç quhej edhe ishte thuja ni mënyrë jugosllave.

Shiheshin ato flaktë që dilnin prej atyne, ishte, po thom, ni kënaqësi e madhe dhe pritej që mas dy-tri ditësh të kthehen gjithë të tjerët edhe çdo gja të qetësohej. Të fillonin shkollat, të fillonin puntë nëpër institucione. Po u pa se nuk do të ndodhte ashtu.

Ushtria serbe ishte përgatitë sigurisht edhe me instruksione edhe të aleatëve të tyre, sidomos të rusëve edhe pse edhe ata në ni mënyrë ishin pajtë që të ndodhte ni bombardim mas asaj që kishte ndodhë në Bosnje. Gjithë ajo tragjedi, vrasjet masive. Por, të nesërmen, me 25, erdhën ushtarë e policë çdo derë edhe thanë, “Mrena dhetë minutave të ikni të gjithë, kënd ta nxajmë do ta vrasim”.

Aurela Kadriu: A erdhën edhe te ju?

Zenun Çelaj: Po, erdhën edhe te unë, m’gjetën aty m’thanë, “Le derën hapun” edhe ashtu edhe veprova edhe u largova. Për fat e kom pasë ni vëlla që kishte banesë në Ulpianë edhe aty kishte shku çika e vëllaut me gjithë bashkëshortin e saj me fëmijtë. Vinte prej Barilevës, ni katun këtu afër Prishtinës. Ni hyrje ku nuk kishte shumë shqiptarë, familje shqiptare, tre-katër, pjesa tjetër ishin serb dhe unë u nisa të shkoj atje. Po rrugës isha kureshtarë se çfarë ka ndodhë dhe u ndala fillimisht të kontaktoj me familjen e Bajram Kelmendit, për të cilën kisha ndëgju se i kanë marrë me gjithë fëmijë Bajramin policia ose paramilitarët dhe të marrë vesh diçka.

Mirëpo, dera ishte mbyllë dhe askush s’ishte ma aty dhe s’mund mësova asgja. Vazhdova rrugën, u ndala në redaksinë “Koha” e cila deri atë ditë veç dilte, botohej. Edhe tamon po du me hy mrena në ndërtesë, aty ku osht’ edhe sot në sheshin, tash, “Nanë Tereza”, aty ni roje me automat edhe veç ma drejtoi automatin edhe ni tjetër tha, “Mos hy, ka të vramë mrena”. E kishin vra atë rojen e redaksisë.

Kështu që, qyteti ishte i qetë s’kishte njerëz, nuk shiheshin, pos aty këtu ndonjë njeri dhe të uniformum, policë, milicë si i qujshim në atë kohë edhe ndonjë ushtar. Edhe vazhdova deri në Ulpianë, kom hy në banesën e vëllaut dhe prej aty nuk kom dalë për 60 ditë të tjera. Kom qëndru brenda. Shikoja mandej nëpër dritare ato që po ndodhnin.

Për fat disa shokë të mi lëviznin, s’di nga e kishin guximin, unë kisha edhe ni arsye që mos të dal se kisha dy akuza mas dy arrestimeve. Kisha frikë se do t’më njezh dikush prej tyne edhe më marrin edhe do të përfundoja. Por, isha edhe i sëmurë për fat të keq, pata probleme qysh ma herët me lukthin. Kisha një sëmundje që shumë vjet më ka mundu.

Se edhe djali, Liraku, prej frontit, zonës të Llapit, knej m’thirri, se na mbeti ni lidhje telefoni e ni prizrenjani që duket se kishin kujtë këta t’postës ose ata që kishin marrë në kontrollë postën... se i ç’kyçen të gjithë telefonat shqiptarë, vetëm të serbëve mbetën edhe të atyre që s’ishin shqiptarë. E për këtë kishin kujtue se ndoshta është turk edhe nuk e kanë ngucë hiç.

E ai shkoi vet në Prizren e m'i la çelësat. Ky ishte domethanë njana prej atyne tri-katër familjeve shqiptare që ishin në atë hymje. Kështu që, herë mas here hypsha deri në katin që ishte ma i larti dhe thirrsha ose... banesa e vëllaut ka pasë fqinj një malazet, prej anës nga vi unë, prej Plavë-Gusisë, me të ciltë kishim një miqësi të hershme.

Axhën e tij, gjatë Luftës së Dytë Botnore, ai një prej gjeneralëve të ushtrisë që është qajtë Nacional Çlirimtare, po malazet natyrisht i rrethun prej çetnikëve edhe vullnetarëve shqiptarë tjetrën anë, ai dorëzohet vullnetarëve shqiptarë. Ku, një axhë i imi e merr në mbrojtje edhe e çon në atë pjesën, në territorin... që pronat që kishim në kufi anej po në anën e Shqipërisë, atëherë ma kufi nuk ekzistonte, thuja.

Dhe domethanë e kishim shpëtu atë njeri, kështu që ky kishte një obligim edhe moral që t'sillej mirë edhe me mu, dhe, ta them të drejtën, më është gjetë mirë. Edhe ushqime më sillte bashkë me fëmijtë e çikës së vëllaut edhe dhandrrin e tij. Edhe telefonin, si të them, e vuna në dispozicion të Lirakut që këta mujshin me folë me telefon satelitor edhe me vëllaun e nipat që i kisha në Amerikë. M'thirrshin te ai edhe unë flitsha.

Natyrisht, këtij, edhe me gjithë këtë miqësi dhe këtë njohje të përparshme nuk i tregova për Lirakun se osht' në front. Po i thashë... kujtova se e kom mashtue, se do të shihni ma vonë se më ndodhi diçka e papritur në fund. I thashë se, "Osht' fat i mirë, shqyrr djali me gru e fëmi shkoi në Maqedoni, në Strugë edhe tash ai është i sigurtë, për mu le të ndodhë çfarë të ndodhë, punë e madhe".

Ai edhe s'boni fjalë kështu, nuk ma tha deri në ditën kur hyjnë forcat ruse me 10 ose 11 qershor hyjnë edhe me hyrjen e tyre këta serbët, malazetët, domethanë këta që kishin mbetë këtu, se shqiptarët shumë pak kanë pasë mbetë në Prishtinë e përshëndetën me të shtëna të jashtëzakonshme. Me të vërtetë, edhe unë kujtova se mos filloi bombardimi edhe i qytetit të Prishtinës aq të mëdha ishin ato.

Prej të gjitha dritareve shtishin. Ky malazezi u frigu shumë, erdhi se ishim, vetëm muri i ndante kto banesën e vëllaut me të atij. Tha, "Zenun aman shpëtom..." tha, "Çka po ndodhë?" Unë s'disha po edhe ai s'kishte ditë. Tha, "Ka hi UÇK-ja në qytet". Natyrisht une i dhashë siguri dhe me të vërtetë do ta mbrojsja deri në fund. U strehumë, hymë deri në, kështu u shtrimë për tokë, s'dishim çka po ndodhë.

Edhe ai aty u shtri, tha, thashë, "Po unë s'di sa do t'kom mundësi" tha, "E di se ke mundësi, e di se e ke djalin në front". Domethanë, e kishte ditë gjithë kohën edhe nuk ma ka thanë. Kjo çika e vëllaut, ajo dilte zakonisht të furnizohej me bukë. Megjithëse, ne krijumë, në ato ditë të para kur hala mund të lëviznin shqiptarët edhe në dyqane t'iu japin, t'i shërbejnë. Sepse tash ishin vetëm serbë edhe nëpër dyqane, ato që kishin mbetë.

Dilte blente bukë dhe atë bukë e pjeknim e shtinim në frigorifer, ishte një, si me thanë, një shkollë që kishim marrë prej Sarajevës prej anej që gjanat të pjekeshin të shtiheshin të pjekuna edhe të, si të

them, të ruheshin në vende të ftohta kështu edhe, si me thanë, të përdreshin racionalisht jo dorëshlirë kështu.

Kështu që, kishim kriju rezerva. Na ishim edhe ni familje tjetër, osht' njo edhe ai i Llapit, ni avokat Qazim Qerimi, ai mbeti me grunë, se vajzat për fat të tij ia doli t'i përcjellë në ato ditë e para meniherë. Shkunë nëpër Maqedoni e ikën atje, në Maqedoni kanë jetu. Kurse ni shok tjetër, Nehat Islami, edhe ai i kishte dy çikat e tij. Edhe ai i lumtur e i stërlumtur e përmes ni lidhje edhe ai qishte t'njoftun t'ni malazezi ia doli t'i përcjellë vajzat. Kështu që, tash ai vinte ndonjëherë te unë se nuk ishim larg me banesa, po unë s'dilsha, ai dilte.

Nëpër strehtë e ballkoneve, rreth ndërtesave shumë katëshe ishin parkue automjetet ushtarake, tenkat e ushtrisë serbe ose jugosllave dhe ato nuk lëviznin, prisnin. Sigurisht e prisnin atë momentin për me qenë në kundërsulm. Kështu ato ia dolën të ruajnë edhe teknikën e tyre ushtarake edhe vet të mos dëmtohen shumë. Aeroportin e braktisën gjatë kohës së bombardimeve, sigurisht edhe bazat që i kishin në Golesh edhe në krye të Gërmisë.

Mas luftës mandej kom pa kur kom dalë me ecë në Gërmia ata ishin futë nëpër... kishin ba kësi strehimore në tokë kështu edhe prej aty me prit mos po hyjnë forcat tokësore. Këto ishin, si me thanë, merrnim pra nga këta që lëviznin ndonjëherë, ndonjë informatë se kush ka mbetë. Morëm vesh, për shembull, që në ditët e para... se Bajram Kelmendin me dy djemtë e kishin vra, se kjo grua e Bajramit, Nekibja, që edhe ajo tash e ndjerë e kishte motrën aty afër. Edhe motra e saj kishte dalë me lëvizë, e pakufizuese, aty afër.

E kish pa kjo çika e vëllaut edhe kish marrë vesh prej saj se osht' vra. Unë natyrisht nuk mund të shkoja, as s'guxova me shku as në vorrimin e tij, po mora vesh... se çuditërisht atje, në vorrimin e tij kishin marrë pjesë Adem Demaçi, që dilte kështu haptas nëpër qytet edhe jepte deklarata televizioneve serbe Beogradit. Edhe hiç pa frikë kështu fliste kundër, pa asnjë kufizim. Kishte qenë edhe Fehmi Agani edhe disa të tjerë 20-30 vetë, kështu të rrethit familjar kishin mund të marrin pjesë në vorrimin e tyre në vorrezat në Dragodan, Arbëri që i thuni tash.

Ndërkohë ndodhën edhe vrasje të tjera në qytet, por jo në masë siç ndodhnin në Drenicë e në pjesë të tjera të Kosovës. Ishin këtu në Prishtinë disa individë, m'kujtohet një, ka qenë, tash s'po më kujtohet emri... ata e patën vra në të vërtetë në ditën e fundit kur po përfundonin bombardimet. Mandej mora vesh se ni profesor i universitetit kishte vdekë e s'kishin mujtë me çu me varros në varreza e kanë shti në oborr, Peja, ni profesor i Fakultetit Juridik. Domethanë, rridhnin këso informacione, e dinim përafërsisht kush ka mbetë në qytet.

Zekerija Cana, edhe ai ka qenë një veprimtar, historian, punëtor shkencor në Institutin Albanologjik. Ai edhe kishte mbledhë shënime se kush ka mbetë edhe ka ba ni libër mandej kush mbeti mandej deri në

fund në Prishtinë. Edhe disa intelektualë tek-tuk, por të gjithë të mbyllun, të gjithë të izoluar, se ishte frika se po t'na takojnë do të përfundonim keq.

Kështu erdhi edhe ai 10 qershori i famshëm që solli praktikisht paqen, Marrëveshjen e Kumanovës. Natyrisht, gjithë natën përcillnim lajmet përmes radiove, tranzistor kështu, i ndiqnim se çka po ndodhë, kishte raportime prej fronteve të luftës, prej viseve të ndryshme të Kosovës. Iu dërgonin njoftime “Zërit të Amerikës”, “Europës së Lirë”, “Deutsche Welle”, radio “Tiranës” dhe prej anej kuptonim se çka po ndodhë jashtë.

T’ju thom të drejtën deri vonë... se u dha edhe lajmi se edhe lagjja ime Velania osht’ djegë e shkrumue edhe ashtu kujtoja unë. Po, në ndërkohë me Lirakun në telefon që lidheshim si të thashë me atë telefonin satelitor të tij, prej këtij kojshisë natyrisht. Unë thojsha se po flas me vëllaun kujtonte se në Amerikë sigurisht, të cilin e njihte ai. M’tregoi se kta prej UÇK-së po dërgonin herë mas here me vëzhgu gjendjen, njerëz që futeshin në qytet për me pa se si është situata, që të dijnë se si është situata dhe si të veprojnë.

Më njoftoi se në Velani asnjë shtëpi nuk është e djegun, asht’ në kambë qashtu si e kemi lanë. T’them tash ndodhin edhe gjana tjera. Ni natë, për shembull, dikund rreth orës 02:00-03:00 të natës po bjen zilja e derës, banesës ku ishim. Koridoret ishin pa drita edhe s’dishe kush po thirrë as kush është. Unë, t’ju them të drejtën u bana gati të vdes se kisha dëgju që kështu po i marrin, po i gjejnë njerëzit e po i marrin e po i pushkatojnë.

Edhe, vëllau qysh kur ka qenë këtu ka pasë ni revole edhe atë revole s’e heksha kurrë nga vetja. Gjithnjë llogaritësja t’paktën vetën ta shpaguj. Me atë revolen në dorë, po derën nuk e hapa krejt ishte me zinxhirë kështu, e kishim rregullu ma herët që t’mos mund të çelet pa ashtu, qoftë edhe menjëherë me thymje. E hapa, një femër doli krejt lakuriq, fliste si mos me qenë normal, sa shqip, sa serbisht edhe, “Çelma derën të hy mrena”. Po unë nuk disha çka osht’, kisha frikë se mund të jetë edhe provokim që e kanë çu serbët ndokënd edhe pastaj edhe t’ma veshin, ka dashtë me dhunu a ku po di unë. Njeriut i shkon mendja gjithqysh e t’kenë tash pretekst t’më vrasin edhe në këtë, me këtë turp të Zotit. Natyrisht nuk ia çela derën.

Çikës t’vllaut i thashë, “Jepna rroba t’ja jepim”. Edhe ia qita rrobat, i veshi, s’di çka bani, i veshi a u largu. Shihnim nëpër dritare edhe kolona njerëzish që vinin nëpër katune, kalonin, se ashtu i bjen ajo rruga, kishte shikim anej nga ajo rruga që është kah spitalet, kah Qendrat Klinike Universitare. Kolona me traktor, me çerre, me ndonjë veturë, kolona e pandërprerë po as s’dijshim ku po shkojnë as... e dijshim se po ikin jashtë Kosovës. Të gjitha këto natyrisht krijonin atë ndjenjen e mungesës së ni të ardhme të një frike që njeriut ndonjëherë i vinte t’dal vet t’bahem bombë e t’shpërthej dikund, të hakmerrem me dikond, po na mungonin ato mundësitë, të papërgaditun për kështu.

Kështu edhe e pritëm ditën e fundit të bombardimeve. Shkova mas 80 ditësh, dikund ashtu, 78 ditësh ta shoh shtëpinë, se rrugët u zbrazën s'kishte njeri të gjallë prej këtu, domethanë Ulpianës pra afër spitalit ku ishte banesa e vëllaut deri në Velani. U përpoqa të gjej rrugë dytësore ku... nëpër mahallë të Muhaxherëve e atje. Tre vetë i kam takue gjithsej edhe ata s'dinin kah po shkojnë. Kur kom shku në shtëpi u përpoqa të hapi dyrtë të shoh çka ka ndodhë me shtëpinë mrena, por asni derë s'mund ta hapja. Mandej mora vesh se një nga fqinjët kishte hy në ditë a dy, disa ditë, s'e di sa, masi na kishin dëbue edhe ku kishte mund kishte mbyllë dyrtë, gozhdue që t'mos mund të hyjnë lehtë. Veturën ma kishin marrë që e kom pasë në garazhdë, në Golf 2-sh në atë kohë që ishte veturë e mirë.

Oborri ishte mbulu nga bari, baroret e këqija si i thonë... po atëherë edhe me pa mend krejt natyrisht, budallakisht hyna unë me përpjekë me gjetë diçka me hypë nëpër ballkon ndonjë dërrasë që t'futem të shoh brenda shtëpinë. Ka mund me pasë edhe mina të vendosura, po atëherë s'e kisha mendue. Edhe kështu u futën forcat e NATO-s. Erdhën britanikët ma së pari te vorri ku është tash i vendosun Ibrahim Rugova e zbritën ata me helikopter. Natyrisht shkojshin me automatik në dorë, shumë të kujdesshëm. Njerëzit që kishin mbetë që kishin qenë aty-këtu (qan) i puthnin, skena të dhimbshme (qan).

Pjesa e Nëntë

Zenun Çelaj: I përqafnin edhe ata (qan). Të nesërmen në qytet kolona e serbëve po largohej. Kishin hypë edhe ushtartë, gjithnji me këto përshëndetjet provokuese {tregon me duar} me tre gishta. Kurse këta ushtartë që hynë në Prishtinë i frenonin shqiptartë që mos të bajnë ndonjë gjest, të vrasin... megjithëse ndodhën ndërkohë që në ditën e parë ose të dytë ktu hyri Batalioni i Atlantikut, shqiptarë t'ardhun nga Amerika.

Ata ishin edhe ma të etshëm, t'thom ose manifestonin agresivitet ma shumë edhe ndodhën disa vrasje, vranë serbë. E patën vra edhe ndonjë policë, sa e di unë. Nuk e di saktësisht statistikën se atëherë edhe s'e kishim këtë mundësinë se si të mbajmë shënime. Edhe pse si gazetar, veprimtar i Këshillit të Drejtave të Njeriut isha ma i përgaditun për këtë mision, por nuk e kreuva. Nuk kishe ku as ku të pijsh ndonjë kafe. Ka qenë vetëm një kand, një kafe, një goran domethanë, musliman po goran që e kishin leju edhe në kohën e bombardimeve.

Aty në kandin te Sheshi "Zahir Pajaziti" domethanë ai s'mund t'i jepte, si me thanë, s'mund të plotësonte as një të mijtën të kërkesave për të pi kafe. "Grandi" ende ishte në durë të, në kontrollin e serbëve që ma vonë kem marrë vesh që ata kishin qenë krejt të sigurimit serb. Erdhi një shok i imi prej Gjilani, Ibrahim Osmani, edhe ai gazetar, edhe ai kishte nejt në bodrumin e shtëpisë t'vet në Gjilan se atje ka pasë ma pak kësi aksione të policisë e të ushtrisë.

Po edhe ai për shkak se ka qenë një ndër ata të izolumit në 1989-shin edhe ai i ndjekun për shkak të grevës në “Trepçë”, s’kish pasë guxim të dalë. Edhe mezi e binda t’hijmë të shohim çka ka mrena në “Grand”. Hyjmë në “Grand” i gjithë personeli vetëm serbisht fliste. Ne kërkonim shqip ata, “Nuk po iu kuptojmë” e na e kthymë, “Do të kuptoni, do të kuptoni mirë”. Edhe ata fillun me u friku, fillun me, si të them, të jenë ma të arsyeshëm, ma të butë.

Ndërkohë, fillunë kolonat të kthyme që ishin kanë që kishin ikë në Maqedoni e Shqipëri, pa ndërprerë vishin në Prishtinë. UÇK-ja, këta të Llapit hyjnë në Kolovicë knej se në qytet nuk i lente KFOR-i, forcat e NATO-s. Nuk i lejunë as me ardhë se ku i zenin me armë ia merrnin armët. Kështu që, ata u nalën në Kolovicë. Ni pjesë e tyre edhe i hoqën uniformat që të mund të lëviznin nëpër qytet, se sa i shihnin me uniforma i merrnin, ua merrnin edhe ato uniformat por edhe kërkonin armë prej tyre. Por, që me i evitu ato tendeshje, ata u nalën në Kolovicë në një prej fabrikave aty të, “Slllovenia Les” m’duket është një, repart ka qenë aty. Dhe kështu...

Aurela Kadriu: A dijsht për Lirakun në atë kohë?

Zenun Çelaj: Po, ai kishte ardhë bashkë me njësi, me këtë... prej zonës së Llapit këtu në Kolovicë. Unë nuk e dijsa se ka ardhë, po ni shok, domethanë vëllau i shokut tim, e kom përmend më duket edhe te ju këtu, Osman Dumoshi. Ai kishte depërtu anej ma herët edhe ishte taku me ata. Erdh, më kish lypë në tona antë. Më gjeti përmes shokëve e m’tregoi se ka ardhë Liraku dhe që osht’ në Kolovicë. Edhe kështu mandej unë shkova me shoktë e tjerë që ishim këtu. E takova mas shtatë-tetë mujsh, ashtu i binte, nantë. Ai prej shtatorit ma kështu nuk ishte në Prishtinë e nuk e kisha pa. Ishte takim shumë emocional, natyrisht edhe nivesha krenar që ka qenë (qeshë), si me thanë, t’ju thom të drejtën...

Aurela Kadriu: E kur iu tha që po don me shku në fillim? Që po don me iu bashku UÇK-së?

Zenun Çelaj: Mu kur më tha?

Aurela Kadriu: Po.

Zenun Çelaj: Po, unë isha i smutë e tha, “Të vijnë këta, njerëzit tanë le të marrin”. Unë isha me të vërtetë i smutë. Ia sqarova. Unë kisha frikë t’shkoja atje, do t’jem barrë, plus se duhet me m’bajtë me u kujdesë për shëndetin tim. Punë e madhe, këtu do të vdes edhe kurgjo kërkujt, dikush shpëton atje e s’e kanë edhe hallin tim. Kështu që refuzova. Plus edhe me ikë, se kisha mundësi me lëshu edhe Kosovën, me këto kolonat që shkojshin kështu. Aty ishte tollovi, plot trenat musheshin kishim informatë edhe na. Po, të thom të drejtën, vinte ligështi. Unë po shkoj me shpëtu që isha në ni moshë atëherë ma, i bjen ‘99-shin, 40, sa po i bjen, gati 60 vjet. Unë po shkoj me shpëtu kokën e djali po mbetet të më vritet. Kështu që, pata vendos, isha i vendosun të mos ta lëshojë Prishtinën.

Aurela Kadriu: Unë iu pyta qysh e pritët kur ai ju tregoi se do t’i bashkohet UÇK-së?

Zenun Çelaj: Unë s'kam qenë në Prishtinë hiç atëherë. Kom qenë në Amerikë. Isha te vëllau, e kom pasë edhe motrën atje edhe do të kthehesha. E kisha ndërmend të vij në Londër, ku e kom djalin tjetër, po ky m'thirri prej knej m'tha, "Unë Iliren me fëmi i përcolla për Strugë, unë po shkoj ku shkojnë burrat". Kisha një drojë se ai fëmi i lemë e i rritun në qytet se nuk do t'i përballojë kushtet e luftës. Edhe i thashë, "Lufta nuk osht' si n'film" se osht' aktor, "nuk osht' si filmi osht' diçka tjetër. A e ke mendu mirë?" Tha, "Të gjitha i kam mendu" thashë, "Ta dish se ma shumë do t'koritesh në qoftëse ikë prej luftës, sesa në qoftëse nuk shkon. Se je..." se ai ka qenë ma delikat prej fëmijëve. Krejt jetën, si me thanë, me artin, me kulturën, punonte me kompjuter. Edhe thashë, "Mendoje mirë. Me bo me ikë, në qoftëse kërkush tjetër s'të vret, unë ka me të vra". Tha, "I kom mendu, hiç mos ki dert".

U ktheva unë në Prishtinë, të jom të paktën derisa të fillojë bombardimi. Jo që prishtim bombardimin, na pritshim ma shumë masivizimin e UÇK-së edhe të shndërrohet në një luftë të përgjithshme, por ajo ndodhi ashtu si ndodhi. Ishte ma fat për ne ni, s'di si me thanë, Zoti sikur me na pasë beku që na doli krah NATO-ja, se ku me ditë sa do të zgjaste ajo situatë. Kështu përfundoi ajo.

Aurela Kadriu: Qysh vazhdoi jeta mbas luftës?

Zenun Çelaj: Mas luftës ishin këto përpjekjet për ringjallje, rikthimin e institucioneve, të pushtetit. KFOR-i e mori kontrollin e sigurisë, u krijun, si të them, ni pushtet ndërkombëtar praktikisht, që i ndanë pushtetet. Dikush, UNMIK-u këto institucionet e drejtësisë, këto tjerat, OSBE-ja arsim e... domethanë, pushtetet e ndryshme juridike, ekzekutive e tjetër, por që ishte një pushtet që iu dha shqiptarëve ishte vetëm formal ose bërthama të ni pushteti që do të formoheshin ma vonë, që do të kenë ato prerogativet, autorizimet në kohën kur këta do të largoheshin.

Siç po shihet ende nuk, as nuk është i plotë ky pushtet, sado që kanë kalu. Sa u bonë? 19 vjet. U përpoqëm të nxjerrim edhe gazetatat. Unë shkova, se atëherë ende nuk ishin largu... që mas dy ditësh tre ditësh, shkova në Pallatin e Shtypit, ku ka qenë redaksia e gazetës. E tash krejt Pallati i Shtypit, me shtypshkronjë ishte nën kontrollin e ni firme që e pat' kriju Beogradi "Panorama" e qujtun.

Në krye të saj kishin vendosë një gazetar të "Jedinstvo" megjithëse njihesha, natyrisht, një Vujoviq e ka pasë emrin. Ai kishte hy në zyrën e kryeredaktorit, drejtorit të "Rilindjes" së gazetës që kemi qenë ma përpara. Edhe unë me dy-tre gazetarë të tjerë të "Rilindjes" që kishim mbetë këtu shkova i thashë, "Siç po sheh koha e juj ka mbaru, ne nuk do të sillemi siç jeni sillë ju me ne". Se ne, me të vërtetë u sollën shumë keq ndaj nesh. Nuk na botojshin gazetën, na përzunë prej zyreve me forcat serbe.

Thashë, "Ne nuk do të sillemi ashtu. Kthehuni në katin tuj" kanë pasë ata një kat e gjysë të Pallatit të Shypit, "vazhdoni botoni gazetën si të doni ju vet me mjetet tuaja, nuk do të keni asnjë pengesë prej nesh po të largoheni vullnetarisht". Tha, "Na kemi ni pushtet dikund tjetër të cilin duhet ta pyesim. Nuk mujmë... nuk janë pazare që mundemi me i bo mes nesh". Unë, se isha, si me thanë, edhe ma i vjetri

që kisha mbetë këtu edhe që kom pasë ma shumë kompetenca në atë kohë, në kohën kur “Rilindja” u shu, u mbyll, si të them. Prandaj, i jepsha vetës këtë të drejtë të flas në emër të “Rilindjes”. “Rilindja” pat’ fillu me dalë në Maqedoni, dilte në Shqipëri edhe dilte në Zvicër. Ishin këto redaksitë, domethanë, kishim njëfarë baze.

Ashtu tha, “Bisedojmë prapë”. Shkova edhe nja dy herë të tjera, nuk iu bind ktyne. Mandej kanë hy ushtarë të Batalionit të Atlantikut edhe i dëbunë, ikën ata përfundimisht. Po ne këtu s’mund u organizum, s’kishim as pare as kurgjo, edhe në fillim s’mund e nxorrëm gazetën shpejt. U organizun do tjerë. Kurse ne me Blerim Shalën, me Bardh Hamzën që ishin të gazetës “Zëri” që ish edhe kjo në kuadër të “Rilindjes”, u organizumë me kqyrë me nxjerrë ni gazetë tjetër të përditshme që e pagëzumë “Zëri” dhe unë isha ai kryeredaktori i parë. Numrin e parë e nxorëm në fund të... se kërkonte përgaditje, kuadrin me përgaditë e me nda puntë. Me 30 dhjetor, dhjetori 30 apo 31 ditë i ka?

Aurela Kadriu: 31.

Zenun Çelaj: E atëherë me 31 dhjetor edhe 1 janar. 31 dhjetor ‘99 edhe 1 janar 2000 nxorëm dy numra kështu eksperimental edhe vazhdoi “Zëri” mandej i përditshëm. Sigurum edhe donacione nga organizatat ndërkombëtare edhe nga Brukseli, nga Holanda, s’e di nga na patën dhanë ndihma edhe vazhdon ajo gazetë. Mandej pat’ ni shpërthim botimesh edhe të tjerëve. U rikthy edhe “Koha Ditore”, “Kosova Sot” që poashtu e patën djeg këto forcat serbe të para të Millosheviçit, “Bota Sot” që dilte edhe në Zvicërr e ni botim filloi të dalë ktu. Fillunë mandej edhe gazetat e tjera.

Aurela Kadriu: Deri në cilin vit ishit në “Zëri”?

Zenun Çelaj: Në “Zëri” kam qenë deri në 2009.

Aurela Kadriu: A na tregoni për pavarësinë? Ku keni qenë?

Zenun Çelaj: Për pavarësinë, në fakt deri 2008 për pavarësinë kom qenë në “Kohën Ditore”. Po privatizohej “Zëri”, privat ishte po ky po e shiste, Blerim Shala që ishte pronari faktik me Bardh Hamzën. Edhe na mblodhi redaksinë tha, ishte fundi i gushtit tha, “Deri në tetor keni pagat, unë iu jepi mas tetorit varet nga ai që e blen gazetën”.

E tash ni prej kolegëve e kish ni vajzë të sëmure shumë, me ni sëmundje të lindun kështu, fytin e ngushtë, që nuk përbinë ushqim ma të trashë se ujin, domethanë ky lloj ushqimi. Ai duhej çdo muj të shpenzojë për ushqimin e vajzës së vet që e blente ose në Turqi ose në Perendim, Europë nga 300-400 marka, euro. Edhe m’thotë, “E di, ke miqësi me Vetonin, me Flakën, a po shkon bisedo me ta a mund të më gjejnë një punë, se unë s’e di çka do të baj në qoftëse mbetëm pa punë, veç ta vrasë vajzën”. S’kish faj.

Shkova i thashë Flakës, ajo me të vërtetë është një personalitet shumë human. Si ia shtrova problemin tha, “Thuj nesër le të vjen”. Edhe shkoi ai me punu aty, po ndërkohë tha, “Na kemi dashtë, kemi mendu me Vetonin...” tha, “Po don me themelu ni portal. Kemi mendu me të thirrë ty, po e dijmë se ti je shumë besnik i ‘Rilindjes’ e atyne dhe nuk do të tradhëtojsh. Po në këto rrethana, a do të vish?” Edhe unë thashë meniherë, “Po”. Edhe kështu kalova. I bjen 2009 duhet të jetë, po, po, 2009. Se 2008 në “Zëri” kam qenë kur u shpallë pavarësia.

Aurela Kadriu: Çfarë momenti ishte qaj specifikisht ajo ditë?

Zenun Çelaj: Na në gazeta zakonisht për disa ngjarje që planifikohen marrim vesh para opinionit. Edhe ishim përgaditë për këtë ngjarje natyrisht. Ishte padyshim lajmi ma i gëzushëm në jetë. Unë nuk di, tash ka qenë i gëzushëm edhe kur hyni KFOR-i se e përjetum edhe ishte çlirimi. Unë bile habitem pse këto institucionet tona nuk e kanë marrë si ditë çlirimi 12 qershorin, por kanë vendosë disa data tjera, se është dita faktike e çlirimit të Kosovës.

Të them, ishte e paimagjinueshme. Ju po shihni edhe tash se jam emocional e gjithmonë kam qenë. Dita kur u shpall pavarësia ka qenë ni ditë shumë e ftohun. Ata që e kanë shijue e jetue e kujtojnë kështu si ka qenë. Po qyteti ka qenë, s’kishe ku ta vësh gjylpanën. Grupe këngëtarësh të këtushëm por edhe nga Shqipëria. Njerëzit... kom përshtypjen se atë ditë secili ka qenë në gjendje me fal mëkatet, tjetrit me ia fal borxhet, me fal gjithçka.

Thuja të gjithë i shishe të përlotur, natyrisht edhe unë ma shumë se të tjerët (qeshë). Ishin kërcënimet e Serbisë e të serbëve se do të ndërmarrin aksione kundër kësaj, por ishte garanci e NATO-s e KFOR-it, kështu që gjithçka kaloi mirë. Megjithëse protesta në Mitrovicën e Veriut e anej që kanë qenë edhe shumë të dhunshëm. Për fat të keq pati edhe shqiptar të vramë në atë pjesë, se ajo nuk ishte nën kontrollin tonë ashtu siç nuk osht’ plotësisht as sot. Domethanë, edhe kjo datë pat’ viktimat e veta si shumë ndër vite, ndër shekuj çashtja e pavarësisë e çlirimit ndër shekuj prej serbëve.

Aurela Kadriu: A ishit në punë atë ditë?

Zenun Çelaj: Po, kom qenë në punë edhe kom punu edhe gjithë të tjerët në përpjekje për me pasë çdo detal të asaj dite që e shënonte historinë, sigurisht ditën ma të ndritshme të Kosovës. Tash Pavarësia e Kosovës, thuja asnjherë nuk është projektu si një ide e preokupimit, ide e angazhimit të njerëzve që janë marrë me çashtjen kombëtare.

Është marrë si një çlirim prej serbëve edhe bashkim me Shqipërinë edhe natyrisht se kjo shpallja e pavarësisë u konsideru si një ditë kalimtare deri në bashkimin me Shqipërinë. Se u shpallë flamuri që nuk kishte asgjë të përbashkët me atë simbolin me të cilin ishim rritë në andrra tona, të hapta ose të fshehta, jo veç na po edhe gjenerata para nesh. Himni ishte pa tekst, edhe sot s’din askush ta këndoje se

duhet me qenë veç njeri i profesionit të muzikës që të dijshe t'i bojsh notat kështu, se s'ka fjalë. E kështu. Ky ishte ai përjetimi.

Aurela Kadriu: Qysh vazhdon jeta e juaj sot? 60 vjet përvojë a?

Zenun Çelaj: Në majin e vitit të ardhshëm... se në "Rilindje" si gazetar jam pranue me 25 maj, 1960. Atëherë edhe për pranim në punë e këso merreshin data që ishin festa me i shënue. 25 maji ka qenë Dita e Rinisë që festohej. Në atë kohë e Dita e Rinisë ishte, si thonë, ditëlindja e shokut Tito që në atë kohë na natyrisht e festonim që jo me shumë entuziazëm si ditë të tillë, po festonim natyrisht. Në atë ditë mas trajnimeve që pata për tu bo gazetar, m'u komunikua se jam pranue. Ishte komunikua ma herët po unë nuk e konsiderojsha vetën të zotin të merrem me gazetari po ni shok i imi, që duket e kam thanë, që ma shkroi lutjen, m'detyroi edhe u bana gazetar mbeta për 60 vjet. Gati 60.

Ni profesion tepër interesant osht', natyrisht, në qoftëse e don. Osht' profesion që ofron kënaqësi. I ka sëmundjet e veta, njeriu osht' në radhë të parë kurioz, të dijë gjithçka por mbi të gjitha para të tjerëve, këta ta ofron gazetaria. Pastaj secili ka qef të t'njohin tjetër, këta ta ofron gazetaria se je njeri që në gazetë ose televizion, dikur radio kur s'kish televizion zani po edhe emri edhe t'ju thom të drejtën të hap dyrë.

Unë nuk kom shfrytëzu asnjherë privilegjet që t'i ofron gazetaria po e di se kom qenë, kom pasë mundësi të hapi dyrë kudo ku kom dashtë në sajë të profesionit, emrit. Tash, jo secili gazetar e ka këtë privilegj. Si profesion don edhe guxim që me të vërtetë të jesh zani i qytetarëve që nuk kanë gojë, që nuk kanë vesh, flas për qytetarin e thjeshtë, të cilët nuk janë në pozitë me dalë me mbajtë fjalim, se nuk janë politikanë, s'janë gazetar që të shkrujnë e të thonë atë që mendojnë ose ta thonë në radio, ose në televizion.

Kjo gazetaria e ka këtë rol, domethanë të bahesh zani i atyne të pagojëve edhe të shurdhëve. E tash këtu, mjeshtria është që t'jesh i atyne memecëve, të thom, të cilët kanë çka me thanë, të cilët flasin në emër të atyne që kanë shumë halle, që kanë shumë ambicie, shumë vizione, këta ta ofron gazetaria. Prandaj edhe janë edhe ma të popullarizune, ma të njoftun.

Aurela Kadriu: Axha Zenun, nëse nuk keni diçka me shtu, unë veç iu kisha falenderu për krejt kohën, ka qenë shumë kënaqësi për neve.

Zenun Çelaj: Ishalla ju kom ofru atë që keni dëshiru. Ju kom thanë kom këtë problemin e komunikimit me gojë, sidomos para mikrofonit edhe kamerës po qikjo osht' se jom mësu veç me shkru me mendu mbi maqinë, jo me za.

Aurela Kadriu: Shumë faleminderit.